

930
2644

KOÇO ZHEKU

LIŞI NË SHEKUJ

930
26 44

KOÇO ZHEKU

LISI NË SHEKUJ



Redaktor: Jani Toçka

Reçensues: Pirro Thomo

Skënder Anamali

Kopertina: Artion Baboçi

H Y R J E

Ky punim është një vështrim historiko-arkeologjik për qytetin e Lisit - Lezhës së sotme, i bazuar në burimet historike, në kërkimet dhe në studimet e botuara kohët e fundit si edhe në të dhënët e vjetura gjatë punimeve shumëvjeçare restauruese të kryera në këtë qytet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Në vendin tonë, krahas arritjeve në degë të ndryshme të shkencave historike është bërë një punë e rëndësishme edhe në drejtim të kërkimeve, të zbulimeve dhe të studimit të vendbanimeve të lashta, duke filluar që nga ato shpelllore e deri te qytetet e fortifikuara ilire. Në studime të veçanta për vendbanimet parahistorike dhe për qytetet ilire është arritur të përcaktohen tiparet dhe elementet karakteristike të kulturave autoktone dhe vazhdimesia e tyre në truallin shqiptar. Janë, bërë të njoitura gjithashtu edhe marrëdhëni reciproke të popullsisë vendase me popullsitë fqinje.

Zbulimet arkeologjike shqiptare kanë vërtetuar një dendësi të konsiderueshme të vendbanimeve parahistorike, të hapura e shpelllore, të diktuara në zona të ndryshme të vendit tonë. Këto zbulime të rëndësishme hedhin një dritë të re dhe dëshmojnë për ngulimin e popullsisë dhe për fillimin e jetës njerëzore, qysh në periudhat më të largëta parahistorike.

Shumë nga këto vendbanime të lashta rezultojnë të janë banuar e fortifikuar edhe në periudha më të vona. Është vënë re gjithashtu se shumica e qyteteve ilire janë ngritur e janë zhvilluar në truallin e vendbanimeve më të hershme dhe mbi horizonte banimi të qendrave paraurbane.

Ndër qytetet shqiptare të ditëve tona, ku koha e kaluar shumëshekullore ka lënë gjurmët e saj të njëmbinjëshme e të dallueshme qartë, është pa dyshim edhe qyteti i vogël i Lezhës.

Lezha ka një histori të gjatë dhe shumë të lashtë, sepse ky qytet ka jetuar në vazhdimësi në të njëjtin truall përmë tepër se tre mijë vjet. Fillimi i ishte një vendbanim parahistorik i hapur më vonë, përmët vetëmbrojtje, u fortifikua me mënyra të ndryshme sa arriti të bëhej një qendër e rëndësishme paraurbane shumë afër bregdetit lindor të Adriatikut. Në kohë të mëvonshme ilirët e bënë atë një qytet të mirëfilltë të zhvilluar ekonomikisht e të përmendur përmët mbrojtjen e tij shumë të fuqishme. Në burimet historike të periudhave të ndryshme ai del si qytet i lulëzuar, i djegur dhe përsëri i rigjallëruar; disa herë i pushtuar e i shkatërruar nga armiq të ndryshëm, por gjithnjë i ringritur në këmbë, derisa erdhë në ditët tona.

Nën truallin e qytetit të sotëm janë zbuluar gjurmët e disa shtresëzimeve banimi, që përfaqësojnë shumë qartë dhe në shumë drejtime periudhat më të rëndësishme të jetës qytetare dhe të historisë së tij të lashtë e shumëshekullore. Më e dallueshme nga këto periudha është ajo e qytetit ilir të Lisis, sikurse edhe ajo e rigjallërimit të qytetit iliro-arbëror e shqiptar. Aty gjenden edhe gjurmët e periudhave të pushtuesve romakë, barbarë, bizantinë, venecianë si dhe periudha e gjatë e pushtimit osman.

Në rrugën e historisë së tij të lashtë ky qytet pati një sërë ndryshimesh si në strukturën shoqërore, ekonomike e politike ashtu edhe në vendosjen topografiko-urbanistike. Përmë pasojë, sipas kushteve e rrëthanave edhe mënyra e vetëmbrojtjes së qytetit është ndërtuar apo rindërtuar, herë pas here, duke iu përshtatur mundësive ekonomike, zhvillimit të strategjisë dhe të teknikës ushtarake të kohëve të ndryshme.

Studimet dhe kërkimet e mirëfillta arkeologjike, të shqëruara edhe me punime restauruese në qytetin e Lezhës, kanë filluar qysh në vitin 1966 dhe janë në vazhdim akoma edhe sot.

Ekspedita të përbashkëta komplekse arkeologjike-restauruese janë organizuar e janë drejtuar në vend nga punonjës të Qendrës së Kërkimeve Arkeologjike të Akademisë së Shkencave dhe të Institutut të Monumenteve të Kulturës.

Kohët e fundit kanë marrë pjesë edhe punonjës të muzeut lokal. ...

Zbulimet arkeologjike dhe punimet e restaurimit, të kryera për ringritjen e mureve rrithuese të qytetit, kanë krijuar një pamje të re, prej së cilës mund të përfytyrohet më qartë si shtrirja topografike e urbanistike e qytetit ilir të Lisit ashtu edhe vazhdimësia e tij në periudha apo në kohë të ndryshme.

Ky punim është një përpjekje për të njojur më afër këtë qytet dhe historinë e lashtë të tij, duke e prezantuar atë në periudhat më të rëndësishme të jetës së gjallë.

Qyteti i Lisit, siç u tha, gjatë shekujve nuk ka qenë gjithmonë i lirë. Pas periudhës ilire, ai shumë herë është pushtuar ose është sunduar nga perandori e nga formacione shtetërore e ushtarake të huaja. Në periudha të caktuara ky qytet është ndodhur edhe para kushteve ndonjëherë shumë të vështira e të pasigurta për vazhdimësinë e jetës qytetare të tij, siç ishte rreziku i romanizimit në kohën e pushtimit romak dhe ai i sllavizimit gjatë dyndjeve sllave në Ballkan.

Megjithatë popullsia vendase, siç e vërtetojnë faktet, asnjëherë nuk u zhduk, as u shterua por ajo gjithnjë u riqjallërua, u shtua e u fuqizua, duke mbijetuar në shekuj.

Banorët e qytetit të lulëzuar të Lisit u gjetën para vështirësive të mëdha gjatë luftërave iliro-romake, të cilat kishin për qëllim shfarosjen e fiseve ilire. Gjatë pushtimit romak ata e ndjenë rrezikun e romanizimit dhe, megjithëse në këtë kohë ishin më pak në numër se kolonët romakë të vendosur në këtë qytet, arritën përfundimisht t'i shpëtojnë këtij rreziku duke ruajtur kompaktësinë në bashkësinë etnike të tyre.

Dukuria e akulturizimit dhe ajo e romanizimit, të praktikuara në mënyrë sistematike nga romakët, duket qartë se në qytetin e Lisit nuk gjetën terrenin e përshtatshëm për tu zhvilluar. Këto dukuri mbeten të izoluara, ashtu sikurse ishin të ndarë me mure rrithuese edhe vetë kolonët romakë.

Romakët lanë këtu gjurmë të kohës së tyre, por në fund të fundit ata nuk u përqjetësuan në këtë qytet. Banorët e Lisit të vuajtura dhe të dëmtuar në njerëz dhe në ekonomi, gjënin gjithmonë forca të reja, prandaj e patën filluar disa herë nga e para rindërtimin e qytetit mbi gërmadhat e mbi shkatërrimet e së kaluarës.

Njohja dhe analiza e problemeve kryesore të zhvillimit ekonomiko-kulturor të shtrirjes urbanistike dhe e mënyrës së

vetëmbrojtjes së këtij qyteti, të para të gjitha këto kronologjikisht dhe sipas shtresëzimeve të banimit të periudhave të njëpasnjëshme, janë me interes të veçantë dhe ndihmojnë në dallimin e fazave të rritjes apo të rënies së qytetit. Në këtë mënyrë bëhet edhe më i qartë realiteti historik e kulturor i qytetit dhe i banorëve të tij ndër shekuj.

Nëpërmjet shtjellimit të këtyre problemeve dhe ballafaqimit të tyre me materialet arkeologjike e me dokumentacionin e burimeve historike, bëhet e mundur arritja e përfundimeve më të argumentuara, lidhur me zhvillimin e ngjarjeve historike dhe me rolin që ka luajtur ky qytet në periudha e në kohë të ndryshme.

Jeta në vazhdimësi në të njëjtin truall dhe e pandërrerë në shekuj vërteton si përkatësinë etnike ilire të qytetit të Lisit të lashtë ashtu dhe kalimin e tij në mesjetë si një qytet i mirëfilltë iliro-arbëror e shqiptar.

KAPITULLI I

PERIUDHA PARAHISTORIKE

1. Epoka e bronzit dhe e hekurit

Duke u bazuar në disa objekte arkeologjike, të zbuluara rastësish gjatë punimeve bujqësore e ndërtimore, mendohet se grupe banorësh parahistorikë zunë vend në krahinën e Lezhës dhe filluan të krijojnë vendbanime fiksë, aty nga fundi i mijëvjeçarit III p.e.sonë.

Gjurmët më të lashta që janë gjetur më afër kësaj krahine, janë të rastit në Gruemirë (Shkodër), në Dushman (Dukagjin), në breg të lumit Erzen (afër Shijakut) dhe tani së fundi në zbulimin e një vendbanimi shpellor në Blaç pranë fshatrave të Laçit e të Bruçit të rrëthit të Matit.¹ fig. 1.

I vërteti objekt përfaqësues i punës së dorës së njeriut parahistorik, që ka jetuar brenda në Lis, është një sëpatë e vogël prej guri të lëmuar, e cila u gjet rastësish vitet e fundit gjatë gërmimeve për hapjen e themelive të një godine në qendër të Lezhës. Objekti në fjalë ruhet i plotë, në gjendje të mirë. Është i tipit të ashtuquajtur «gjuhë loppe». Njëra nga sipërfaqet e sëpatës është e sheshtë, tjetra e gungëzuar.

¹ Historia e Shqipërisë, vell. I, Tiranë, 1959, f. 43. F. Prendi, Epoka e bronzit në Shqipëri, *Iliria*, VII-VIII, 1978 — fq. 9, 5, 5, 25 dhe «Vështrim mbi kulturën e periudhës së parë të epokës së hekurit në Shqipëri», *Iliria*, III, 1974, fq. 103-130.

Eshtë e punuar në gur të fortë, ngjyrë kafe në të zezë dhe nuk ka vrimë apo kanal për vendosjen e bishtit prej druri. Sipërfaqet e saj janë lëmuar imët dhe janë të shkëlqyeshme. Tehu eshtë i harkuar, mjaft i mprehtë. Pjesa e siperme eshtë e rrumbullakosur dhe më e ngushtë nga tehu.

Objekte të këtij lloji janë gjetur edhe në krahina të tjera të vendit tonë si, p.sh., në Maliq e gjekë. Ato konsiderohen si veglat e para prej guri të prodhuar nga njeriu parahistorik.¹ Por sëpata e gjetur në qytetin e Lisit eshtë pak më e vogël se të tjerat.

Studuesit e këtyre objekteve parahistorike janë të mendimit se ky tip sëpate eshtë i njohur dhe i ngjashëm thujse në të gjithë botën, por datimi i tyre eshtë i ndryshëm dhe lidhet drejtpërdrejt me zanafillën e jetës njerëzore. Ato vazhdojnë të përdoren edhe në periudha të mëvonshme.

Kjo sëpatë prej guri të lëmuar, megjithëse sot për sot eshtë e vetme, eshtë gjithmonë dëshmi e ekzistencës së një vendbanimi parahistorik, të vendosur në breg të lumit dhe shumë afër bregdetit të Adriatikut. Nga ana tjetër, ky objekt kaq i lashtë tërheq vëmendjen lidhur me thellimin e kërkimeve arkeologjike edhe në fushën e parahistorisë, si në qytet ashtu edhe në krahinën përreth tij.

Në krahinën e Lezhës epoka e bronzit dhe ajo e hekurit përfaqësohen nga një numër objektesh: armë, vegla pune, vathë, fibula etj. Duke u nisur nga fakti se krahina e Leshës dhe ato në kufi me të janë edhe sot zona minerale të pasura me bakër, atëherë mund të mendohet se prodhimi dhe përpunimi i bronzit ka qenë i njohur që në kohët më të hershme të kësaj epoke.

Ky mendim gjen mbështetje edhe nga vetë zbulimet e fundit arkeologjike. Eshtë fjala për «thesarin» e madh, që u gjet rastësisht gjatë rrugës së re automobilistike Lezhë-Shkodër, rrreth 13 km në veri të qytetit të Lezhës.² Ky «thesar» përbëhet nga më tepër se 120 copë sëpata prej bronzi, prej të cilave shumica janë të vogla, të tipit «Kelt» dhe të tjerat më të mëdha, të tipit «Shqiptaro-dalmat». Nga studimi i këtyre objekteve del se ky eshtë «thesari» më i madh parahistorik që eshtë zbuluar deri më sot në vendin tonë. Në këtë zbulim të veçantë e shumë të rëndësishëm gjejnë

¹ *Shqipëria arkeologjike*, Tiranë, 1971, nr. 12.

² F. Prendi, «Një depo sëpata parahistorike nga Torovica e Lezhës», *Iliria*, 2, 1984, fq. 19-45.

mbështetje edhe mendimet e shprehura lidhur me përkatësinë etnike të sëpatave të njohura deri tani me emrin «Shqiptaro-dalmate».

Sëpata të tilla janë të njohura edhe nga gjetjet në numër më të vogël, të zbuluara kryesisht në Shqipërinë e Veriut si në: Malgush, Shirokë, Pender, Gradaskije, Borje, rrëthi i Kukësit, si edhe në Mal të Zi e në Dalmacinë Jugore.

Për tu përmendur është edhe fakti që ndërmjet sëpatave të Torovicës u gjet edhe një sëpatë prej bronzi e tipit italik. Kjo sëpatë e njohur mirë shërbeu për saktësimin e datimit të sëpatave të Torovicës në gjysmën e dytë të shekullit X p.e.sonë. Nga ana tjetër, ajo vërteton për marëdhënie dhe për shkëmbime ndërmjet brigjeve të Adriatikut Jugor qysh në periudhën e hershme të hekurit.¹

Dihet se në parahistori objekte të tilla të njëllojta kanë qenë përdorur si armë njëkohësisht edhe si vegla pune. Në rastin konkret, sëpatat e Torovicës duhet të janë përdorur si objekte me vlerë shkëmbimi (në vend të monedhave, të cilat janë vënë në përdorim në kohë më të vona).

Për këtë arsyе edhe gjetja e këtyre objekteve është konsideruar si një thesar i fshehur në një gropë të mbuluar me dhe e me gurë, rrëzë një shkëmbi, rrëth tre mijë vjet më parë.

Këto objekte tregojnë nga ana tjetër për një shkallë kulturore të ngritur, për një zhvillim ekonomik të përparuar në fund të kohës së bronzit dhe fillimin e kchës së hekurit dhe njëkohësisht presupozojnë fazën paraardhëse të sistemit monetar edhe për krahinën e Lezhës.

Për dendësinë e popullsisë dhe për përhapjen e vendbanimeve parahistorike dëshmojnë gjithashtu edhe varrezat tumulare, ose kodër-varret, të cilat gjenden në gjithë territorin e krahinës së Lezhës.

Nga gërmimet e pjesshme që janë bërë në këto varreza apo nga gjetjet e rastit, në Muzeun e Kallmetit janë vendosur tri maja heshte prej bronzi dhe një shpatë e tipit «Mikenë» gjithashtu prej bronzi, në Blinisht është gjetur një çekan guri dhe një shpatë bronzi, në Spiten, në vendin e quajtur Sukë është gjetur një sëpatë bronzi e tipit «Shkodran». Ky toponim ndeshet edhe në Kallmet, ai është i shpeshtë thuajse në gjithë krahinën, gjë që lë shteg për të menduar se kodër-varret kanë qenë përdorur në të gjithë territorin e krahinës.

1 F. Prendi, Po aty.

Materiali arkeologjik i epokës së bronzit dhe të hekurit, gjetur në vende të ndryshme të krahinës së Lezhës, përbëhet siç u tha, nga vegla pune, nga armë, nga objekte zbuluar prej bronzi dhe nga prodhime qeramike, kryesisht enë të përdorimit të përditshëm. Në tërësi, ky material i zbuluar në Blinisht, në Trashan, në Dajç, në Kallmet, në Malësi të Lezhës, në Spiten etj. dëshmon për dendësim të vendbanimeve parahistorike si dhe për një zhvillim gradual të jetës së popullsisë vendase. Në një vështrim tjetër, këto materiale duhen parë edhe si shpresëdhënëse për zhvillimin e kërkimeve arkeologjike, në mënyrë që të bëhet i mundur verifikimi dhe dokumentimi më i mirë i kësaj periudhe të gjatë e shumë të rëndësishme.

Për vazhdimësinë e jetës njerëzore dhe për zhvillimin e mëtejshëm të vendbanimit të Lisit flasin qartë edhe gjurmët e fortifikimit, që janë zbuluar në majën e malit të Shelbunit (fig. 2).

Shelbuni ngrihet si një piramidë gjigante natyrale, në juglindje të qytetit, në 410 m lartësi nga niveli i detit. Për pozicionin gjeografik, për formacionin shkëmbor dhe për pjetrinë e theksuar të terrenit, ky mal u zgjodh si vendi më i përshtatshëm për mbrojtjen e popullsisë së vendbanimit të hapur breglumor në rast rreziku.

Mali i Shelbunit zotëronte gjithë terrenin fushor bregdetar dhe grykën e luginec së anën veriperëndimore. Nga maja e tij njeriu kishte përparrë një horizont shikimi shumë të gjerë e të thellë për të kontrolluar lëvizjet në rrugët që kalonin nëpër luginat dhe fushën që shtrihej deri në bregdet (fig. 3).

Në kreshtën, deri diku të sheshtë, të malit të Shelbunit janë zbuluar gjurmë muresh që tregojnë për një sistem mbrojtës parahistorik. Ato mund të ndiqen në një pjesë të mirë të gjatësisë së tyre dhe duken qartë se i përkasin një muri të ndërtuar me gurë të mëdhenj e mesatarë, të papunuar e të vendosur në muraturë të thatë. Gjerësia e murit rrëthues të majës së malit është 3.30 m.¹ Pjesa më e ruajtur shquhet në anën jugperëndimore, ku muri ruhet deri në 2-3 rreshta gurësh foto 1. Në anët e tjera duken në sipër-

¹ F. Prendi — K. Zheku «Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike», Monumentet, 2, 1971, f. 91.

faqe gjurmët e trases së mureve, vende-vende të shkëputura, por që mund të ndiqen gati në gjithë perimetrin e rrëthimit të tyre. Në qoshen jugore të terrenit të rrëthuar dallohen mirë gjurmët e një porte, e cila ka një hapësirë drite 1.40 m. dhe një korridor rrëth 3 m. të gjatë. Kjo hyrje i shërbente vendit të mbrojtur për një komunikim të afërt me vendbanimin breglumor. Duhet të jetë përdorur më tepër në zbritje, pasi për t'u ngjitur ishte shumë vështirë, sepse terreni është shkëmbor dhe me pjerrësi të madhe. Ka mundësi që hyrja kryesore e këtij vendi të mbrojtur të ketë qenë në anën veriore, në drejtim të qafës së malit, ku terreni është më i përshtatshëm.

Nga disa vëzhgime të pjesshme, brenda fortifikimit të Shelbunit janë gjetur fragmente enësh prej balte të pjekur, me punim të trashë e të punuara me dorë. Nga këto të dhëna të pakta arkeologjike dhe në mënyrë të veçantë nga karakteri tipologjik i ndërtimit të mureve rrëthuese me gurë të papunuar, arrihet në konkluzionin se ndërtimet mbrojtëse të majës së Shelbunit mund të janë bërë në kohë më të hershme se periudha e fundit e bronxit.

Nga disa studiues janë shprehur kohët e fundit mendime lidhur me disa «elemente karakteristike», siç është p.sh. kthesa pak a shumë me kënde të drejta e linjës së mureve rrëthuese të Shelbunit, të cilat dëshmojnë për një zhvillim të mëtejshëm të sistemeve mbrojtëse parahistorike.¹

Planimetria e mureve rrëthuese të majës së Shelbunit nuk ka ndonjë formë të rregult apo të kërkuar. Muri ka ndjekur një linjë të kushtëzuar më tepër nga natyra e terrenit. Kjo vërtetohet edhe nga vetë fakti që në anën perëndimore nuk ka pasur fare mur rrëthimi, sepse në këtë anë vendi është shkëmbor dhe me pjerrësi thuaqse vertikale, pra edhe i pakalueshëm. Duhet shtuar gjithashtu se gjurmët më të sakta të mureve rrëthuese të fortifikimit të Shelbunit janë ruajtur, siç u tha, vetëm në një trakt, rrëth 60 m i gjatë, i cili ndjek një linjë të drejtë dhe pa kthesa. Gjurmët tjetra të këtyre mureve janë përcaktuar në bazë të grumbujve të gurëve, që duken në sipërfaqe përgjatë pllajës lindore.

¹ Gj. Karaiskaj, 5000 vjet fortifikime në Shqipëri. f. 24.

2. Qendra protourbane

Kushtet ekonomiko-shoqërore dhe mijedisi gjografiko-fizik përreth vendbanimit parahistorik të Lisis, ndihmuani vazhdimesinë dhe zhvillimin e jetës njerëzore edhe në kohë të mëvonshme, deri në arritjen e krijimit të një qendre protourbane. Gjurmët e kësaj qendre janë zbuluar në majë të kodrës që ngrihej më sipër vendbanimit filletar të Lisis, i cili siç u përmend ishte në terren fushor, buzë lumiit e rrëzë kodrës.

Kërkuesat e reja më të avancuara për të bërë një jetesë më të sigurt në përshtatje me kushtet natyrore, sollën krijimin e kësaj qendre të re të mbrojtur, e cila ngrihet këtë radhë në gjysmë të rrugës që lidhet me vendbanimin filletar dhe me fortifikimin e Shelbunit. Terreni i zgjedhur në këtë rast për ndërtimin e kësaj qendre protourbane kishte një sipërfaqe deri diku të sheshtë dhe me përmasa të mjaf-tueshme për ngritjen e vendbanimit dhe për zgjerimin e tij në kohë më të vona.

Nga ky vendbanim i fortifikuar protourban janë ruajtur trakte të murit mbrojtës në anën perëndimore e jugore, të cilat duket se e rrithonin të gjithë majën e kodrës.¹

Gjurmët e pakta e të shkëputura të këtyre mureve, që arrijnë deri në 1 m lartësi, tregojnë se ato ishin ndërtuar me gurë të mëdhënëj e mesatar të punuar deri diku me çekan e të vendosur në muraturë të thatë.

Në disa bloqe gurësh të këtyre mureve ruhen disa kanale vijëdrejta, reth 20 cm të gjata, të gdhendura me daltë, që tregojnë për gropat në formë xhepi, ku vendoseshin pykat për çarjen ose për copëtimin e shkëmbinjve. Këto të dhëna si edhe përpunimi i gurëve me çekan para vendosjes së tyre në muraturë, tregojnë për zhvillim të teknikës së ndërtimit të mureve mbrojtëse protourbane ilire. Ky zhvillim lidhet me një sërë arritjesh në drejtim të forcimit të ekonomisë dhe në veçanti të vënies në përdorim të veglave prej hekuri, si dalta, çekanë e vare, që ishin më të forta se

¹ F. Prendi — K. Zheku dhe të dhënët e reja arkeologjike «Monumentet», Tiranë 1971, 2, f. 7-21.

ato prej bronzi dhe që bënин të mundur nxjerrjen, copëtimin dhe përpunimin e gurëve të përdorur pér ndërtimin e mureve mbrojtëse. Vetëkuptohet se shfrytëzimi i këtyre veglave prej hekuri dhe punimet bujqësore e në degë të ndryshme të artizanatit ndikuan në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj qendre të re protourbane.

Banorët e qendrës protourbane të Lisit jetonin në një mjeshtëri të tillë natyral e gjeografik, që ofronte kushte shumë të favorshme pér zhvillimin e bujqësisë, të blegtorisë, të peshkimit dhe të tregtisë.

Nga sa u tha del e qartë se fazat paraprake të përcaktuara gjatë rrugës kalimtare deri në arritjen e krijimit të qytetit të Lisit ishin si më poshtë. Faza e parë është ngulimi dhe krijimi i vendbanimit të hapur, të vendosur në terren fushor, i cili përfaqëson një bashkësi territoriale. Faza e dytë karakterizohet nga zgjedhja e një vendstrehimi të mbrojtur nga natyra si dhe fortifikimi i tij nga vetë ata që do ta përdornin në rast rreziku. Ndërsa faza e tretë përfaqësohet nga ndërtimi i qendrës protourbane të vendosur majë kodrës dhe fortifikimi i saj me mure rrethuese.

Në këtë rast, zhvillimi i procesit të shndërrimit të një qendre protourbane në një qytet të mirëfilltë përputhet në të gjitha drejtimet edhe me zhvillimin në përgjithësi të qyteteve ilire. Ato lindën mbi bazën e zhvillimit të brendshëm të vendbanimeve të fortifikuara të periudhës së parë të hekurit, të cilat janë ngritur pranë rrugëve të komunikacionit dhe në qendër të një pellgu gjeografik pak a shumë të gjërë, me kushte të favorshme pér zhvillimin e bujqësisë e të blegtorisë dhe nganjëherë me pasuri minerale. Rreth tyre ndeshen vendbanime më të vogla, të fortifikuara apo të haptcha, në të cilat jetonte popullsia fshatare. Si të tilla qytetet përbënë qendrën ekonomiko-politike të një pellgu gjeografik të caktuar:¹

¹ S. Islami, «Lindja dhe zhvillimi i jetës qytetare në Iliria», *Iliria*, II, 1972, fq. 2-19.

KAPITULLI II

QYTETI ILIR I LISIT

1. Të dhëna historike

Si rezultat i zhvillimit gjithnjë në ngritje të qendrës së fortifikuar protourbane, që u përmend, arriti të formohet në të njëjtin truall një qendër e re qytetare, e cila në burimet historike të kohës së lashtë përmendet me emrat Lis, Lissos, Lisson, Lissum etj. Banorët e këtij qyteti janë quajtur lisanë. Emrat etnikë, sipas Stefan Bizantinit, ishin: Lissios dhe Lisseus.¹

Në bazë të ndryshimeve të rëndësishme që ndodhën ne strukturën ekonomiko-shoqërore në Ilirinë Jugperëndimore, rrëth shekujve V-VI p.e.sonë, zënë fillin e jetës qytetare edhe qendra të tjera në bregdetin lindor të Adriatikut, si Shkodra, Ulqini, Rizoni etj.²

Formën e plotë e të mirëfilltë të një qyteti të zhvilluar Lisi e mori në kohën e përfundimit të sistemit mbrojtës së tij, aty nga fundi i shekullit IV ose në fillim të shekullit III p.e.sonë. Ndërtimet mbrojtëse të Lisit ishin sa të fuqishte për nga konstruksioni dhe teknika e ndërtimit aq edhe

1 Stefan Bizantini, *Mbi qytetet dhe popujt në burimet historike*, vell. 1, 1965, f. 419.

2 S.: Islami, «Lindja dhe zhvillimi i jetës qytetare në Iliri», *Iliria*, II, 1972, f. 12.

madhështore në pamjen e tyre. Nisur nga ky këndvështrim Lisi ishte në radhën e parë të qyteteve më të mëdha dhe të mbrojtura të të gjithë Ilirisë. Në këtë drejtim sistemi i fortifikimit të Lisit ishte ndoshta edhe më i fuqishëm nga ai i Apolonisë së Ilirisë foto 2.

Lisi, si një qytet bregdetar dhe njëkohësisht si limani më jugor i shtetit të ardianteve, luajti rol me rëndësi gjatë shekullit III p. e. sonë, sepse shërbente si pikë nisjeje përfotën ushtarake detare ilire në sulmet e shpejta e të befasimme kundër qyteteve bregdetare të Adriatikut, të Jonit dhe deri në thellësi të Mesdheut.

Ky qytet vazhdoi të ishte një qendër e rëndësishme edhe në kohën e sundimit të mbretëreshës ilire, Teuta, e cila sipas burimeve historike, arriti të riorganizojet më mirë flotën detare ushtarake dhe t'i bëjë më të shpeshia operacionet luftarake në mësymjen e qyteteve të mëdha: Epidamnit, Korkyrës, dhe të qyteteve të tjera të Greqisë.

Si qyteti i Lisit ashtu edhe fortifikimi i tij Akrolisi përmenden për herë të parë në burimet historike nga Polibi, historian grek i shekullit II p. e. sonë. Ky autor në historinë e tij trajton gjërisht luftërat iliro-romake dhe ngjarjet e tjera që u zhvilluan në tokën ilire gjatë luftës së rasteve maqedono-romake ndërmjet viteve 264, 146 p.e.sonë¹, foto 3 fig. 3/1.

Fillimisht qyteti përmendet kur pëershkuhen kushtet e paqes, që u vendosën ndërmjet mbretëreshës Teuta dhe përfaqësuesve të Romës, në vitin 229 p.e.sonë. Në këtë rast Lisi caktohet si kufiri më jugor i lundrimit të anijeve luftarake ilire në bregdetin lindor të Adriatikut. Ky kufizim i flotës ilire nuk zgjati pér shumë kohë, sepse në vitin 220 p.e.sonë, Skerdilajdi së bashku me Demeter Farin u nisën nga bregdeti i Ilirisë me 90 anije dhe mbasi kaluan Lisin vazduhan lundrimin në drejtim të ishujve Kylkade.

Nga Polibi mësohet gjithashtu se Filipi V, mbret i Maqedonisë, shoresonte të shtinte në dorë Lisin dhe Akrolisin. Për realizimin e këtij plani strategjik ai u nis me një ushtri të madhe dhe pas një udhëtimi prej dy ditësh, qëndroi pranë lumenit Ardoksan, afër qytetit të Lisit. Prej andej Filipi vuri re se ky qytet ishte i përforuar shumë mirë, si

¹ Polibi, Historitë, L.II.12, Burime të zgjedhura historike, vëll. 1, 1965, f. 49.

nga ana e detit dhe nga ana e tokës, nga natyra dhe nga do-ra e njeriut. Akrolisi, që kishte pranë, ishte shumë i lartë dhe ishte aq i fortifikuar saqë vetëm me një vështrim kup-tohej menjëherë se pushtimi i tij ishte një gjë e pamundur. Kështu mbreti maqedon humbi çdo shpresë për të, ndërsa për qytetin besonte se mund ta shtinte në dorë.

Përparrë kësaj gjendjeje Filipi vuri re vendin që ishte midis Lisit dhe rrëzës së malit të Akrolisit dhe pa se ai ishte i përshtatshëm për sulmin e tij kundër qytetit, të cilin mendonte ta pushtonte me një luftim të vogël, duke përdo-rur një taktkë të përshtatshme për rastin e dhënë. Para se të fillonte sulmin kundër qytetit, u dha një ditë pushim ushtarëve, kurse vetë i bëri një verifikim të përgjithshëm terrenit rrëth e rrrotull. Pas kësaj, në të ngrysur të ditës, mori pjesën më të madhe e më të zgjedhur të ushtarëve të armatosur lehtë, dhe e fshehu në disa lugina të pyllëzuara, që ishin nga ana e brendshme e tokës. Të nesërmen ai mori pjesën tjetër të ushtrisë dhe doli nga ana e detit, në perën-dim. Polibi e përshkruan me një saktësi aq të madhe terrenin përreth qytetit të Lisit, aq sa lë përshtypjen sikur historiani grek ishte i pranishëm, në krah të mbretit të Maqedonisë. Në vazhdim, para fillimit të luftimeve, Polibi shkru-an: «Brenda në Lis ishin grumbulluar forca të mëdha nga krahinat e aférme ilire, të cilat kishin ardhur aty menjëherë sa kishin dëgjuar për ardhjen e Filipit. Sa për Akrolisin, ilirët kishin një besim aq të madh në fortifikimin e tij, saqë kishin lënë atje vetëm një ushtri të paktë për ta ruajtur».

Beteja filloj menjëherë apo maqedonasit iu afrojan Lisit, Atëherë edhe ilirët filluan të derdhen jashtë mureve të qytetit, duke pasur besim si në numrin e madh të forcave të tyre, ashtu edhe në pozitën e fortë natyrore të atyre ven-deve. Mbreti maqedonas mbajti në fushë pelastët, kurse ushtarët e armatosur lehtë i nisi drejt kodrave për t'u përleshur rrëptë me armikun. Ndërsa ata po kryenin urdhrin e mbretit, fati i luftës për një kohë mbeti i dyshimtë, mirëpo pastaj ushtarët e Filipit, të ndodhur përballë një terreni të vështirë dhe një kundërshtari të madh në numër, u detyruan të kthehen prapa dhe të tërhiqen te pelastët. Vendasit morën guxim nga kjo fitore, i ndoqën ushtarët e Filipit, zbritën në fushë dhe u përleshën me pelastët.

Në këtë kohë ushtarët që ruanin Akrolisin kujtuan se Filipi po i tërhiqte forcat e veta dhe po bëhej gati të tërhiqej krejt nga fusha e betejës, duke mos kuptuar se ai mun-

dohoj t'i nxirrte jashtë fortifikimit. Atéherë, të mbështetur dhe në pozitat e forta të vendit, brenda në Akrolis qëndruan pak veta, ndërsa të tjerët të gjithë u derdhën nga rrugët e ngushta nëpër vendet e sheshuara të luftës, me qëllim që të ndiqnin armikun e t'i rrëmbejn plaçkën.

Pikërisht në këtë çast u ngritën ushtarët maqedonas që ishin të fshehur, dhe pa i vënë re njeri, u turrën me forcë e shpejtësi kundër ilirëve. Ndërkaj edhe pelastët e tërhequr u kthyen përsëri dhe u ranë ilirëve. Të turbulluar nga ky sulm i papritur, ata që kishin dalë nga qyteti i Lisit u shpërndanë, u tërhoqën dhe hynë brenda në qytet, por ata që kishin zbritur nga Akrolisi nuk mundën të kthehen prapa, mbasi iu pre rruga nga ushtarët që kishin zënë pritë Kështu ngjau kjo e papritur. Akrolisi u zu pa vëشتirësi, kurse qyteti i Lisit ra të nesërmën, mbas luftimesh të mëdha kundër sulmeve të rrepta e të tmerrshme të maqedonasve.

Pushtimi i qytetit të Lisit dhe të Akrolisit ndodhi në vitin 213 p.e.sonë. Ky pushtim bënte pjesë në planet strategjike të Filipit, i cili mendonte të krijonte paraprakisht një rrugëdalje të maqedonasve në bregdetin e Adriatikut. Një-kohësisht, ai kërkonte të krijonte në Lis, si dhe në qytete të tjera, baza detare, nga ku mund të hidhej përtej detit dhe t'i sulmonte romakët në tokën e tyre. Për këtë qëllim Filipi para se të merrte Lisin, kishte kërcënuar Epidamnin dhe sidomos Apoloninë. Këtë të fundit, megjithëse e sulmoi dy herë: më 216 dhe më 214 p.e.sonë, nuk kishte mundur ta pushtonte.

Në vazhdim të ngjarjeve historike qyteti i Lisit përmendet edhe një herë tjetër nga Polibi, këtë radhë si rezidencë e Gentit, mbret i ilirëve, sikurse quhet ai, në burimet historike të kohës së lashtë.¹

Në qytetin e fortifikuar të Lisit, Genti priti delegacionin e parë maqedonas të dërguar nga Perseu me udhëzimet paraprake për lidhjen e një aleance miqësore ndërmjet dy palëve. Por këto bisedime, siç dihet, u zgjatën me kthim e me dërgim delegacionesh, derisa përfunduan në qytetin Meteón të Labeatisë. Mbas kësaj marrëveshjeje Genti dërgoi përfaqësues, të cilët së bashku me ata të caktuar nga Per-

¹ Polibi, Vep. cit., Po aty. f. 67.



seu, do të shkonin në Rodi, për të bërë së fundi një aleancë tripalëshe kundër Romës.

Një historian romak i shekullit I shkruan se Genti, tanimë në pozita lufte kundër romakëve, mblodhi në qytetin e Lisit një ushtri prej 15 000 luftëtarësh të armatosur. Prej këtej ai nisi vëllanë e tij me 1 000 këmbësorë dhe 50 kalavës, për të nënshtruar me anën e forcës ose të frikës, fisin e kavëve, ndërsa vetë u nis kundër qytetit ilir Basanie, është milje larg Lisit, i cili në atë kohë ishte aleat i romakëve.¹

Sipas këtij historiani, Genti, përvëç këtyre operacioneve, kishte dërguar edhe 80 anije, për të plaçkitur tokat e dyrrashasve dhe të apoloniatëve. Këto veprime të menjëherëshme të Gentit shërbyen si shkas nga ana e romakëve, për fillimin e luftës kundër tij: Sikurse dihet, kjo luftë përfundoi në favor të romakëve, me dorëzimin e Gentit në qytetin e rrëthuar të Shkodrës, në vitin 168 p.e.sonë.

Në përfundim të njoftimeve nga burimet e lashta, lidhur me qytetin ilir të Lisit duhet përmendur gjithashtu edhe Diodori i Sicilisë, i cili jetoi dhe punoi në kohën e Jul Cezarit dhe të Augustit.² Ky autor është i pari dhe i vetmi që shkruan se Dionisi plak, tiran i Sirakuzës, gjatë fushatës së tij për kolonizimin e bregdetit ilir të Adriatikut, kishte dërguar kolonë dhe kishte themeluar qytetin e Lisit, në vitin 385 p.e.sonë. Duhet thënë që në fillim se të dhënët e këtij autori për fiset e Ballkanit vijnë nga fragmente të veprës së tij nëpërmjet autorëve bizantinë.

Themelimi i qytetit të Lisit nga Dionisi i Sirakuzës është vënë në dyshim qysh në shekullin XVII nga Lucius, i cili thotë se ku është shkruar që Lissos ka qenë themeluar nga Dionisi, duhet nënkuptuar Issa, në ishullin Hvar, dhe jo Lezha në Shqipëri.³ Ky mendim është përkrahur më vonë nga shumë autorë si: Fortis,⁴ Katali,⁵ Myler⁶, Belok⁷ etj. Por ka pasur edhe prej atyre që janë shprehur kundër këtij mendi-

1 Tit Livi, Nga themelimi i Romës, LXIV.29.6, *Burime të zgjedhura historike*, 1967.

2 Diodor, Biblioteka historike, L.XV.13.4, Burime të zgjedhura, f. 138, 129.

3 Lucius De regno Dalmatiae et Chratiae, Amstelodami, 1668, I. 26.

4 Fortis, *Voyage en Dalmatie*, II, Berno, 1778, f. 223.

5 Cattalinich, *Storia della Dalmazia*, I, f. 53.

6 C. Mullerus, *Geographi Graeci Minores*, Paris, 1855, fq. 29-30.

7 C. J. Beloch, *Griesc. Geschichte*, III, 1, 2. Berbiu, f. 118,

mi, si: Hen¹, Hekard², Majer³, Flus⁴, Prashniker-Shober⁵ etj.

Një analizë e hollësishme e këtyre mendimeve mospër-puthëse është bërë nga G. Novak, në studimin e tij mbi veprimtarinë kolonizuese të Dionisit të Sirakuzës në Adriatik.⁶

Në historiografinë shqiptare, këtij problemi, fillimisht, nuk i është kushtuar vëmendja e duhur dhe pa e thelluar është përanuar mendimi se Lisi është themeluar nga Dionisi i Sirakuzës në vitet 390/384⁷ p.e.sonë.

Kohët e fundit në një studim të veçantë («Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike») janë sjellë argumente të shumta e të shumanshme të dala nga gjermimet arkeologjike, që evidentojnë autoktoninë ilire të qytetit të Lisit.⁸

Lisi si qytet, në kohën më të lashtë të tij përfaqësonë qendrën e një fisi të vogël, prej të cilit trashëgonte edhe emrin e tij ΛΙΣΣΙΤΑΝ (Lisitan). Ky emër, siç do të shihet më poshtë, dokumentohet dhe arrin në ditët tona nëpërmjet monedhave të këtij qyteti. Në kohën më të vona ai do të bëhet kryeqendra e kraninës së banuar nga pirustët, të cilët, sipas Strabonit, bënin pjesë në fiset panore. që kishin përiprajës Baton.⁹

Pirustët dhe desidiatët dalmatë, në gjysmën e dytë të shekullit I p.e.sonë, konsiderohen nga Paterkuli, shkrimitar dhe ushtarëk i oborrit perandorak. të pathyeshëm, në sajë të pozitës së vendeve dhe të maleve, të natyrës së tyre të egër, të zotësisë së tyre të çuditshme.¹⁰

1 J. G. von Hahn, *Albanesische Studien*, Jena, 1854, f. 92.

2 H. Hecquard, *Histoire et description de la Haute Albanie*, Paris, 1857, f. 51.

3 E. Meyer, *Geschichte es Altertumis* Stuttgart, Berlin, 1913, fq. 162-163.

4 Flus në Pauly-Wissowa, *Real-Encyclopädie...*, s. v. Lissos,

5 C. Praschniker — A. Schober, *Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, Wien, 1919, f. 14.

6 G. Novak, *Kolonizatorsko, djelovanje Dionizija Starijega në Jadranu, Serta Hoffilleriana*, 1940, f. 111.

7 Historia e Shqipërisë, I, Tiranë, 1959, f. 61; S. Pulaha, *Vështrim mbi historinë e Lezhës në Lissus*, 1967, f. 85; S. Anamali — M. Korkuti, «Problemi ilir dhe i gjenezës së shqiptarëve», në *Studime historike*, 1969, 1, f. 127.

8 F. Prendi — K. Zheku, *Monumentet*, 2, 1971; Shiko edhe: F. Prendi — K. Zheku, «Qyteti ilir i Lisit, origjina dhe sistemi i fortifikimit të tij», *Studime historike*, 1, 1971, fq. 155-169.

9 Straboni, *Gjeografija*, L. VIII, 3.

10 Paterkuli, *Historia romake*, L.II, 115, 4.

Zona ku shtrihej fisi ilir i pirustëve, sipas Tit Livot, ishte ndërmjet tualantëve, desaretëve dhe banorëve të Rizonit, të Ulqinit e të Shkodrës.¹

Në kohën e sundimit të Gentit, pirustët ishin ndër fiset ilire që e përkrahën atë në luftën e tij kundër romakëve.

Mbas pushtimit romak të Ilirisë, pirustët ishin ata që vazhduan rezistencën duke sulmuar krahinat kufitare. Për të shuar kryengritjet e pirustëve niset vetë Jul Cezari, i cili, sipas tij, e stabilizoi gjendjen në vend.

Të dhënat e autorëve të lashtë që u përmendën janë me interes për njohjen e historisë së qytetit të Lisit, sidomos për momentet kur ky qytet ilir mori pjesë ose u lidh me zhvillimin e ngjarjeve historike më të rëndësishme të kohës së lashtë. Megjithëkëtë duhet thënë se këto njoftime janë të pakta, të pjesshme e të ardhura nga autorë. Shkrues të historive greke e romake, pra edhe të dhënat e tyre janë respektivisht të njëanshme.

Kuadri historik i qytetit të Lisit bëhet më i plotë dhe në disa anë më i prezantueshëm nëpërmjet zbulimeve arkeologjike dhe studimit të materialit të përfituar nga këto gërmime. Një vlerësim edhe më i dukshëm bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet restaurimit të monumenteve të zbuluara në këtë qytet.

2. Gjurmë të zhvillimit urbanistik të qytetit

Kërkimet arkeologjike dhe punimet restauruese të kryera deri më sot në qytetin e Lisit² kanë bërë të mundur studimin dhe përcaktimin, thuajse në përgjithësi, të planimetrisë së tij dhe njëkohësisht shtrirjen në kohën ilire, shekujt IV-II p.e.sonë.

¹ T. Livi, Nga themelimi i Romës, L.X, L.V, 26.13.
-244.

² F. Prendi — K. Zheku, «Qyteti ilir i Lisit», *Iliria*, II, 1972, fq. 215-244.

Në këtë kohë Lisi ishte vendosur në një terren kodrinor e fushor, me një sipërfaqe rrëth 20 hektarë. Ai fillonte që nga rrafshi i kodrës, mbi truallin protourban, zbriste në shpatet e në tarracat në anët veriore e jugperëndimore të kodrës deri në terrenin fushor rrëzë kodrës e në breg të lumenit. fig. 4.

Në përshtatje të këtij terreni urbanistika e qytetit zhvillohej në katër zona kryesore: a) Zona e pjesës së sipërme, e vendosur në majë të kodrës; b) zona e pjesës së mesme, e shtrirë në shpatet kodrinore; c) zona e pjesës së poshtme, që zinte vend në fushën rrëzë kodrës; d) zona breglumore që ishte ndërmjet shtratit të lumit dhe murit perëndimor të qytetit.

Secila nga këto zona mendohet se kishte edhe nga një funksion të veçantë.

Zona a — qyteti i sipërm, për vetë pozicionin natyror të mbrojtur, mendohet të ketë qenë e banuar nga klasa sunduese ose këtu të kenë qenë vendosur institucionet shoqërore, me karakter të ndryshëm. Zona b — qyteti i mesëm, e cila zinte edhe sipërfaqen më të madhe të të gjithë territorit të 'banuar, ishte më e përshtatshmja për ndërtimin e shtëpive të banimit.

Zona c — qyteti i poshtëm ishte qendra zejtaro-tregtare.

Zona d — porti lumor, vetëkuptohet se e lidhë qytetin me rrugët detare të Adriatikut.

Eshtë përcaktuar qartë se të tria zonat e para përfshiheshin brenda murit rrëthues të qytetit dhe secila prej tyre kishte hyrje të veçanta, që komunikonin drejtpërdrejt me mjedisin përrëth dhe me rrugët kryesore, që hynin në qytet.

Zona e katërt siç dallohet edhe në planimetrinë e qytetit, ishte e ndarë nga zonat e tjera dhe njëkohësisht e mbrojtur miqë nga zgjatimi i dy krahëve të mureve rrëthuese deri në breg të lumit.

Pjesë përbërëse e Lisit në këtë kohë ishte edhe Akrolisi, i cili zinte vendin e një përforcimi të veçantë në sistemin mbrojtës të qytetit.

Planimetria e Lisit, mund të thuhet, u zhvillua në përshtatje me kushtet e terrenit, me kërkesat e reja të jetës qytetare dhe në veçanti të vetëmbrojtjes së tij. Në këtë drejtim paraqitet me një planimetri të veçantë e të pa-përsëritur në asnjë nga qytetet e tjera ilire të njohura deri më sot.

Në dritën e të dhënavë të fundit, Lisi nuk mund të qëndrojë në radhën e atyre qyteteve të cilat janë konsideruar të ndërtuara sipas shembullit të qyteteve bashkëkohore në Greqi, në Maqedoni dhe në Epir; gjithashtu ai nuk mund të kategorizohet si qytet me akropol, sikurse është cilësuar në ndonjë rast.

Urbanistika e qytetit të periudhës ilire deri më sot është ruajtur shumë pak, por megjithatë, ato pak gjurmë që gjenden janë të sakta dhe me interes.

Nga periudha ilire ruhen planimetria e përgjithshme e mureve rrëthuese të qytetit, kullat mbrojtëse, të gjitha hyrjet e tij dhe një pjesë e mirë e rrugëve kryesore të pjesës së poshtme. Gjithë këto elementë ndihmojnë në përfytyrimin e zhvillimit urbanistik të Lisit në këtë periudhë.

a. Hyrjet e qytetit

Në planimetrinë e mureve të Lisit të kohës ilire janë përcaktuar me saktësi 11 porta të mëdha e të vogla, në-përmjet të cilave hyhej nga të gjitha drejtimet. Nga këto hyrje 2 janë zbuluar në pjesën e sipërme, 6 në të mesmen dhe 3 në qytetin e poshtëm.

Vendosja e këtyre hyrjeve në secilën zonë presupozon në vija të përgjithshme rrjetin rrugor që përshkonte në tërësi qytetin si edhe rrugët e jashtme që hynin në të.

Hyrjet ose portat e Lisit, jo vetëm që janë të shumta në numër, gjë që tregon një veçanti karakteristike të pasur në qytete të tjera të kohës së lashtë, por nga ana tjetër ato paraqiten të ndryshme në planimetri, në përmasa, në konstruksione si edhe në funksionet e tyre. Rrjedhimisht ato dallojnë edhe nga masat që janë marrë përmes mbrojtjenës së tyre dhe përmes kontrollimin e hyrje-daljeve të qytetit të rrethuar. Në bazë të këtyre karakteristikave, të njëmbëdhjetë portat në fjalë vetëndahen: në porta kryesore, të mëdha dhe të dorës së dytë.

Numri i caktuar për secilën zonë më vete është një tre-gues që lidhet respektivisht me popullsinë e vendosur në secilën zonë dhe me marrëdhëniet e tyre kundrejt mjedisit të jashtëm.

Në qytetin e sipërm porta kryesore ka qenë e vendosur në anën lindore dhe shërbente kryesisht përmes komunikimit më të afërt me Akrolisin dhe me krahinat e thella ma-

lore. Porta e dytë, që ishte në anën veriore, e lidhët këtë pjesë të qytetit me zonën fushore dhe me krahinën veriore. Duhet shtuar se ndërtimet e hyrjeve të mëvonshme, sidomos ato të periudhës mesjetare, nuk kanë lënë gjurmë të qarta lidhur me planimetrinë fillestare të këtyre hyrjeve. Ekzistenza e këtyre dy portave që në kohën ilire vërtetohet më tepër nga thyerja e drejtimit të murit rrighthes dhe nga traktet e mureve të korridoreve të brendshme.

Për hyrje-daljen e zonës kodrinore të qytetit të mesëm janë ndërtuar tri porta të mëdha dhe tri të tjera të dorës së dytë; nga këto, dy të mëdhatë dhe një e vogël janë vendosur në murin jugor dhe po aq të tjera në murin rrighthes të anës veriore.

Pjesët e poshtme të këtyre portave janë ruajtur në gjendje të mirë dhe shumë të qarta për nga ana konstruktive dhe nga planimetria e tyre si edhe nga mënyra e mbrojtjes së tyre. Porta më e madhe e kësaj zone është ajo e zbuluar para kthesës së murit rrighthes, që zbret nga shpati, në anën veriore të kodrës. Ajo ka një hapësirë drite prej 4.20 m dhe është e orientuar me ballë nga lindja, gjë që presupozon komunikimin e zonës veriore të qytetit të mesëm me rrugën që vinte nga krahinat e malësisë lindore. Në zgjidhjen planimetrike ajo paraqitet e veçantë në krahasim me portat e tjera. Këtu hyria ndërpret ballin e murit rrighthes. Para pragut të portës është lënë një korridor i jashtëm dhe në të dyja anët e këtij janë ndërtuar kullat mbrojtëse, të cilat zhvillohen në anën e brendshme të murit rrighthes. Me këtë vendosje krijohet gjithashtu edhe një korridor përbrenda portës. Sistemi i mbrojtjes së kësaj hyrjeje, me anën e dy kullave, e vendos atë në radhën e më të sigurtave, çka trengon pér funksionimin e rëndësishëm të saj foto 4 fig. 5.

Nisur nga përmasat dhe nga sistemi mbrojtës, ajo është quajtur Porta e Madhe.

Porta tjetër e kësaj zone, që gjendet rrëth 100 m. në perëndim të Portës së Madhe, shërbente, me sa duket pér furnizimin me ujë, i cili merrej nga një burim i vogël në afërsi të saj. Uji i paktë, por i kulluar e i ftohtë i këtij burimi, i freskon edhe sot udhëtarët, që ngjiten rrugës përpjetë kodrës. Pér funksionin dhe pér vendin ku ndodhet është quajtur Porta e Burimit. Megjithëse është me përmasa mesatare dhe ka funksion të dorës së dytë, ajo është gjithashtu e mbrojtur me anën e një kulle drejtëkëndore, ndërtuar në anën e djathtë, të hyrjes së saj foto 5 fig. 6. Nga

porta e tretë e anës veriore, që ndodhej më sipër Portës së Madhe, nuk janë ruajtur gjurmë shumë të qarta të planimetrisë së saj, por drejtimi, ndërprerja e murit rrethues dë ekzistencë e një kulle në kthesën e tij, supozojnë se edhe në këtë vend duhet të ishte një hyrje tjetër.

Nga tri portat e anës jugore, që të futnin në qytetin e mesëm, Porta e Gaviarit është kryesore. Ajo gjendet e vendosur në kthesën juglindore të murit rrethues, ka një hapësirë drite prej 4 m. dhe është e mbrojtur me një kullë të ndërtuar jashtë murit dhe në të djathtë të hyrjes së saj foto 6; fig. 7, 8. Nga Porta e Gaviarit është ruajtur pragu, blloqet mbështetëse të kasës dhe të kanatave si edhe blloku në mes të pragut, që shërbente për fiksimin e portës në mbyllje. Është me interes të vihet në dukje se këto gjurmë të para nga mënyra e vendosjes së blloqeve të gurëve të pragut dhe nga teknika e punimit të tyre, nuk janë të njëllojta me ato të portave të tjera. Kjo jep shkas që të mendohet se pragu i kësaj porte është i njëkohshëm me pjesët e murit të rrithimit dhe të kullës mbrojtëse, kurse pragjet e portave të tjera janë të rindërtuara, siç do të shihet në nië periudhë më të vonë se ajo ilire. Ky mendim përforcohet edhe nga fakti që në gurët e pragut të kësaj porte si edhe në ato pak gurë që ruhen nga kalldrëmi i korridorit, duken gjurmët e dy kanaleve paralele, të thelluara ose të ngrëna nga kalimi i vazhdueshëm i karrocave me rrota të veshura me rrathë prej hekuri të petësuar. Ky element, i zbuluar deri tanë vetëm në këtë hyrje, tregon, nga ana tjetër, se në-përmjet kësaj porte kalohej në tarracën perëndimore të zonës së qytetit të mesëm me karroca. Kjo gjë lë shteg për të menduar se në këtë zonë kishte rrugë të gjera e të sheshta, që lejonin qarkullimin e mjeteve me rrota, të cilat shërbën përfurnizimin me ushqime e me mallra të ndryshme.

Më anë të kësaj porte kjo zonë e qytetit lidhej drejt-përdrejt me rrugën kryesore, që vinte nga jugu, dhe me rrugë këmbësore lidhej edhe me Akrolisin. Porta e vogël, që është zbuluar në perëndim të Portës së Gaviarit, rrëth 50 m larg saj, shërbente edhe ajo përfurnizimin me ujë të pijshëm, që merrej nga burimet me ujë të bollshëm, të cilat gjenden akoma edhe sot jo shumë larg nga kjo portë. Përmesat në këtë rast janë shumë larg nga kjo portë. Përnjë kanat, e mbrojtur nga një kullë drejtkëndore, e vendosur në krahun e djathtë të hyrjes së saj.

Në kthesën jugperëndimore të murit rrethues është zbu-

luar edhe një hyrje, e cila i shërbente zonës më të ulët të shpatit perëndimor të zonës së qytetit të mesëm. Në zgjidhjen planimetrike të kësaj porte ka ndikuar terreni i thyer; vetë pragu i portës është i shkallëzuar, gjë që nuk lejonte kalimin e mjeteve me rrota.

Prania e gjithë këtyre hyrjeve në këtë zonë të Lisit tregon për një lëvizje e qarkullim nëpërmjet rrugëve që e përshkojnë qytetin e mesëm në të gjitha drejtimet.

Po të merret parasysh se kjo zonë ishte ndërmjet dy zonave të tjera (qytetit të sipërm dhe atij të poshtëm), s'ka dyshim se ekziston edhe rrugë të tjera që lidhnin të tria zonat e qytetit të Lisit.

Qyteti i poshtëm, me sa është zbuluar deri tanë, del se ka pasur tri hyrje, nga të cilat vetëm njëra është zbuluar tërësisht. Ajo paraqet një zgjidhje me planimetri shumë të zhvilluar dhe së bashku me sistemin mbrojtës të saj përbën një kompleks të vetëm jo më për qytetin e Lisit, por të pashoq edhe në qytetet e tjera të kohës së lashtë, që njihen deri më sot në vendin tonë foto 7, (fig. 9, 10).

Hyrja në fjalë është vendosur në murin jugor të qytetit të poshtëm. rrëzë kodrës, përballë rrugës kryesore që vinte nga jugu. Zgjidhja arkitektonike dhe konstruksioni i saj me përmasa madhështore tregojnë se kjo ishte hyrja kryesore e qytetit të Lisit.

Kjo hyrje ishte me dy porta të vendosura njëra pas tjetrës në mes të një korridori të gjatë 17.30 m dhe të gjerrë. 6.54 m.

Për mbrojtjen e kësaj hyrjeje dhe për kontrollin e hyrje-daljeve të qytetit, ajo ishte e vendosur ndërmjet dy kullave të mëdha të dala 6 m nga balli i murit rrëthues si dhe në mes dy kullave të tjera më të vogla të ndërtuara në anën e brendshme. Porta e parë e kësaj hyrjeje ishte 6 m më brenda faqes ballore të kullave, dhe në këtë mënyrë krijuhej një mijedis, i cili shërbente për kontrollimin paraprak të udhëtarëve, që hynin në qytet. Porta e dytë ishte ndërtuar në largësi 6 m brenda portës së parë; ndërmjet tyre ishte një koridor i dytë, që siguronte një disiplinim e një kontroll të dyfishë para hyrjes së portës së dytë foto 8.

Në vendet ku janë ndërtuar portat, gjerësia e korridorit ngushtohet me anën e pilastrave të ndërtuara me gurë të gdhendur e të lidhura konstruktivisht me muret anësore të korridorit. Duke gjykuar nga gjurmët që duken në dy pilastrat e portës së parë, del se kjo e fundit hapej e

mbyllej me anën e një kanatë, që ngruhej e ulej në drejtim vertikal nëpërmjet kanaleve të gdhendura posaçërisht në gurët e pilastrave. Kanata rrëshqitëse e kësaj porte mendohet se ishte ndërtuar prej druri, me trarë të trashë të skuadruar e të mbërthyer në kryqëzimet e tyre në formë kafazi.

Gropëzat katrore të gdhendura në bloqet e dy gurëve, që u gjetën përbrenda pilastrave të portës së dytë, vërtetojnë se kjo portë ishte e mbyllur me dy kanata prej druri, të cilat lëviznin me anën e çernjereve metalike prej bronzi, të fiksuara me plumb.

Për ekzistencën e një hyrjeje tjetër, të vendosur në murin rrëthues të anës veriore të qytetit të poshtëm, të dhënët e deritanishme janë të kufizuara. Presupozimi i kësaj hyrjeje lidhet vetëm me zbulimin e një kulle, e cila si nga vendosja dhe nga drejtimi i saj, lë shteg për të menduar për qenien e një hyrjeje simotër, d.m.th. e hyrjes jugore, që u përmend. Mendohet e njëllojtë me këtë të fundit, sepse të dyja këto hyrje kishin funksione të njëjtë në të gjitha drejtimet, pra edhe ndërtimi i tyre duhet të ishte i njëjtë.

Hyrja e tretë e kësaj zone është zbuluar në mes të gjatësisë së murit perëndimor. Ka një hapësirë drite 3.95 m dhe është e vendosur, duke ndërpërre drejtimin e murit rrëthues, në mes të një korridori të formuar nga ndërtimi i dy kullave mbrojtëse, të cilat zhvillohen në anën e brendshme të qytetit.

Porta e kësaj hyrjeje ishte vendosur ndërmjet dy pilastrave me përmasa më të vogla, por të punuara njësoj, sikurse pilastrat e portës së hyrjes kryesore.

Pozicioni i ndërtimit të portës perëndimore kishte një rëndësi të veçantë dhe tregon se vendosja e saj kundrejt bregut të lumit të lidhët qytetin me portin lumor dhe në përmjet tij me rrugën detare, e cila në kohën ilire ka luajtur rol me rëndësi të dorës së parë në zhvillimin e mëtejshëm të qytetit të Lisit. fig. 11.

Për tu vënë në dukje është fakti që pilastrat e gjetura në dy portat e qytetit të poshtëm ishin të ndërtuara për të njëjtin qëllim: zvogëlimin e hapësirës së korridorit, dhe me material e teknikë gjithashtu të njëllojtë. Ato kishin përmasa të ndryshme, në përshtatje me përmasat e secilës portë. Ndërtimi i këtyre pilastrave, në të dyja rastet, me bloqe gurësh të skuadruar e të gdhendur, me sipërfaqe të

sheshtë ndryshe nga bloqet e gurëve të muraturës, të cilët janë të punuar trashë me çekan e me faqe të gunguar, duhet konsideruar si një karakteristikë e veçantë, që lidhet me kërkeshat estetike. Të trajtuarën në këtë mënyrë pilastrat dukeshin më tepër si pjessë përbërëse të konstruksionit prej druri, me të cilin ishin ndërtuar portat, dhe në kontrast me vetë muraturën e korridoreve të hyrjeve.

Si elemente karakteristike të portave të qytetit të Lisisit mund të përmenden përmasat e tyre madhështore, zgjidhjet arkitektonike me planimetri të ndryshme në përshtatje me terrenin dhe me funksionin e tyre. Në shumicën e tyre portet janë të vendosura në mes të korridoreve të hyrjeve. Ato ishin ndërtuar me konstruksion prej druri, dyfletëshe, prej dërrase të trashë, të mbërthyera mbi tra-rë, me gozhdë të mëdha e me kokë, të rrumbullakëta. Kanatat e rënda të këtyre portave ishin vendosur me çerniera metalike prej bronzi, të përbëra nga dy pjesë, femër e mashkull, të cilat lehtësonin lëvizjen e tyre si në hapje ashtu edhe në mbyllje. Në mbyllje ato siguroheshin nga brenda nëpërmjet llozeve, (trarë prej druri), të cilat fiksoheshin në vrima të posaçme, të hapura në muret anësore të korrido-reve. Gjurmë të këtyre vrimave janë ruajtur në disa nga portat e përmendura.

Pragjet zakonisht ishin ndërtuar sipas terrenit të sheshtë ose edhe të shkallëzuar, me dy-tri këmbë shkallë para tyre. Koridoret e hyrjeve, në ndonjë rast, ishin shtruar me kalldrëm, siç u pa te porta kryesore e qytetit të poshtëm.

b. **Rrugët e qytetit**

Duke u nisur nga fakti se çdo hyrje e qytetit lidhej me rrugë të jashtme e të brendshme, atëherë del qartë se rrjeti rrugor ishte i dendur, i degëzuar përreth qytetit dhe i kryqëzuar në brendësi të tij. Nga rrugët e largëta që takohen në qytetin e Lisisit, më kryesorja ishte ajo që vinte nga jugu dhe tjetra që zbriste nga veriu. Një rrugë e tretë mendohet se vinte nga lindja apo nga verilindja.

Në perëndim Lisi lidhej me rrugët detare, që vinin edhe këto nga drejtime të ndryshme. Rrugët e jashtme të sipër-përmendura tregojnë gjithashtu edhe për një rrjet të dendur rrugësh të brendshme, të cilat shërbën për qarkulli-

min e lirshëm që nga pjesa e poshtme e qytetit e deri në pjesën e sipërme, majë kodrës.

Nga rrugët e brendshme deri më sot është bërë e njo-
tur vetëm një pjesë e rrugës kryesore, që përshkonte pjesën e poshtme të qytetit nga jugu në veri. Trakte të shkurtra janë zbuluar edhe para portave më kryesore të Lisit.

Nga traktet e rrugëve të njoitura del se ato ishin të gjera e të ndërtuara posaçërisht për qarkullimin e qerreve, të karrocave, të karvaneve dhe të këmbësorëve. Rruga kry-
esore, që kalonte në pjesën e poshtme të qytetit, ishte e pajisur edhe me trotuare për kalimin e këmbësorëve në të dyja anët.

Qyteti i Lisit, për pozicionin gjeografiko-fizik shumë të përshtatshëm të tij, ishte bërë një qendër me rëndësi të vecantë në rrjetin e rrugëve detare, që përshkonin breg-
detin lindor të Adriatikut.

3. Mbrojtja e qytetit

Sistemi mbrojtës i Lisit, si nga ana strategjike-ushtarakë ashtu edhe nga ana arkitektonike e konstruktive, është një dëshmi e gjallë. që pasqyron trashëgimin e traditave të lashta në fushën e ndërtimeve mbrojtëse ilire. I vendosur në një terren të thyer, me disnivele e me pjerrësi të theksuar, ai paraqiste vështirësi të mëdha në ndërtimet mbrojtëse të tij. Megjithatë mund të thuhet se këtu bien në sy zgjidhje konstruktive arkitektonike shumë të arritura e të përparuara për kohën e ndërtimit të tyre. Në sistemin mbrojtës të këllij qyteti duken qartë aftësitë e mëdha krijuarë dhe njëkohësisht ato ekzekutuese, nëpërmjet të cilave është arritur që të ndërtohet një vepër sa e madhe në përmasa aq edhe e fuqishme e madhështore në paraqitje.

Ndërtimi i menjëhershëm i një kompleksi të madh për mbrojtjen e qytetit, ku muret rrëthuese arrin në 2500 m gjatësi, tregon nga ana tjetër për një gjendje shumë të mirë ekonomike të popullsisë dhe për mundësitë e mëdha në fu-
shën e ndërtimeve mbrojtëse.

Mbrojtja e përgjithshme e Lisit paraqitet me një skemë, siç u tha, të veçantë e të pahasur në ndonjë tjetër qytet ilir. Karakteristika kryesore e kësaj skeme qëndron në vetë faktin se përveç murit rrighthues, i cili përfshinte të katër zonat e banuara, mbrojtja e qytetit ishte e përforcuar edhe me ndërtimin e Kështjellës së Akrolisit që ndodhej në një pozicion shumë më të lartë se qyteti. Në sistemin mbrojtës të Lisit rol të rëndësishëm ka luajtur edhe lumi, i cili kalonte paralel me murin perëndimor në një gjatësi rrëth 200 m.

Muri rrighthues ngrihej mbi një planimetri të çregullt, në përshtatje me terrenin dhe me shtrirjen e zonave të banuara. Duke filluar që nga bregu i lumbit, të dy krahët rrighthues (verior e jugor), 150 m larg njëri-tjetrit, pasi sigurojnë mbrojtjen e portit lumor, lidhen me murin perëndimor, përshkojnë terrenin fushor në vija të drejta pastaj i ngjiten shpateve të kodrës me vija të thyera e me drejtëme të ndryshme, derisa bashkohen dhe myllin rrithimin, duke përfshirë gjithë majën e kodrës, shpatin perëndimor dhe pjesërisht pjerrësinë veriore e jugore të kodrës, një sipërfaqe rrëth 20 hektarë.

Muri rrighthues i Lisit është i përforcuar me kulla, të cilat janë ndërtuar përmbyllin e portave të qytetit, të kthesave dhe të vetë kurtinave të murit.

Hyrjet, sipas funksionit apo pozicionit të tyre, ishin të mbrojtura me kulla, të vendosura në njérën anë ose në të dyja anët e tyre.

Kullat, në përgjithësi, janë me planimetri në formë katore dhe ngrihen mbi lartësinë e mureve rrighthuese, në vëllime prizmatike.

Vetëm një kullë paraqitet me planimetri afersisht çërekrrethi dhe me vëllim po aq cilindrik. Ky përjashtim lidhet, me sa duket me terrenin dhe me vetë kthesën e murit rrighthues. Deri më sot janë diktuar 23 kulla, nga të cilat 18 janë zbuluar gjatë gërmimeve dhe punimeve restauruese. Kullat e tjera ruajnë gjurmë të papërcaktuara mirë, por ekzistanca e tyre nën grumbujt e gurëve të rrëzuar nuk duhet përjashtuar përfundimisht.

Në pjesën më të madhe kullat e zbuluara ruhen relativisht në gjendje të mirë, sidomos në pjesën e poshtme të tyre. Nisur nga gjurmët e mureve të këtyre kullave, del se ato kanë qenë njëkthinëshe, drejtkëndore e të ngritura

mbi lartësinë e mureve rrëthuese. Pjesa e poshtme e kullave ka qenë mbushur me gurë të mëdhenj e të vegjël, mbeturina nga ndërtimi i mureve. Dyshemeja e kthinës së kullës, e cila mendohet se ka qenë e shtruar me pllaka guri, ishte në një nivel me dyshemenë e vendkalimit të mureve rrëthuese. Për t'u ngjitur në këto kulla janë përcorur shkallë prej guri, të ndërtuara ngjitur më kullën dhe gjithmonë në anën e brendshme të murit rrëthues.

Shkallët e kullave shërbenin njëkohësisht edhe për ngjitten në vendkalimin para bedenave të mureve mbrojtëse. Gjurmë të këtyre shkallëve, të ruajtura në 2-3-5 këmbë shkallë, janë gjetur pranë secilës kullë, thuajse në të gjitha kullat e zbuluara. Shkallët e kullave, megjithëse janë gjithmonë si shtesë, të dala nga faqet e mureve, nga ana konstruktive ato lidhen sa me kullat aqë edhe me muret e rrëthimit. Përmasat e këtyre shkallëve zakonisht luhaten ndërmjet tyre. Mesatarisht ato janë të gjera 1.50 deri 1.60 m dhe kanë bazamakë me gjërsi 32 cm dhe me lartësi 30 cm. Në bazë të këtyre përmasave mund të arrihet përafërsisht që të përcaktohet edhe lartësia e secilës shkallë deri në hyrjen e kullave. Kjo largësi mendohet të ketë qenë edhe lartësia e sheshkalimit të mureve rrëthuese. Duhet pasur parasysh se të dhënat e mësipërme ndryshojnë sipas terrenit dhe vetë pozicionit të ndërtimit të kullave; nga ana tjeter, lartësia që del nga përmasat e shkallëve është gjithmonë lartësia e brendshme e mureve, kurse lartësia e jashtme e tyre lidhet drejtpërdrejt me pjerrësinë e terrenit.

Në përforcim të kurtinave të mureve rrëthuese kuliat janë ndërtuar larg njëra-tjetrës në largësi që luhaten nga 40 m deri në 60 m. Për t'u vënë në dukje është edhe fakti që ndër ato vende ku muri rrëthues zbret në terren shumë të pjerrët, kullat janë zëvendësuar me kthesa me kënd të drejtë, me ballë të gjëre 3-4 m. Këto kthesa, përvëç funksionit mbrojtës, shërbenin edhe si kontraforte për pjesën e murit të ndërtuar më sipër tyre.

Në përforcim të sistemit mbrojtës të Lisit, kullat parqiten të thjeshta, me planimetri drejtkëndore, por me një konstruksion sa të fuqishëm aq edhe madhështor. Ato, në përgjithësi, janë të dala jashtë drejtimit të kurtinave të murit rrëthues, por ky rregull bën përjashtim në kullat mbrojtëse të hyrjeve, të cilat ka raste që janë ndërtuar të dala në anën e brendshme të mureve. Kjo dukuri është

vërtetuar në hyrjen perëndimore të qytetit të poshtëm dhe në portën e madhe, në anën veriore. Për t'u vënë në dukje është edhe zgjidhja e sistemit mbrojtës të hyrjes kryesore: me dy kulla të mëdha të dala në anën e jashtme dhe me dy të tjera më të vogla në anën e brendshme të saj.

Kullat e brendshme në këtë rast ishin më të vogla dhe kishin si funksion kryesor strehimin e rojeve të përhershme, të cilat ruanin hyrjen dhe njëkohësisht bënин hapjen dhe mbylljen e portës së dytë. Nga ana e brendshme e këtyre dy kullave komandoheshin llozet, trarët rrëshqitës në vrima të posaçme të hapura në muret e kullave, që komunikonin me korridorin mbrapa portës së dytë.

Muret rrëthuese janë ndërtuar tërësisht me gurë të punuar e të gdhendur me shumë mjeshtëri. Gjurmët e tyre ruhen mjaft mirë thuaçse në gjithë gjatësinë e perimetrit që rrëthojnë. Ato janë ndërtuar me një gjerësi prej 3.50 m. Bën pëjashtim muri perëndimore i pjesës së poshtme të qytetit, i cili, për arsy se ishte i mbrojtur nga lumi, kishte një gjerësi prej 1,50 m. Lartësia e mureve, e nxjerrë nga të dhëna të tërthorta, arrinte deri 6-8 m. Respektivisht edhe lartësia e kullave mbrojtëse ishte 10-12 m.

Përmasat e mureve madhështore shprehin jo vetëm kujdesin dhe rëndësinë e madhe që i kushtohej mbrojtjes së qytetit, por edhe aftësitë krijuarës ndërtimore me karakter të fortë, të ashpër, imponues. Madhështia dhe fortësia e sistemit mbrojtës të Lisit duket akoma edhe sot, kur ndodhesh para hyrjeve dhe kullave të tij.

Sistemi mbrojtës i këtij qyteti paraqitet edhe më i fuqishëm kur shihet së bashku edhe me fortifikimin e Akrolisit. Përshtypja që i bënë muret rrëthuese të Lisit mbretit të Maqedonisë, ishte me të vërtetë ashtu sikurse e përshkruan Polibi. Nga ana tjetër, duhet marrë parasysh se Filipi V, para se të vinte për të pushtuar Lisin, kishte parë Apoloninë dhe muret mbrojtëse të saj, ashtu edhe të shumë qyteteve të tjera të Greqisë, mirëpo asnë nga këto vende nuk i kishte lënë atë përshtypje që i la mbrojtja e fuqishme e qytetit ilir të Lisit.

4. Akrolisi

Përmendet fillimisht së bashku me qytetin e Lisis, si një kështjellë përforcuese e sistemit mbrojtës të tij.

Në kohën tonë, në Akrolis, në majë të Sheldunit, janë ruajtur shumë pak gjurmë muresh të ndërtuara brenda sipërfaqes së rrëthuar të fortifikimit parahistorik. Duke pasur parasysh përmasat e vogla të planimetrisë, të ndërtimi meve që ruhen këtu dhe teknikën e përdorur në ndërtimin e mureve, duket se ato përfaqësojnë një kështjellë të vogël. E cila shërbente më tepër si pikë vrojtimi në funksion të sistemit mbrojtës të qytetit të Lisis. Duhet shtuar që nuk mund të jetë i drejtë mendimi i shprehur se Akrolisi kryente edhe funksionet e akropolit të Lisis¹, sepse jo vetëm që nuk janë gjetur gjurmë të ndërtesave, të cilat ngrihen posaçërisht në akropolen, por edhe shtresa kulturore në të gjithë sipërfaqen e Akrolisit rezulton e cekët dhe shumë e varfër nga materiali arkeologjik. Nga ana tjetër, duhet thënë se Akrolisi ishte relativisht shumë larg nga qyteti dhe se rruga për t'u ngjitur deri në majë të tij ishte e ladhshme dhe e përpjetë.

Vetë emri Akrolis sugjeron një toponim të përbërë nga emri ilir i qytetit të Lisis dhe i parashtesës greke «akro». Në këtë kompozitë emri Akrolis do të thotë, në gjuhën greke, pjesa e sipërme e Lisis ose Lisi i Sipërm. Ky emërtim mund të jetë edhe thjesht përkthim i emrit ilir të kështjellës nga historiani grek, prej të cilët eshtë edhe burimi i parë i emrit Akrolis. Në të kundërt, Polibi duhet të jetë nisur nga rasti analog i Akrokorinthit, i cili rastësishët eshtë shumë i ngjashëm me pozicionin gjeografiko-fizik të Akrolisit.

Rivlerësimi i pozicionit zotëruesh të majës së malit të Sheldunit edhe një herë në skemën mbrojtëse të qytetit ilir të Lisis tregon për trashëgimin e traditave mbrojtëse më të lashta dhe njëkohësisht për një fuqizim edhe më të madh të mbrojtjes së qytetit në kushtet e zhvillimit ekonomiko-shoqëror dhe të strategjisë ushtarake të kohës, për të cilën bëhet fjalë (fig. 24.).

1 F. Prendi, Vep. cit., *Iliria*, II, f. 214.

5. Materiali dhe teknika e ndërtimit të mureve rrrethuese të qytetit

Në ndërtimin e mureve rrrethuese, të kullave dhe të portave të qytetit është përdorur si material bazë guri gjelqeror i nxjerrë në vend nga formacionet shkëmbore sipërfaqësore të kodrës, mbi të cilën shtrihej edhe vetë qyteti.

Teknika e përdorur për ndërtimin e këtyre mureve tregon për një zhvillim të bazuar në traditat e trashëguara që nga ndërtimet mbrojtëse të fortifikimeve parahistorike të Sheldunit dhe të mureve rrrethuese të qendrës paraurbane, që u përmendën më sipër.

Në ndërtimet e mureve rrrethuese të sistemit mbrojtës të Lisit vihet re koncepti konstruktiv i përdorur në ledhet rrrethuese të vendbanimeve të fortifikimeve të periudhës më të lashtë parahistorike.

Ky koncept karakteristik i kohës së lashtë është realizuuar në kurtinat e mureve rrrethuese, duke i zëvendësuar gardhet prej druri të strukturës së ledheve parahistorike me dy faqe muri të ndërtuara me biloqe gurësh të gdhendur e të vendosur paralel në largësi njëra nga tjetra rreth 2 m. Këto dy faqe muri (e brendshmja dhe e jashtmja) lidhen njëra me tjetrën me trakte muresh të tërthorta, sikurse lidheshin edhe gardhet prej druri në ledhet e përmendura. Bërrhamë e ledheve parahistorike ishte mbushja prej dhei të ngjeshur, kurse në muret e Lisit ajo është e mbushur me gurë të madhësive të ndryshme.

Tiparet dhe elementet karakteristike të teknikës së ndërtimit në muret e Lisit lidhen më tepër me përbërjen masive të formacionit shkëmbor si edhe me mënyrën e nxjerrjes apo të copëtimit të këtyre shkëmbinjve. Proseset e përpunimit paraprak të gurëve, si nxjerra, gdhendja dhe skuadrimi i biloqeve në forma e në dukuri të ndryshme, si dhe vendosja e tyre në muraturë, tregojnë qartë për vazhdimësinë dhe për zhvillimin gradual të vetë teknikës së ndërtimit të periudhës ilire.

Është konstatuar se për ndërtimin e mureve rrrethuese janë hapur disa gropë në brendësinë e territorit të rrrethuar, duke shfrytëzuar formacionet shkëmbore që ishin në sipërfaqë dhe sa më afër vendit të ndërtimit të mureve. Këto

gurore ndihmonin gjithashtu edhe për zgjerimin e vendeve të ndërtimit, ku terreni ishte i thyer e i pjerrët.

Duke u nisur nga disa gjurmë të ndryshme, që janë vënë re, në bлоqe gurësh, të cilët u gjetën të vendosur në mur ose ishin të rrëzuar, arrihet në përfundimin se për copëtimin apo për prerjen e shkëmbinjve masivë janë përdorur pyka prej druri të thatë, të futura në gropë të gdhendura në formë xhepi. Përmesat e këtyre gropave luhaten simbas madhësisë vëllimore të shkëmbit, nga 0.30 deri 0.60 m gjatësi, 0,20 deri 0.40 m thelli si dhe 0,50 m - 0,15 m gjerësi e grykës së gropës. Brenda këtyre gropave futeshin shtrënguar pykat prej druri të thatë dhe pastaj gropat mbushteshin me ujë. Pas një kohe jo shumë të gjatë, uji bymente pykat deri në plasjen e gurëve.

Gurët e copëtarët në këtë mënyrë dilnin me vëllime e forma poligonale të ndryshme; përpunimi përfundimtar i tyre u përmbahej zakonisht këtyre vëllimeve, në mënyrë që të kursehej sa materiali aq edhe koha për gdhendjen e tyre.

Muri rrethues i Lisit ka një gjerësi prej 3.50 m; ai është ndërtuar mbi themeli të vendosura mbi një tokë të fortë ose drejtpërdrejt mbi shtresën shkëmbore. Themeli i këtij muri është i ndërtuar vetëm me një rresht gurësh të zgjedhur, me sipërfaqe mbështetëse të madhe (kapakë guri me trashësi relativisht më të vogël kundrejt bлоqeve të përdorura në muraturë). Gurët e themelit janë vendosur gjithmonë me një drejtim horizontal bri njëri-tjetrit; ata janë gdhendur vetëm në sipërfaqen e tyre. Në rastet kur terreni është me pjerrësi, rreshti i gurëve të themelit ulet me një shkallëzim që është zakonisht i lartë sa është edhe rreshti i parë i muraturës që ngrihet mbi të. Gjatësia lineare e këtyre shkallëzimeve lidhet me pjerrësinë e terrenit. Gurët e themelit janë gdhendur trashë. Në gjithë gjatësinë ballore të tyre ato kanë një thembër të ngritur 4-5 cm dhe të gjerë 10-15 cm, e cila shërben për të parandaluar rrëshqitjen e muraturës.

Duhet theksuar se themeli nuk është ndërtuar në gjithë gjerësinë e murit, por vetëm për aq sa i takon mbështetjes së fakes së jashtme, ose asaj të brendshme. Bërrhama e murit ndërmjet dy fakteve mbështetet drejtpërdrejt mbi tokë. Është vënë re, gjithashtu, se në terren të pjerrët themeli i fakes së jashtme ndërtohet në një nivel më të ulët kundrejt themelit të fakes së brendshme.

Muratura që ngrihet mbi themel është e ndërtuar njësoj në të gjithë lartësinë: me bloqe gurësh të gdhendur në të gjitha faqet anësore bashkuese dhe mbështetëse. Faqja ballore e gurëve është lënë në përgjithësi e papunuar, dhe në ndonjë rast bloqet janë punuar ashpër vetëm me çekan. Në muraturë gurët janë vendosur për së gjati ose edhe për së larti, duke formuar në këtë mënyrë rreshta deri diku horizontalë ose më tepër të valëzuar.

Faqet e mureve (e jashtmja dhe e brendshmja) lidhen ndërmjet tyre me mure në një rrresh gurësh të vendosur në drejtim të têrthortë e në largësi të ndryshme. Secili rrresh i faqes së murit lidhet njëkohësisht edhe me bërthamën e murit, me anën e gurëve të vendosur në drejtim të gjerësisë së murit. Kjo lidhje përsëritet. Pas tre-katër gurësh të vendosur për së gjati, gjendet një blok i vendosur në drejtim të kundërt. Këto bloqe-lidhës dallohen qartë në faqet ballore të mureve, nga sipërfaqja e vogël e tyre.

Bërrthama e mureve është e ndërtuar me gurë me vëllime të ndryshme të papunuara ose me bloqe gurësh të dalë jashtë përdorimit gjatë gdhendjes së tyre, ata janë vendosur në mënyrë të çrregullt.

Nga ana tipologjike muret rrethuese të Lisit mund të konsiderohen si të tipit poligonal me ndërthurje vende-vende edhe të tipit drejtëkëndor. Ky i fundit përfaqësohet më shumë në ndërtimin e qosheve të mureve, të kullave si dhe në ndërtimin e portave të qytetit foto 9, 10.

Trajtimi stilistik i këtyre mureve nuk duket se paraqet një qëllim, paraprakisht të kërkuar, sepse bloqet e gurëve në pamjen ballore të tyre janë lënë të papunuara, me faqe shkëmbore e të gungëzuarë dhe në ndonjë rast të rrallë ato janë gdhendur trashë me çekan. Duke u bazuar në këto të dhëna muret e Lisit klasifikohen si mure të stilit me faqe shkëmbore.

Trajtimi stilistik i mureve rrethuese të qytetit të Lisit është bërë objekt studimi në literaturën historiko-arkeologjike nga studiues të huaj e shqiptarë. Ndërsa mund të përmenden arkeologët austriakë Prashniker e Shober, të cilët në botimet e tyre e trajtojnë me interes sistemin e fortifikimit të Lisit. Këta autorë dallojnë dy stile ndërtimi: muret rrethuese të këtij qyteti dhe janë të mendimit se ato i përkasin një faze të vetme ndërtimi. Këtë ndodhi ata e shpjegojnë me paraqitjen e terrenit të pjerrët dhe të shë-

shtë.¹ Pas këtyre autorëve, Bomo², i cili është marrë me studimin e veçorive stilistike të mureve epirote-ilire, pranon ekzistencën e dy stileve në muret rrëthuese të Lisis, por ai është i mendimit se këto stile janë edhe të kohëve të ndryshme. Ky autor, sikurse edhe Prashniker e Shober, përkrahës të mendimit se Lisi ishte themeluar nga Dionisi i Sirakuzës, bëjnë pyetjet: Cili nga këto mure të stileve të ndryshme është ndërtuar nga Dionisi? dhe cili është para tij? Në përgjigje të këtyre pyetjeve Bomo thotë se muri i stilit poligonall, në Lis, është më i hershëm se shekulli IV p.e.sonë dhe, duke e krahasuar me muret greke, e daton atë të shekullit V p.e.sonë. Kurse për stilin e dytë, ai është i mendimit se mund të jetë vepër e kohës së Dionisit. Skrantonii³, duke i konsideruar të dyja këto stile muresh të kohës së Dionisit, pra edhe të datuara mirë në fillim të shekullit IV p.e.sonë, i merr si shembull të mirëfilltë në klasifikimin stilistik të mureve greke dhe i vendos në kategorinë e dytë të emërtuar «Multilateral», grupi B, Poligonal dhe në kategorinë e dytë «Kuadrilateral» grupi A. Trapezoidal.

G. Novak, i cili, siç u tha, është i bindur se qyteti i Lisis nuk ishte koloni helene por një qytet i mirëfilltë ilir, përpigjet që të përcaktojë edhe kohën e ndërtimit të mureve rrëthuese të tij. Për këtë problem ai ka parasysh faktin që Skylaksi, autor antik, nuk e përmend fare Lisin në veprën e tij të shkruar para vitit 335 p.e.sonë, kështu që mendon se në këtë kohë Lisi nuk njihet si 'koloni e Sirakuzës 'dhe as që ishte një qytet i fortifikuar. Nga ana tjetër, ky autor, duke përmendur datën 213 p.e.sonë, kohë në të cilën sipas Polibit, Lisi ishte një qytet shumë mirë i fortifikuar, arrin në përfundimin 'se në mes të këtyre datave (335-213 p.e.sonë) duhet të jenë ndërtuar edhe muret rrëthuese të qytetit të Lisis.⁴

Për t'u përmendur janë edhe botimet e para të rezultateve të gërmimeve arkeologjike dhe të punimeve restauruese të kryera në Lezhë gjatë viteve 1968-69 ku, ndër të tjera,

1 C. Praschiker — A. Schöber, *Archaologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, Wien, 1919, f. 14.

2 R. L. Beaumont, *Greek influence in the Adriatic*, në *Jurnal of Hellenic Studies*, L VI, 1936, f. 202.

3 R. L. Scranton, *Greek Walls*, Cambridge, 1941, f. 84.

4 G. Novak, *Vep. e cit.*, fq. 111-126.

problemët, deri në ato kohë të diskutueshme, si përkatësia etnike ilire e Lisit dhe datimi i mureve të tij, analizohen hollësishët dhe gjunjë zgjidhje të drejta të argumentuara nën dritën e zbulimeve dhe të fakteve të reja e të panjhura deri në atë kohë.¹

Muret rrighthuese të qytetit të Lisit, të ngritura në kohën ilire, janë nga ana tekniko-stilistike të njëlllojta, kurse nga ana ndërtimore ato paraqesin një zhvillim progresiv të bazuar në traditat e periudhave më të hershme. Stili i dytë, që dallohet nga Prashniker e Shober, siç do të shihet në vazhdim, përfshin rindërtimë të sistemit të fortifikimit të Lisit, të bëra në kohën romake.

Muret rrighthuese të qytetit të Lisit, të para nga ana ndërtimore, tregojnë si përmundësitet ekonomike ashtu edhe për pjesëmarjen e një armate me njerëz të specialiteteve të ndryshme: projektues, konstruktorë, mjeshtër të ndërtimit, gurgdhendës, muratorë dhe punëtorë të ndryshëm. Për ndërtimin e të gjithë sistemit të fortifikimit të Lisit dhe të Akrolisit kanë qenë ngritur një numër kantieresh të specializuara për nxjerrjen e gurëve, për copëtimin dhe për gdhendjen e tyre në bloqe me forma e me përimasa të ndryshme si edhe për ndërtimin e mureve. Në këtë drejtim duhen përmendur edhe metalurgët dhe specialistët për shkrirjen dhe për prodhimin e veglave të punës prej hekuri si: leva të madhësive të ndryshme, vare, çekanë e dalta të shumëllojshme. Prodhami i këtyre veglave në sasi të mëdha dhe sidomos kalitja e tyre presupozon praninë e mjeshtërive të ndryshme të metalurgjisë.

Për të krijuar një ide të përafërt mbi punën e madhe që është bërë për ndërtimin e mureve mbrojtëse të këtij qyteti janë nxjerrë. disa të dhëna, të cilat kanë dalë nga përllogaritje të bazvara në burimet që ofrojnë gjurmët e mureve rrighthuese. të kullave dhe të hyrjeve të shumta iëruajtura deri në ditët tona. Për këtë gjë është marrë përbazë gjatësia e mureve (2500 m) gjerësia e tyre (3.50 m) dhe lartësia e nxjerrë nga të dhëna të tërthorta (rreth 8 m).

Për të ndërtuar një vëllim murature të tillë me gurë

¹ F. Prendi — K. Zheku, «Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike», *Monumente*, 2, 1971, fq. 7-17; «Qyteti ilir i Lisit, origjina dhe sistemi i fortifikimit të tij», «*Studime historike*, 1, 1971, fq. 155-168.

të gdhendur, për dy faqet e murit, janë nxjerrë nga guroret e ndryshme rrëth 100 000 m³ gurë prej të cilëve janë gdhendur në forma e në përmasa të ndryshme më tepër se 80 000 copë bloqe.

Në qoftë se do të kërkohej për t'u ditur me afërsi, se për sa kohë është ndërtuar i gjithë ky fortifikim dhe sa specialistë e punëtorë kanë marrë pjesë në këtë vepër kaq madhështore, atëherë duhej bërë një përllogaritje tjetër. Meqënëse për këtë llogaritje faktori kohë është në raport të zh drejtë me numrin e fuqisë punëtore që merr pjesë, atëherë për një periudhë pesëvjeçare del se kanë marrë pjesë rrëth 800 deri 1000 specialistë të ndryshëm, si gurgdhenës, muratorë hekurpunues dhe 1800-2000 punëtorë të ndryshëm.

Nga ana tjetër, duhet thënë se për prodhimin e veglave të ndryshme prej hekuri, që janë përdorur në këtë vepër, është shkrirë e është përpunuar rrëth 20 ton hekur.

Gjithë kjo punë e madhe që është bërë pasqyron në mënyrë të dukshme sa mundësitet ndërtuese aq edhe forcën ekonomike dhe shkallën e zhvillimit kulturor që kishte arritur qyteti i Lisit në këtë periudhë.

6. Mbi arkitekturën dhe artin

Nga periudha e lulëzuar e qytetit ilir të Lisit, përvec ndërtimeve madhështore të sistemit mbrojtës të qytetit që u përmendëm, me interes është të vihet në dukje edhe një monument, i cili u gjet në mes të kishës, katedrale të shën Kollit, gjatë gërmimeve arkeologjike, që u bënë në vitin 1978. Pjesët e ruajtura të këtij monumenti përfaqësojnë shkallën e një bazamenti, mbi të cilin mendohet se qëndronte një statujë monumentale. Bazamenti i zbuluar ka formën e një drejtkëndëshi, me përmasa 1.96 x 2.86 m. Ai është i vendosur me aks gjatësor veri-jug, paralel me rrugën kryesore të qytetit, rrëth 20 m në perëndim të saj.

Vendosja e këtij bazamenti kundrejt rrugës dhe hyrjes kryesore të qytetit të poshtëm tregon për një vend të zgjedhur, ndoshta në mes të një sheshi të vogël, në mënyrë që

monumenti i vendosur këtu të binte në sy, menjëherë pas hyrjes në qytet.

Pjesa e ruajtur e bazamentit është ndërtuar me bloqe gurësh të skuadruar e të gdhendur, me faqe të sheshta. Nga dy këmbëshkallët e para që ruhen nga ky bazament mund të nxirren këto përmasa: lartësia e shkallës së parë duhet të ketë qenë 0,29 m dhe gjërsia e saj 0,15 m, ndërsa shkalla e dytë 0,25 m e lartë dhe 0,13 m e gjërë. Me këto përmasa shkallët sillen përreth bazamentit. Bloqet e gurëve të tyre janë vendosur në të thatë dhe lidhen nga sipër, njëri me tjetrin, me ganxha hekuri, të vendosura në kanale e në gropat e posaçme me anë të plumbit të shkrirë. Fakti se në të njëjtën mënyrë janë lidhur edhe bloqet e pilastrave të portave të hyrejas kryesore, bën që të mendohet pér një ndërtim të njëkohshëm të bazamentit me sistemin e fortifikimit të qytetit.

Gurët e shkallëve të bazamentit kanë një sipërfaqe shumë të lëmuar dhe duken që janë djegur nga dielli dhe janë rrahuar nga shira, gjë që tregon se monumenti në kohën e tij, gjendej, në një mjeshtësi natyror të hapur.

Përreth bazamentit të zbuluar janë muret e katedrales së vjetër-vendvarrimit të Skënderbeut, dhe nuk dihet nëse monumenti që ngrihej mbi të bënte pjesë në një kompleks arkitektonik apo ishte i vetëm në mes të një sheshi të qytetit.

Gjatë punimeve që janë bërë në zonën e qytetit të po-shtëm është gjetur një copë e vogël, pjesë e një skulpture të punuar në mermer të bardhë. Pjesa skulpturale e ruajtur ka formë thuajse cilindrike dhe në sipërfaqen e saj dallohen gjurmët e palave të një rrobe që e mbulonte këtë pjesë. Kjo copë mermeri e gdhendur duket se është pjesë e thyer nga një skulpturë, trupore akoma e paidentifikuar, por që mund të supozohet se i përkiste skulpturës së vendosur mbi bazamentin e përmendorur.

Nga arkitektura e ndërtimesave monumentale të qytetit të Lisit deri më sot është gjetur një kapitel i stilit dorik. Ky kapitel, i zbuluar në shtresa të periudhave më të vona, është një dëshmi tepër e paktë, po të merret parasysh se në qytete të tjera të vendit tonë (Apoloni, Durrës etj.) gjetje të tillë janë të shumta si në numër ashtu edhe në llojshmërinë e tyre. Rrjedhimisht edhe njohuritë lidhur me zhvillimin arkitektonik në këtë qytet mbeten akoma të kufizuara.

Nga ana tjetër, edhe krijimtaria artistike e Lisit është gjithashtu shumë pak e përfaqësuar në gjetjet arkeologjike.

Për t'u menduar në këtë fushë është një altoreliev, që është gjetur jashtë qytetit, në rrënojat e një kishe. Në këtë alto-reliev paraqitet një figurë mitologjike: Erosi në moshën fëmijërore, i gdhendur mbi një pllakë mermeri të bardhë. Ky Eros, perëndia e dashurisë, është paraqitur me krahë gjysmë të hapur, i shtrirë, në pozicion fjetjeje. Për sa u takon vlerave artistike të kësaj vepre, duket se ajo është mjafët e arritur dhe dëshmon për një artist të sprovuar në këtë gjini artistike (foto 11).

Meqenëse u fol për gjetjen artistike, është rasti të përmendet edhe diçka tjeter, që lidhet më tepër me shprehje të ndjenjave të mjeshtërve gurgdhendës ilirë, trashëgimi i të cilave ruhet edhe sot nga mjeshtërit e ndërtimeve popullore të vendit tonë.

Në murin verior të qytetit të mesëm, mbi sipërfaqen e një bllok guri, është dikuar një figurë njeriu e gdhendur me majën e daltës. Në këtë figurë dallohen vijat kryesore të përkufizimit të një trupi të një njeriu që qëndron në këmbë. Në pamjen e përgjithshme figura ka përmasa shumë të vogla (rreth 15 cm) dhe paraqet një burrë me shtat mesatar, me një brez në mes dhe me qeleshe në kokë.

Kjo figurë e gdhendur përfaqëson veprën e parë, nëse mund të thuhet kështu. që trashëgohet nga mjeshtërit ilirë, pjesëmarrës në ndërtimin e sistemit të fortifikimit të qytetit të Lisisit.

Është me interes të përmendet edhe një kallëp prej balte të pjekur, i cili ka shërbyer përi riprodhimin e figurave të ashtuquajtura terrakota, po me baltë të pjekur. Këto figura, të prodhuara nga artizanati, në përmasa të vogla, ishin me karakter votiv e mitologjik dhe vendoseshin në tempuj të ndryshëm.

Nga kallëpi që është gjetur mund të riprodhohet edhe sot një skenë mitologjike, në të cilën paraqitet, në miniaturë, një kompozim me tri figura të vendosura në mes të një sfondi të inkadruar me elemente zbuluruese, të përdorura në arkitekturën monumentale të kohës së lashtë. Në një riprodhim të nxjerrë nga ky kallëp kanë dalë shumë të qarta dhe të plota tri figurat e skemës kryesore, zbulurimet në kornizën e poshtme e të sipërme si edhe zbulurimi i fushës trekëndore, i kulmarit të figurës arkitektonike që përkufizon skejnën. Pjesët arësore të kallëpit janë të thyera, por megjithatë, po të merren parasysh përmasat e vogla (8,0 cm x 8,5 cm), vendosja e skenës dhe elementet zbuluruese, mund të men-

dohet se në rastin e dhënë paraqitet pamja ballore e një altari përkujtimor në shkallë të zvogëlluar. Ky kallëp i gjetur në qytetin e Lisisit, megjithëse i vetëm, dëshmon pér zhvillimin e prodhimeve artistike në baltë të pjekur të një niveli me atë të qyteteve fqinjë: Dyrrah. Apoloni etj. (foto 12).

Këto gjetje janë me të vërtetë të pakta e të ndryshme, pra edhe të pamjaftueshme pér të krijuar një ide të pér-afërt mbi shkallën e zhvillimit të arkitekturës dhe të artit në qytetin e Lisisit, por duhet pasur parasysh se objektet e përmendura janë gjetjet para, dhe se gjermimet e porsafilluara në zonën e qytetit të poshtëm, mendohet se në të ardhmen do të nxjerrin edhe materiale të tjera më të shumta.

7. Jeta ekonomiko-shoqërore e qytetit

Njohja e zhvillimit të qytetit dhe e jetës qytetare në Iliri është një problem me rëndësi pér njohjen e bazës ekonomike e shoqërore, mbi të cilën formohet e zhvillohet shteti dhe shoqëria ilire.

Nga gjermimet arkeologjike të kryera në një numër qytetesh ilire të vendit tonë, përfshirë këtu edhe ato të kryera në Lisi, janë bërë të njohura aspekte të atyre kushteve, në të cilat lindën dhe u zhvilluan qytetet ilire në vende e në periudha të ndryshme. Në bazë të këtyre studimeve është konstatuar se përgjatë rrugës së lindjes dhe zhvillimit të qytetit ilir, dallohen dy etapa historike të rëndësishme¹. Etapa e parë i përket shekullit V dhe gjysmës së parë të shekullit IV p.e.sonë. Kësaj periudhe i përkasin edhe qytetet ilire më të lashta si: Thronion, Pelion, Damastion etj., që përmenden nga autorë të historisë së lashtë.²

Qyteti i Lisisit është një ndër ato qytete që u ndërtuan

1 S. Islami, «Lindja dhe zhvillimi i jetës qytetare në Iliri», *Iliria*, II, fq. 7-20, Tiranë, 1972; F. Prendi, «Urbanizimi i Ilirisë së Jugut», *Kuvendi i Studimeve Ilire* (Tiranë, 15-20 shtator), I, 1974, f. 107-122.

2 Paus, V, 22.2.4, Diod. XVI, 697.

në etapën e dytë, në mes viteve 335-230 p.e.sonë, kohë në të cilën zhvillimi i jetës qytetare shtrihet edhe në krahinat bregdetare të Ilirisë.

Procesi i lindjes së këtij qyteti, siç u pa, është rezultat i zhvillimit të mëtejshëm të vendbanimit të fortifikuar paurban, në të njëjtin truall, por në kushte ekonomike e shoqërore më të përparuara.

Fillimisht jeta qytetare u zhvillua duke u bazuar kryesisht në zhvillimin e bujqësisë e të blegtorisë, bazuar në toka fushore shumë pjellore dhe në kullotat e mira, që i ofronin kodrat dhe malet, të cilat ishin shumë afër qytetit. Në kohë më të vona qyteti i Lisisit e mbështeti ekonominë e tij në zhvillimin e degëve të ndryshme të artizanatit, në tregtimin e mallrave të prodhuara prej tij dhe në të ardhurat që nxirreshin nga sektorë të tjera.

Në bazë të të dhënave arkeologjike të këtij qyteti, një zhvillim të madh e të rëndësishëm kishin marrë sektorët e nxjerrjes dhe të përpunimit në vend të materialeve të ndërtimit: gurë, tulla, qerpiçë, tjegulla, lëndë druri, gozhda, gancha etj. Një sektor tjetër, që ka lënë gjurmë të shumta, është edhe ai i poçerisë, i cili siguronte me prodhime vendi pjesën më të madhe të enëve të përdorimit të përditshërm dhe të atyre që nevojiteshin për depozitimtin dhe për transportimin e prodhimeve bujqësore e blegtoriale.

Punishte të degëve të artizanatit zhvillonin një veprimtari të gjërë në përpunimin e lëndëve të para, si: metale të ndryshme, lëndë druri, lesh etj., duke prodhuar prej tyre respektivisht: vegla pune, pajisje të ndryshme, tekstile, veshmbathje etj.

Kjo veprimitari e zhvilluar në sektorët më të rëndësishëm dhe njëkohësisht në shumë fusha të tjera krijoj mundësinë që të zhvillohet një ekonomi e shëndoshë dhe një shoqëri e kulturuar e një niveli me atë të qyteteve të tjera ilire, që ishin fqinjë me të.

Të dhënët e drejtpërdrejta dhe të tërthorta tregojnë gjithashtu edhe përbërjen shoqërore të popullsisë së këtij qyteti, që lidhej me degë të ndryshme të veprimtarisë prodhuase ose të aktiviteteve të tjera, si: zejtarë, ndërtues, pronarë tokash, detarë etj.¹

1 F. Prendi, *Aspects de la vie sociale économique et culturelle de Lissus*, Posebna Izdanja, k. XXIV, Sarajevo, 1975, fq. 149-159.

Forca e madhe e veprimtarisë ndërtimore, e cila përfaqësohet aq fuqishëm në sistemin mbrojtës të qytetit, në ndërtimet e tjera nuk ruhet pothuaj aspak. Gjurmë të materialeve të ndërtimit, si tulla e tjegulla të thyera, janë të pranishme por jo në sasi të mëdha, si në gjermimet arkeologjike ashtu dhe në sipërfaqe të terrenit. Tullat janë të punuara me dhe argjilor. Mbas pjekjes brumi i tyre ka marrë ngjyrë të kuqe të fortë. Përmasat e plota dhe formati i tyre nuk dihen. Më të qarta janë të dhënët që mund të nxirren nga copat e tjegullave të gjetura. Ato janë të dyllojshme, të sheshta, me brinjët e gjata të ngritura dhe të harkuara me kurriz. Këto të fundit shërbejnë për të mbuluar vijat e bashkimit të tjegullave, të cilat, gjatë vendosjes së tyre në çati, mbulojnë njëra-tjetrën në shkallëzime. Nga pikëpamja tipologjike ato janë të ngjashme me tjegullat solene. Të tillë janë gjetur në Durrës, në Apoloni dhe në qytete të tjera ilire.

Tjegullat janë të punuara me baltë të pastër, të përzier me shamot. Për të arritur saktësinë e përmasave dhe formën e duhur janë modeluar në kallëpe të posaçme prej guri. Profilet e brinjëve gjatësore të tjegullave janë të formave të ndryshme: trekëndëshe, me dy brinjë të drejta dhe një të lakuar.

Një copë tjegulle e gjetur në Lis mban në sipërfaqen e sheshtë të saj vulën e pronarit të punishtes, me emrin EOPTAIO, të shkruar në gjuhën greke. Ky është një emër ilir i njojur edhe nga monedhat edhe nga gurë varresh të zbuluar në Durrës.

Duke u bazuar në veçoritë karakteristike të shkronjave, kjo vulë është datuar rrith shekullit III p.e.sonë, gjë që përpunhet me disa fragmente të tjegullave me kurriz. Këto tjegulla kanë ngjashmëri me disa nga tipat e njojur të Apollonisë, që janë përdorur gjatë shekujve IV-II p.e.sonë. Kohët e fundit është gjetur një tjetër fragment tjegulle, e cila ruan pjesën e mesit të një vule, ku me vështirësi dillohet vetëm gërrma N, kurse të tjerat janë fshirë.

Tjegulla e vulosur EOPTAIO, që është gjetur vetëm në Lis, tregon tërthor për prodhimin në vend jo vetëm të tjegullave, por edhe të tullave.

Prodhimtaria e sektorit të poçerisë përfaqësohet më shumë me copa enësh, me parete të trasha si qypa të mëdhenj, që përdoreshin për depozitim e prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe të shtamave të mëdha, amforat, të cilat për-

doreshin për ruajtjen dhe për transportimin e verës, të vajit, të ujit etj.

Nga pjesë të qypave të gjetur del se ata kanë qenë të zokonshëm, të njojur nga qytetet e tjera, ku janë zbuluar edhe të plotë. Ata kanë pasur forma sferike: me bark të fryrë, me qafë të shkurtër, me grykë të rrumbullakët, me diametër rreth 15-20 cm, buzë të sheshta e të gjera, fund të dalë në formë cilindrike me diametër 10-15 cm dhe një lartësi 8-10 cm. Këta qypa kanë qenë të punuar me baltë të përziera me rërë të hollë kuarci. Duke u bazuar në një numër romak IIIC.=97, të gjetur në një buzë qypi të thyer, mund të mendohet se në këtë mënyrë tregohet pesha e drithit që mund të futej brenda në qyp. Por edhe trashësia e vetë grykës tregon për një enë me peshë e vëllim të madh.

Shtamat ose amforat, sikurse u përmend, përbëjnë pjesën më të madhe të materialit të poçerisë, që gjendet kudo e me shumicë në qytetin e Lisis. Këto amfora kanë qenë në përgjithësi të një madhësie dhe për sa i përket vëllimit të brendshëm të tyre mendohet se ai ka qenë standard, i njojur në tregti si për trupat e ngurtë ashtu edhe për ata të lengët. Format e amforave, që përfaqësohen në Lis, janë të shumëllojshme, aq sa kategorizimi i tyre në këtë drejtim është pothuajse i paarritshëm, për më tepër kur eksemplarë të plotë të këtyre amforave janë gjetur vetëm 5-6 copë, edhe këto të thyera ose të plasura në shumë vende.

Veçoritë karakteristike të këtyre amforave vërehen në trajtimin e formës vezake të trupit, në disa ekzemplarë ku fundi vezak është trajtuar në pjesën e poshtme, ndërsa në të tjerë në pjesën e sipërme të trupit. Vjegat e amforave janë të holla e të gjata; kur qafa është e gjatë ato janë më të trasha e më të shkurtra, (tab I) ndërsa kur ajo është e shkurtër trupëzimi i buzëve është i shumëllojshëm. Ka që janë me buzë të holla e me profil të rrumbullakët, të sheshta, të pjerrëta dhe të shpërvjela në qafë në formë golfi. Amforat mbylleshin me nga një kapak të rrumbullakët, të punuar po prej balte të pjekur, në formën e një pjate të vogël. Në pjesën e sipërme janë të ngritura në trajtë sumbulle, nga ku ka-peshin për hapjen e mbylljen e amforave. Kapakët në pjesën e sipërme janë të vulosur me motive gjometrike të ndryshme si edhe me emra të shkruar në formë rrithi. (tab. II. III.).

Karakteristika të veçanta paraqiten edhe në trajtimin fundor të amforave. Ato me bark të zhvilluar në pjesën e

poshtme të trupit përfundojnë me fund me majë të trashë e të shkurtër, të tjerat, që kanë zhvillim të kundërt, kanë funde të gjata e të holla. Të gjitha amforat me funde të tilla luteshin pjesërisht në tokë ose vendoseshin në trekëmbësha të posaçëm, në të kundërt nuk mund të qëndronin drejt në këmbë.

Për sa i përket vendit të prodhimit, amforat dallohe-shin veçanërisht nga vulat e punishteve të prodhimit, të cilat janë gjetur në kapakët, në buzët e amforave ose në pjesën e sipërme të vjegave të tyre. Vulat, siç u pa, te kapakët janë në formë simbolesh në formë monogramesh etj., kurse vulat që gjenden në buzët dhe në vjegat e amforave janë në formë drejtkëndore dhe në ndonjë rast të rrumbullakët e me germa në relief. Vulat, në këtë rast si vegël pune, ishin të gdhendura në copa druri, dhe enët vu-loseshin para pjekjes së tyre kur balta ishte akoma e njomë.

Vulat zakonisht mbanin emrin ose edhe mbiemrin e pronarit të punishes; ishin të shkruara me germa të mëdha uë një ose në dy rresha, në gjuhën greke e latine. Të tilla janë gjetur në Lis në më tepër se 100 copë të ndryshme. Rreth 50 copë prej tyre janë gjetur të plota e të lexueshme mirë. Studimi i tyre përbën një temë me shumë interes për të dalluar në radhë të parë prodhimin vendas dhe së dyti, prejardhjen e tyre nga qytetet e tjera. (tab. IV).

Ndër këto vula, janë gjetur dy të tilla në gjuhën greke. Në njérën prej tyre lexohet emri i prodhuesit dhe muaji ΕΠΙΑΝΗΣΙΔΑΜΟΥΔΑΛΙΟΥ. Kjo vulë me dy rreshtha është gjetur mbi një dorezë, që ruan pjesërisht edhe buzën e amforës. Forma e dorezës dhe ajo e buzës janë karakteristike për amforat e ishullit të Rodit, të njoitura mirë prej amforave të plota, që janë gjetur në Durrës dhe në Apoloni, të cilat datohen në fund të shekullit III ose në fillim të shekullit II p.e.sonë. Një tjetër vulë e rrumbullakët, me një mbishkrim përreth, ku mezi dallohen shkronjat e emrit ΔΙΟCOYPIΔA. Në mesin e kësaj vule duket një lule shege, gjë që bën për të menduar se edhe kjo është me prejardhje nga Rodi.

Vulat e tjera, të gjitha me shkronja latine, tregojnë për kohë të mëvonshme, kur ndikimi i gjuhës latine hidhet përtëj detit në brigjet lindore të Adriatikut. Amforat, që mbajnë këto vula, pjesërisht janë të ardhura, por duhet menduar se edhe një pjesë e tyre është prodhuar në vend. Kjo vërtetohet nga vulat që mbajnë emrat ilirë: GENT dhe

SURI, pronarë të punishteve vendase. Po me emrin Genti eshtë zbuluar edhe një vulë tjetër në Durrës. Amfora që mban këtë vulë ka mundësi që të jetë prodhuar në Lis.

Përcaktimi tipologjik apo kategorizimi kronologjik i amforave të gjetura në qytetin e Lisit eshtë gjithashtu një problem me rëndësi për t'u studiuar.

Enët e përdorimit të përditshëm për gatim dhe ngrënje janë të punuara me çark nga punishte të posaçme.

Në pjesën më të madhe këto enë riprohujnë tipa të njojur edhe në qytete të tjera ilire, sidomos në Durrës. Enët më tipike të Lisit janë brokat me dorezë të përdredhur, filxhanët sferikë me një vjegë në formë unaze, e ngjitur në buzë në drejtim horizontal si dhe ato me vjega vertikale. Në Lis janë gjetur edhe fragmente të brokave me vjeza të ngritura mbi buzë në formë briri, të njoitura gjithashtu edhe në qytete të tjera.

Por enët e tjera, si pjata filxhanësh etj., të zbukuruara me motive lulesh, të pikturuara me ngjyrë të bardhë e rozë, me kanelyrë të tipit Gnathie, fragmente të enëve të tipit «Megarë» dhe për ato me qeramikë gri që përfaqësohen në Lis, janë shprehur mendime se janë të sjella nga qyteti i Durrësit.¹

Përpunimi i metaleve, prodhimi i veglave të ndryshme dhe i pajisjeve të tjera të nevojshme në ndërtim e gjetkë zhvillohej në degë të ndryshme të artizanatit të qytetit të Lisit. Në portat e mëdha, të ndërtuara me trarë e me dërrasa të trasha, janë gjetur gozhdë të madhësive nga 5 cm deri 25 cm. Nga gozhdët e gjetura të kthyera në 2-3 vende, dalin edhe trashësitë e lëndës së drurit të përdorur në ndërtimin e këtyre portave. Trarët që përbënë skeletin e portave ishin rrëth 12 cm të trashë, binarët përforcues 7 dhe 9 cm. dërrasat e kanateve 4 cm të trasha etj. Dy gozhdë të vogla me kokë plloçake, që u gjetën të futura nën një rrip hekuri, të gjerë 6 cm, në largësi 7 cm njëra nga tjetra, tregojnë përmenyrën e përforcimit dhe njëkohësisht përzbuchurimin e pamjes së jashtme të portave të Lisit. Janë gjetur edhe vegla të tjera prej hekuri, si një daltë 27 cm e gjatë, me trup të rrumbullakët, me majë të mprehtë, me teh të gjerë.

1 F. Prendi, Aspect..., Vep. cit.

Kjo daltë duket se ka pasur dorezë druri në pjesën e sipërme, gjë që tregon se ajo ka qenë vegël për daltime në dru. Dy spadola prej hekuri, njëra me teh të gjerë, tjetra me majë në formë mistrie, që kanë pasur doreza druri, duken më tepër si vegla të përdorimit shtëpiak.

Hekuri ka qenë në përdorim edhe për farkëtimin në vend të armëve të ndryshme. Këtë gjë e tregojnë majat e shigjetave, të heshtave, të hanxharëve e të thikave të ndryshme, që janë gjetur si në qytet ashtu edhe në afërsi të tij. Për t'u përmendur është tipi i hanxharit, i cili, me gjithëse në formën e përgjithshme është i ngjashëm me hanxharin e njohur ilir, në kokën e dorezës është i ndryshëm. Kjo veçori ndoshta tregon për një variant të tipit lokël.

Objektet prej bronzi, përfaqësuese të punishteve të një artizanati me tradita të lashta, në periudhën qytetare të Lisit janë të pakta por me iteres. Në përgjithësi, ato janë objekte të vogla zbukurimi, si: fibula, byzylykë, unaza, gjilpëra, grepa peshkimi, thumba e gozhdë të vogla. (Tab. V).

Fibulat e gjetura në Lis, sipas F. Prendit, bëjnë të mundur inkuadrimin e fizionomisë së kulturës qytetare të Lisit, sidomos për fundin e shekullit III dhe shekullit II p.e.sonë. Me interes janë fibulat me dy gjilpëra të tipit «Heshtë» dhe ato kardioformë. Këtu janë gjetur edhe fibula të periudhës së Gentit me këmbë të përthyera dhe me hark të gjerë, të cilat janë konsideruar si tipi bazë nga ku ka evoluar në kohë të mëvonshme fibula e njohur e Kamanit. Në qytetin e Lisit ekzistonin edhe punishtet e prerjes dhe të stampimit të monedhave prej bronzi, sikurse vërtetohet nga vetë monedhat autonome të Lisit.

Si objekte të punuara me plumb mund të përmenden 15 copë plumbçe muratori, të cilat kanë formë piramidale prizmatike, që në pjesën e sipërme kanë nga një vrimë për kalimin e spangos. Plumbi është përdorur edhe për arnimin apo për ngjitjen e qypave dhe të amforave të thyera ose të krisura. Me plumb janë fiksuar dhe çernierë prej bronzi të portave dhe të ganxhave prej hekuri, që përdoren në lidhjen e bloqeve të gurëve. Këtë gjë e tregojnë gjurmët e gjetura në portën kryesore të qytetit të poshtëm.

Lidhur me veprimtarinë ndërtimore të zhvilluar në qytetin e Lisit, për t'u përmendur është fakti që këtu ushtron te profesionin e arkitektit Hieroni, i biri i Leonit. Kjo vërtetohet nga guri i varrit të tij i gjetur në këtë qytet.

Nisur nga karakteri i mbishkrimit në gjuhën greke, i formulës së dedikimit dhe i formës së gurit, ky varr i takon shekullit II p.e.sonë. Duhet theksuar se deri më sot është i vetmi njoftim që bën fjalë për një arkitekt, i cili ka pnuar në një qytet ilir të kohës së lashtë.

Të konsiderueshme janë gjetjet e peshoreve prej balte të pjekur në formë koni me vrimë në majë, të cilat shërbenin për thurjen e rrjetave dhe të tekstileve të ndryshme.

Krahas gjithë këtyre aktiviteteve zejtare, për t'upermendur është gjuetia e peshkut dhe e kafshëve të egra, në veçanti e drerit dhe e derrit të egër, që kanë lënë gjurmë të shumta si në kocka, brirë e në dhëmbë. Janë gjetur edhe vegla të ndryshme prej kocke ose prej briri.

Zhvillimi ekonomik e kulturor i qytetit ishte gjithnjë në rritje, deri në fund të tri dekadave të para të shekullit II p.e.sonë, kohë në të cilën ndodhën ndryshime të rëndësi-shme në strukturën politiko-ushtarake të Ilirisë.

Pas rënies së mbretërisë së Gentit (168 p.e.sonë) pustuesit romakë i ndanë tokat e shtetit aridan në tri njësi administrative të vogla dhe në njëren prej tyre qyteti i Lisit caktohet si qendër krahinore, me kufi nga lumi i Matit e Idri në kufirin jugor të labeatëve.

Pas këtyre ngjarjeve, siç do të shihet në vazhdim, jeta në qytetin e Lisit zhvillohet në kushte e në rrethana të tjera

8. Monedhat e qytetit të Lisit

Organizimi politik dhe ekonomik i qytetit të Lisit fillimisht mbështetej në shoqërinë fisnore dhe në sistemin tregtar të shkëmbimit të mallrave në natyrë ose edhe të objekteve me vlerë, që kryenin funksionin e parave akoma të pavëna në përdorim. Në këto rrethana marrëdhëniet tregtare që kishte qyteti me botën e jashtme ishin të kufizuara. Tregtia në këtë periudhë bëhej me anën e monedhave të qytetit të Dyrrahut dhe të Apolonisë. Për një veprimtari të tillë tregojnë edhe zbulimet arkeologjike që do të parashtronin më poshtë:

Në qytetin e Lisit gjatë gërmimeve arkeologjike, puni-

meve restauruese dhe në sipërfaqe të terrenit janë gjetur mbi 200 copë monedha prej bronzi. Ato paraqiten të ndryshme për nga forma, nga përmasa dhe nga pesha e tyre. Ndër këto monedha janë jo vetëm ato të qytetit të Lisit, por edhe të qyteteve të tjera: Durrësit, Apolonisë, Shkodrës etj., të prera e të vëna në qarkullim në kohë të ndryshme. Nga e gjithë sasia e këtyre monedhave, pjesa më e madhe e tyre janë të dëmtuara ose të oksiduara, aq sa nuk mund të përcaktohet prejardhja e tyre. Nga monedhat e lexueshme e të identifikuara më të shumtë janë ato të Durrësit, të cilat paraqiten me legjendën e qytetit të shkurtuar «ΔΥΡ». Ato kanë qenë përdorur pér një kohë të gjatë që nga shekulli III p.e.sonë.

Në radhën e dytë janë monedhat e vetë qytetit të Lisit, ndër të cilat më të shumtë janë ato të tipit mburojë-përkrenare. Pas këtyre, në numër të konsiderueshmë janë edhe monedhat e qytetit të Apolonisë të tipave të ndryshëm.

Monedhat e qyteteve të Shkodrës, të cilat janë prerë së bashku me ato të Lisit, janë shumë të rralla në krahasim me ato të qyteteve të përmendura. Me nga një monedhë përfaqësoshet qyteti i Amanties dhe i Orikutit.

Duhet shtuar se janë gjetur gjithash tu edhe monedha me emrin Ballaios (ΒΑΛΛΑΙΟΣ), i cili supozohet të ketë qenë mbret ilir. Këto monedha, sipas H. Cekës, janë prerë në vitet 167-135 p.e.sonë.

Nga gjetjet e këtyre monedhave të vjetra krijohet një ide e qartë e zhvillimit ekonomik dhe e marrëdhënieve tregtare në qytetin e Lisit. Nga ana tjetër, këto të dhëna tregojnë se ky qytet ishte i lidhur më tepër me qytetet më të zhvilluara të Jugut (Dyrahu e Apoloninë) dhe me pak me ato të Veriut.

Prerja e monedhave autonome nga vetë qyteti i Lisit është bërë në një kohë kur qyteti arriti një zhvillim ekonomik e shoqëror më të ngritur dhe kur marrëdhëni tregtare filluan të zhvillohen më shumë me qytetet e tjera bregdetare, në të dyja brigjet e Adriatikut dhe të Jonit.

Këto marrëdhënie arrijnë që të zhvillohen deri edhe me ishujt më të largët të Egjeut, të Rodit etj.

Monedhat e para të Lisit, sipas numizmatëve, kanë qenë të njëlllojta me ato të qytetit të Shkodrës. Në faqen krysore të tyre ishin vënë simbolet figurative: mburoja e rrumbullakët ilire dhe në shpinë një përkrenare e tipit ilir së bashku me legjendën Lisisitan (të shkruar greqisht ΛΙΣΣΙΤΑΝ).

Studimet e hollësishme që janë bërë rrëth problemit të numizmatikës së Ilirisë, nga arkeologu e numizmati i mirënjo-hur Hasan Ceka, vërtetojnë se prerja e monedhave autonome, në qytetin e Losit është bërë rrëth vitit 228 p.e.sonë¹. Në këtë drejtim ka ndihmuar edhe tradita e përpunimit të metaleve të nxjerra nga minierat, që ndodheshin në afërsi të Losit si edhe zhvillimi i zejtarisë së metalpunuesve.

Periudha e dytë e vënies në qarkullim e një serie monedhash të reja lidhet me kohën e sundimit të mbretit Gent (197-168 p.e.sonë). Në faqe të këtyre monedhave është vënë portreti i mbretit, që mban një kapele karakteristike mestrehë të gjatë, e ashtuquajtura «Kausia». Në shpinë të tyre është një anije ilire, e shoqëruar me legjendën ΛΙΣΣΙ-TAN. Mbasi Gentit, qyteti i Losit pret një seri të tretë monedhash, në faqen e të cilave përfytyrohet koka e hyjit mitologjik Hermes, kurse në shpinë figuron një anije ilire me legjendën ΛΙΣΣΙ-TAN. Anija liburne, simbol i monedhave të Shkodrës dhe të Losit, ishte ndër anijet më të shpejta të kohës së lashtë, e përdorur nga fisi ilir i labeatëve.

Nga gërmimet arkeologjike si edhe nga gjetje të rastit është vërtetuar edhe një tip tjetër, i cili dallohet nga të gjitha monedhat e tjera të Losit, që u përmendën. Për këtë tip monedhash studiues të ndryshém nuk janë të një mendimi as për kohën e prerjes as edhe për kohën e vazhdimit të qarkullimit të tyre. Hasan Ceka, këto lloje monedhash, në faqen e të cilave figuron një dhi dhe në shpinë të tyre simboli i rrufesë si dhe legjendën e njohur Lisan tan ΛΙΣΣΙ-TAN duhet t'i përkasin periudhës më të hershme të prerjeve monetare të qytetit të Losit, dhe pikërisht kohës ndërmjet viteve 229 deri më 213 p.e.sonë.

Burimet historike tregojnë se në këtë kohë qyteti i Losit shkëputet nga mbretëria e Teutës për një periudhë të shkurtër 15-vjeçare.

Monedhat e Losit së bashku me ato të Shkodrës janë marrë në shqyrtim në një studim të veçantë edhe nga S. Islami, i cili, duke pasur parasysh botimet e mëparshme si dhe më tepër se 100 copë monedha të grumbulluara në Muzeun Arkeologjik e Etnografik të Tiranës, mendon se datat e dhëna në botimet e ndryshme duhet t'i nënshtronët një shqyrtimi kritik, si për datën e fillimit të prerjes së

1 H. Ceka, *Probleme të numizmatikës ilire*, Tiranë, 1965, fq. 93-95.

monedhave të këtyre dy qyteteve, ashtu edhe për datimin e tipave të ndryshëm. Mbasi merr në shqyrtim ngjarjet historike të kohës, autori shpreh mendimin se Lisi nuk i ka prerë monedhat e para së bashku me Shkodrën, sepse monedha më e hershme e Shkodrës është ajo që ka në faqe ftyrën e Zeusit dhe në shpinë një anije ilire, poshtë saj një delfin dhe legjendën e qytetit. Këtë monedhë e gjen të ngjashme me atë të Durrësit të tipit Zeus-trekëmbësh, e vënë në qarkullim në fillim të shekullit II p.e.sonë. Kjo analogji e shtyn autorin të arrijë në përfundimin se monedhat e Shkodrës janë vënë në qarkullim pak më parë se mesi i shekullit III p.e.sonë.¹

Nga ana tjetër, duke analizuar simbolet e monedhave të tipit mburojë-përkrenare të prera nga Shkodra dhe nga Lisi njësoj, por që dallojnë nga legjendat e tyre përkatëse, ai i konsideron si të vëna në qarkullim së bashku, para vitit 186 p.e.sonë².

Për monedhën e Lisit të tipit Artemis-rrufe në legjendën e qytetit, S. Islami mendon se është paraardhëse e asaj që pret më vonë mbreti Gent me të njëjtat simbole, por me emrin dhe me titullin e vet në vend të legjendës së qytetit, e cila qëndron, me sa duket, midis kësaj të fundit dhe asaj me dhi e rrufe. Në vazhdim autori thotë, se ka shumë të ngjarë që ajo të jetë prerë në të njëjtën kohë me monedhën e tipit mburojë-përkrenare dhe me këtë rast të jetë bërë edhe zëvendësimi i simbolit të faqes nga dhi në Artemis.

Lidhur me monedhën e Lisit të tipit Gent-anije, që mban mbi krye të figurës së mbretit, prolegjendën ΡΗΛΩΝ dhe legjendën ΛΙΣΣΙ-ΤΑΝ, S. Islami është i mendimit se edhe në këtë rast është portreti i Gentit, në një prerje tjetër, tek e cila mbreti paraqitet më i ri. Për sa i përket kuptimit të mbishkrimit Ridho-n, në faqe të monedhës, për këtë autor mbetet si një çështje e hapur.

Nuk kalon shumë kohë dhe në gjermimet arkeologjike të bëra në Kukës zbulohen monedhat ilire me etnikonin Labiatan-ΛΑΒΙΑΤΑΝ. njëra prej të cilave ka të plotë prolegjendën ΡΗΛΩΝΟΣ³.

¹ S. Islami, Vep. cit., f. 358.

² S. Islami, Vep. cit., f. 358. Duhet thënë se H. Ceka mendon se këto monedha janë prerë rrëth viteve 213-197 p.e.sonë.

³ B. Jubani, «Monedha iliro me etnikonin Labiatav, të zbuluara në Kukës», *Studime historike*, 2 (1972), fq. 173-180.

Mbas këtij zbulimi H. Ceka i rimerr edhe një herë në studim monedhat që kanë faqe të tyre portretin me kausia (të mbretit Gent të Lisit me prolegjendën Ridhon e të labiatëve me Ridhonos). Mbasi shqyrton një sërë argumen-tesh të ndryshme: historike, numizmatike e gjuhësore, arrin në përfundimin se portretet e këtyre monedhave përfaqë-sojnë hyjnинë ilire të detit me emrin Ridho-n. Ky emër, në trajtën që gjendet në monedhat e Lisit, trashëgohet edhe në ditët tona, sipas këtij autorit, në Rodon, kepi i Rodonit, te Muzhli i Skënderbeut. Ky vend që nuk pësoni shumë nga pushtimet e huaja, nuk e ndryshoi edhe shumë toponimin ilir që trashëgonte. H. Ceka është gjithashtu i mendimit se nëpërmjet legjendës Lisan përcaktohet edhe emri i krahinës së Lisit, të cilin Tit Livi nuk e përmend kur përshkruan ndarjen e tokave të mbretërisë së Gentit, në tri krahina të ashtuquajtura autonome.¹

Nga studimet e mësipërme del qartë se qyteti i Lisit ka pasur relativisht një aktivitet të gjërë monetar, duke pasur parasysh ose në këtë qytet janë prerë e janë vënë në qarkullim 6 tipa monedhash të ndryshme për nga forma, nga vlera monetare dhe nga koha e nxjerjes së tyre në treg.

Deri më sot njihen këto monedha të Lisit.

- I. Tipi Dhi-rrufe me legjendë ΛΙΣΣΙ-ΤΑΝ; sipas H.C. rreth 229 p.e.sonë
- II. Tipi Mburojë-përkrenare me legjendë ΛΙΣΣΙ-ΤΑΝ; 213-193 p.e.s., H.C. pas vitit 186 p.e.sonë.
- III. Tipi Artemis-rrufe, legjendë në dy rreshta ΛΙΣΣΙ-ΤΑΝ; sipas S.I. para vitit 186 p.e.sonë.
- IV. Tipi Portret-anije ilire, me legjendë ΛΙΣΣΙ-ΤΑΝ; 197-168 p.e.sonë.
- V. Tipi Artemis-rrufe, në shpinë, ΒΑΣΙΛΩΣ-ΓΕΝΘΙΟΥ (mbreti Gent), 197-168 p.e.sonë.
- VI. Tipi Hyjni ilire ΡΗΔΩ-Ν-anije ilire, ΛΙΣΣΙ-ΤΑΝ; 167-135 p.e.sonë.

Këto ishin pra, monedhat që bënin pjesë në sistemin monetar të Lisit, me anën e të cilave ky qytet zhvilloi marrëdhëni e tij tregtarë, të brendshme e të jashtme, për afro njëqind vjet të kohës më të lulëzuar të tij.

¹ H. Ceka, Le buste du roi Genthius ou bien figure de mythologie illyrienne, *Frappe et ateliers monétaires dans l'antiquité et moyen age*, fq. 29-34, Belgrad 1976.

Për t'u vënë në dukje janë edhe të dhënat që japid këto monedha lidhur me përcaktimin kohor, relativisht të vonë, të prerjes së monedhave të Lisisit, në krahasim me qytetet më të lashta ilire. Nga ana tjetër, del se Lisi i preu monedhat e tij së bashku me Shkodrën, me simbole të njëlllojta por të dallueshme nga legjendat përkatëse të tyre. Këto fakte duhet thënë se janë me interes, sepse në mënyrë të tërthortë ato vërtetojnë edhe një herë që qyteti i Lisisit nuk ka qenë ndërtuar nga Dionisi i Sirakuzës në fillim të shekullit IV p.e.sonë, por ishte një qytet ilir që u ngrit e u zhvillua, vërtet me vonesë, kundrejt qyteteve të para ilire, por megjithatë së bashku me Shkodrën dhe me një radhë qytetesh të tjera ilire të periudhës së dytë.

Në qoftë se Lisi do të ishte një koloni sirakuiziane, ashtu sikurse e konsiderojnë, veç atyre që u përmendën në fillim edhe të gjitha ata numizmatë që u morën me studimin e monedhave të këtij qyteti, atëherë ai duhet të kishte prerë monedhat e veta jo njëkohësisht me Shkodrën, por më kolonitë e njohura sirakuiziane si, p.sh.. me Issën e cila, siç dihet, filloi të presë monedhat e saj në fund të shekullit IV p.e.sonë, relativisht në një kohë të afërt me themelimin e saj. Të njëjtën gjë vërtetojnë simbolet e përdorura në monedhat e Lisisit. të cilat siç u pa, në shumicën e tyre përfaqësojnë elemente ilire, ku dallohen armët vetëmbrojtëse, si mburoia dhe përkrenaria, të njohura në pajisjen e ushtarakëve ilirë. Këto armë janë riprodhuar në mënyrë figurative, me të gjitha karakteristikat e tyre, si në paraqitjen e formës ashtu edhe të elementeve zbukuruese të tyre. Në riprodhimin e këtyre simboleve duken të qarta aftësitë artistike të mjeshtërve ilirë me përvojë në këtë fushë.

KAPITULLI III

QYTETI I LISIT NE KOHEN E PUSHTIMIN ROMAK

Pas rëniec së mbretërisë së Gentit, Roma e ndau në tri njësi territorin e tokave të fiseve ilire, që përfshiheshin në shtetin Ardia.

Në njësinë e parë ushtarako-administrative, qyteti i Lisi tishte si qendër kryesore e saj. Këtu bënин pjesë krahanat në veri të lumit Mat e deri në kufirin jugor të labiatëve.

Kjo ndarje kishte për qëllim, në radhë të parë, të përcante bashkimin e fiseve ilire dhe të largonte rrezikun e organizimit të kryengritjeve të përbashkëta të këtyre fiseve kundër romakëve.

Fiset ilire janë cilësuar nga Polibi si «popull i prapë», prandaj edhe kundër tyre morën edhe masa administrative, duke ua ndaluar të drejtën që të mblidheshin në një kuvend të përbashkët. Banorët e njërsës njësi ndaloreshin të martoheshin me ata të njësive të tjera. U ndalohej gjithashtu, tregtia ndërmjet tyre dhe prerja e lëndës së drurit për ndërtimin e anijeve.

Para fillimit të mijëvjeçarit të parë të erës sonë, qyteti i Lisis, në burimet historike, përmendet si «municip», qendër e rëndësishme ushtarako-administrative romake. Ky qytet do të bëhej për Romën, një qendër kryesore në bregdetin e Adriatikut, nga ku ushtria romake do ta shtrinte pushtimin në thëllësi të Ilirisë, për të arritur në Dardani. Nga ana tjetër, për synimet imediate të Romës, Lisi konsiderohej si një bazë detare, që do të siguronte lundrimin

ë flotës ushtarake e tregtare romake, gjatë gjithë Adriatikut Verior.

Për realizimin e këtyre aspiratave, romakët, mënjëherë pas vëties nën sundimin e tyre të qytetit, u interesuan në mënyrë të veçantë për rindërtimin e sistemit mbrojtës. Dhe sikurse dëshmojnë qartë mbeturinat e ndërtimeve të kësaj kohe, mbrojtja e re u bë në bazë të një programi të caktuar, sipas kërkjesave të reja. Nevojat e menjëherësme të kolonëve romakë ishin: forcimi në fushën ushtarake dhe mbrojtja e popullsisë civile romake të vendosur këtu. Ata morën të gjitha masat që ta ndryshon rrënjosht sistemin urbanistik, duke e përshtatur atë brenda skemës të qytetit ilir dhe njëkohësisht të fortifikimit të qytetit, sepse ata tanë e dinin mirë se ndodheshin në një vend të huaj, në prani e të rrethuar nga popullia vendase.

Muret rrëthuese të hershme të qytetit ilir u rindërtuan në pjesët e rrëzuara, kurse tri zonat e banuara të qytetit, në këtë kohë, u ndanë ndërmjet tyre e u rrëthuan me mure; sipas programit të ri u krijuan katër zona të fortifikuara: 1. akropoli 2. zona e qytetit kodrinor, 3. qyteti i poshtëm, 4. porti lumor fig. 12.

1. Akropoli i qytetit

Në sistemin e ri mbrojtës të Lisit duket qartë se kriji mi dhe fortifikimi i akropolit ishte një nga objektivat kryesore të tij. Të dhënat e përfituar nga punimet restauruese, të bëra në zonën e sipërme të këtij qyteti, japid mundësinë e përcaktimit, deri në njëfarë mase, të planimetrisë së mureve rrëthuese të akropolit dhe të hyrjeve kryesore të tij. Gjurmët e nxjerra në dritë të mureve mbrojtëse tregojnë se planimetria e akropolit kishte një formë të çrrregullt, të përcaktuar më tepër nga mundësitë që ofronte terreni dhe muret rrëthuese të kohës ilire. Sipërfaqja e banuar e akropolit të fortifikuar rezulton pak më e vogël se ajo që zinte rrëthimi i vendbanimit protourban të Lisit. Në sistemin e fortifikimit të akropolit janë shfrytëzuar në anën lindore të

tij muret rrethuese të kohës ilire, sikurse edhe dy hyrjet e qytetit ilir që ishin në këtë zonë. Gjurmët e rindërtimit të këtyre hyrjeve janë të dallueshme si në portën kryesore të anës lindore të akropolit ashtu edhe në portën veriore të tij. Në anën lindore duken gjithashtu, gjurmët e një kullë drejtikëndore, e cila është e ndërtuar që nga themeli dhe bën pjesë në përforcimin e ri që i bëhet hyrjes kryesore të akropolit. Nga gjurmët e mureve që ruhen në hyrjen veriore të akropolit kuptohet se porta e kësaj hyrjeje është pak më e zhvendosur nga vendi i portës më të hershme. Në anën e majtë të portës veriore ruhen pjesë nga muret e kullës, që bënte pjesë në fortifikimin ilir, e cila pas rindërtimit shërbente përmbrojtjen e portës veriore të akropolit. Për t'u vënë në dukje është fakti që muri i rrëthimit të akropolit, i ndërtuar që nga themeli, fillon pikërisht në anën e djathtë të hyrjes veriore dhe përfshinë gjithë majën e kodrës, e mbyll rrëthimin me bashkimin e tij me murin ilir të anës lindore.

Duke ndjekur gjurmët e murit të akropolit nga porta veriore, ai vazhdon në një drejtim deri në një largësi prej 65 m. Këtu ndërpritet nga një kullë me planimetri gjysmë-rrethore dhe me vëllim gjysmëcilindrik. Ky objekt, me përmasa 12 m diametri, u gjet në gjendje mjaft të mirë. Muret e saj ruhen në lartësi nga 2-4 m. Në të dyja anët e kullës duken gjurmët e vazhdimit të murit rrëthues të akropolit, i cili ruhet në dy-tre rreshta gurësh. Muri i rrëthimit të akropolit del përsëri në sipërfaqen e terrenit me një trakt të gjatë rrëth 3 m, i cili përfundon në qoshen perëndimore të akropolit. Në këtë trakt muri është me një kthesë të vogël, që lë shteg përmbrëtues që e ka përfshirë brenda mureve të kullës mesjetare, që është ndërtuar mbas shumë shekujsh në të njëjtin vend.

Muri i akropolit, i ndërtuar që nga themeli, dallohet nga muri ilir prej veçorive e trajtimit stilistik të blloqeve, të cilat në këtë rast janë të gdhendura, me sipërfaqe gati të sheshuar me daltë dhe janë vendosur në muraturë me rreshta më tepër horizontalë.

Nga sa vihet re, muret e rrëthimit të akropolit ndiqen gati në 2/3 e gjatësisë perimetrale të tyre, kurse gjurmët e tjera të anës jugore të tij ka shumë mundësi që të jenë brenda murit të kalasë mesjetare, e cila, siç do të shihet, është e ndërtuar e gjitha mbi mbeturinat e mureve të akropolit të qytetit të Losit.

Nga ky vështrim i përgjithshëm vetëkuptohet se krijimi i akropolit, me një rrethim muresh të veçantë dhe njëkohësisht të përfshirë në sistemin mbrojtës të përgjithshëm, kishte për qëllim kryesisht sigurimin e shtabit ushtarak dhe të funksionarëve të lartë romakë, të vendosur brenda zonës së akropolit.

Gjatë sondazheve arkeologjike të bëra në akropol nuk janë hasur deri tani ndërtime të tjera, përvèç shtrësës kulturore të pasur me fragmente qeramike të kohës romake.

2. Qyteti kodrinor

Zona e banuar nën akropol, e mbrojtur pjesërisht nga muret e rindërtuara ilire, në këtë kohë rrëthohet edhe ajo me mur të veçantë në anën perëndimore të saj. Ky mur, i ndërtuar që në themel ngrihet në gjysmëpjerrësinë e shpatit të kodrës, pikërisht në pjesën më të ngushtë të mureve rrëthuese të qytetit ilir.

Sistemi mbrojtës i kohës ilire, sikurse vihet re edhe në planimetri, përfshihet në atë të kohës romake dhe muret e reja të ndërtuara që nga themeli janë ato të ndërtuara për ndarjen dhe për fortifikimin kryesisht të akropolit dhe të qytetit kodrinor.

Në sistemin mbrojtës të qytetit kodrinor, të përforcuar me mbylljen e rrëthimit të tij të veçantë me anën e murit perëndimor, i cili arrin një gjatësi rrëth 250 m, janë ndërtuar edhe kulla e hyrje të reja. Në anën e brendshme të murit perëndimor janë ndërtuar njëkohësisht edhe të ndara njëkthinëshe, me përmasa 4.80×7.20 m. Gjurmë të ndarjeve të tillë duket se janë ndërtuar edhe nga ana e brendshme e murit ilir deri te porta e burimi. Deri tani janë zbuluar më se 35 kthina të dallueshme.

Këto kthina të njëlojta, të ndara njëra nga tjetra, përdhese dhe me një derë të vogël, tregojnë qartë sa shërbenin për strehimin e reparteve të ndryshme ushtarake dhe për depozitim e armatimit e të pajisjeve të tyre.

Ndërtimi i gjithë këtyre kthinave në anën e brendshme

të murit rrethues i jep atij një karakter të veçantë në gjithë sistemin e rindërtuar të qytetit të Lisit.

Qyteti kodrinor komunikonte me qytetin e poshtëm me anën e dy hyrjeve të reja, të ndërtuara menjëherë me murin perëndimor, kurse për komunikimin e jashtëm ishin në përdorim edhe në këtë kohë të gjashtë hyrjet që kishte zona e qytetit të mesëm në kohën ilire. Për sa i përket komunikimit të kësaj zone me akropolin, deri më sot nuk ka ndonjë të dhënë të sigurt.

Hyrja kryesore e zonës kodrinore, që ishte ndërtuar afersisht në gjysmën e gjatësisë së murit të brendshëm perëndimor, është zbuluar tërësisht gjatë viteve 1970. Kjo hyrje, për vetë funksionin e saj, është quajtur porta e brendshme, dhe lidhte zonën e qytetit kodrinor me atë të qytetit të poshtëm. Në përgjithësi, porta e brendshme ka shumë elemente të përbashkëta me portat e tjera, por në planimetrinë e saj paraqet një zgjidhje të veçantë. Porta në këtë hyrje është vendosur në mes të korridorit dhe pas tij vjen një oborr i hapur; prej këtej, me një kthesë në krahun, e djathë, hyhej në zonën e qytetit kodrinor. Në krahun e majtë të saj ishte ndërtuar nulla, që mbronte këtë hyrje me formë drejtkëndëshe. Në kundërshtim me rregullin që është vërtetuar në të gjitha kullat e tjera, nulla në fjalë nuk ka shkallë të vendosura bri mureve të saj. Ky fakt mund të tregon se ngjitja dhe hyrja për në kullë bëhej drejt përdrejt nga vendkalimi i rojave të murit rrethues. Hyrja e portës së brendshme është 3 m e gjerë, ka një prag të shkallëzuar e të ndërtuar njësoj si edhe në portat e tjera. Edhe mbyllja e portës së kësaj hyrjeje bëhej gjithash tu me anën e llozave të futur në mur, gjë që vërtetohet nga një vrimë e hapur në murin e korridorit të portës.

Prania e elementeve të përbashkëta të kësaj porte, e cila dihet se është ndërtuar e re që nga themeli, tregon se në përgjithësi portat e tjera ishin rindërtuar dhe ishin vënë në përdorim në këtë kohë.

Porta e brendshme, në krashtësim me portat e tjera, u gjet shumë e dëmtuar dhe në pjesën më të madhe e rrëzuar ose me mure që kishin rrëshqitur bashkë me gjithë themelin e tyre. Në gjendjen e sotme, mbas restaurimit të përgjithshëm të saj, ajo paraqitet si një ndër portat më prezantuese të kohës së rindërtimit të sistemit mbrojtës të Litisit (foto 13 fig. 28).

Punimet restauruese, që u kryen në gjithë kompleksin e

kësaj hyrjeje, e shpëtuan atë nga dëmtimet e mëtejshme, duke e ringritur në këmbë dhe duke e mbështetur të gjithë strukturën murale në një bazament të ri e të sigurt për kohën e ardhshme. I gjithë kompleksi arkitektonik i kësaj porte, kur doli nga gërmimet, dukej si një gërmadhë gurësh të rrëzuar. Në përfundim të restaurimit të saj, ajo mori pamjen që ka pasur ky monument para se të rrëzohej tërësisht nga rrëshqitja e terrenit.

Nëpërmjet këtyre punimeve u bë më i qartë përfytyrimi planimetrik i portës, i kullës, i murit rrëthues dhe i kthinave në anën e brendshme të tij. Nga të dhënat, që u volën gjatë punimeve të restaurimit, u arrit që të bëhej edhe një rikonstruksion grafik i pamjes së përparme fillestare të portës së brendshme (fig. 13, 14).

Për ndërtimin e kompleksit të kësaj porte dhe të të gjithë murit rrëthues perëndimor të zonës së qytetit kodrinor, është përdorur një teknikë ndërtimi, që dallohet nga teknika e mëparshme.

Karakteristika kryesore e kësaj teknike është përdorimi i dy lloj materialeve të ndryshme: i gurit dhe i tullës së pjekur. Pjesa e poshtme e muraturës është ndërtuar me bloqe gurësh të gdhendur e të vendosur në të thatë, në të njëjtën mënyrë, si edhe në teknikën e kohës ilire, kurse pjesa e muraturës që ngrihet mbi të, është ndërtuar me tulla të pjekura të vendosura me llaç balte.

Muri prej guri përbën në këtë rast xokolaturën mbështetëse të muraturës prej tulle, e cila ishte e ndërtuar në gjithë gjatësinë e murit. Xokolatura prej guri ishte e ndryshme në lartësinë e saj dhe njëkohësisht e shkallëzuar si pas pjerrësisë së terrenit.

Tullat e përdorura për herë të parë në muret rrëthuese të Lisisit kanë qenë të punuara e të pjekura në vend, me përmasa të ndryshme. Vendosja e tullave në muraturë dhe lidhja me llaç balte kanë ndihmuar prishjen me lehtësi të këtyre mureve në kohë më të vonshme, prandaj sot nuk ruhen veçse trakte shumë të vogla të tyre. Për t'u vënë në dukje është edhe fakti që muri perëndimor, megjithëse mur fortifikimi, është më i hollë nga muret ilire. Trashësia e tij është 1.80 m, kurse muret e kthinave janë sa gjysma e kësaj trashësie, 0,90 m.

Me gjithë këto elemente të ndryshme, duhet thënë se në përgjithësi, në punimet rindërtuese të sistemit të ri fortifikues të qytetit vërehet kudo trashëgimia e traditave ndërtifikuese.

timore vendase. Në xokolaturën prej guri ndeshen koncepte konstruktive e arkitektonike të njëllojta me ato të mureve ilire, por dallohen gjithashtu, siç u tha, edhe elemente që tregojnë për një zhvillim të mëtejshëm të teknikës së ndërtimit.

Gërmimet arkeologjike, që janë bërë në brendësi të zonës kodrinore dhe pikërisht në tarracën jugperëndimore të saj, nxorën në dritë një sërë ndërtesash të ngritura buzë rrugës kryesore, e cila, me sa duket, përshkonte zonën nga porta e brendshme e deri te porta e Gaviarit. Këto godina, të orientuara nga perëndimi, janë ndërtuar me mure prej gurësh të vegjël, të lidhur me llaç gëlgjereje. Kjo teknikë ndërtimi ndeshet për herë të parë në këtë zonë të qytetit të Lisit dhe dëshmon se ndërtimet e mëparshme kanë qenë kryesisht me konstruksione druri, të veshura me mure të holla prej qerpiçi. Këto materiale, të paqëndrueshme ndaj kohës dhe kushteve klimaterike, nuk kanë lënë asnje gjurmë të tyre.

Ndërtesat e zbuluara në këtë zonë kanë qenë me bodrum, që përdoreshin si depo ose edhe si sterna për grumbullimin dhe për ruajtjen e ujit të shiut. Sternat ishin të veshura me shtresa llaç gëlgjereje, përzier me pluhur tjegullash të shtypura.

Në radhën e objekteve të zbuluara dallohet njëri prej tyre i ndërtuar me blloqe gurësh të mëdhenj, të gdhendur e të skuadruar me daltë, me një sipërfaqe të sheshtë. Blloqet e gurëve janë vendosur edhe këtu në të thatë. Nga kjo ndërtesë është ruajtur vetëm një rresht gurësh nga muret perimetrale. Objekti në fjalë ka një planimetri afërsisht katror, një palë shkallë guri të vogla, që i bashkëngjiten murit të anës lindore. Këto të dhëna e dallojnë këtë ndërtesë prej të tjerave, që u gjetën në një radhë me të. Nga ana tjetër, prania e saj dëshmon për nië ndërtim të një-kohshëm. Kjo ndërtesë, si nga ana teknike ashtu edhe nga përmasat e vogla, duket se ka qenë një objekt përkujtimor ose me karakter kulti.

Në anën veriore të këtyre ndërtesave, rrëth 90 m larg tyre, është zbuluar edhe një objekt mjaf i dëmtuar nga rrëshqitja e terrenit, ku në kohë të mëvonshme është zhdukur edhe pjesa përpara. Nga pjesët e ruajtura shihet se kë objekt ka qenë shtëpi banimi, përdhese, e ndërtuar me mure guri të lidhur me llaç gëlgjereje, e vendosur në terrenin e pjerrët të shpatit të kodrës. Pjesa më e ruajtur e saj është

banja, e cila ka një dysheme karakteristike të shtruar me parket, ndërtuar me copa tjegullash të prera në formë pri-zmi, drejtkëndore e të vendosura me llaç gëlqereje. Gjurmë të një dyshemeje të tillë janë gjetur edhe gjatë punimeve të restaurimit të portës së brendshme. Rasti i dytë lë shteg për të menduar se në këtë qytet ishte e mirënjohur kjo teknikë, e cila është përdorur gjérësisht në shtrimin e mje-diseve të posaçme, siç ishin banjat e vogla të shtëpive të banimit.

Nga sa mund të vihet re, banesat e ndërtuara në këtë zonë janë të drejtuara nga perëndimi e buzë rrugëve, të cilat mendohet se janë paralel ndërmjet tyre. Kjo vendosje presupozon, nga ana tjetër, përdorimin e rrugëve të kryqëzuara e me një rrjet drejtkëndor, megjithëse terreni nuk e favorizonte një gjë të tillë. Bri rrugëve ishin edhe kanalet mbledhëse të ujërave sipërfaqësore, të cilat, me një sistem të organizuar të tyre, shkarkoheshin jashtë mureve rre-thuese. Kjo gjë vërtetohet edhe nga lugu, i cili është gjetur para hyrjes së portës së brendshme.

Si përfundim, mund të thuhet se në zonën kodrinore të Lisit ishin vendosur kolonët romakë, në banesa të qëndrueshme prej guri. Brenda kësaj zone kanë qenë edhe kazermat e reparteve ushtarake, që ishin në mbrojtje të tyre. Nuk përashtohet gjithashtu, edhe mundësia e bani-të mit, në këtë zonë kaq të mbrojtur, edhe e familjeve të pjetë-sëtarëve që shërbenin në administratën e pushtetit lokal.

3. Qyteti i poshtëm

Zona e qytetit të poshtëm, në afërsi të lumit, është më pak e njobur për periudhën e parë të pushtimit romak. As edhe gërmimet e fundit nuik kanë dhënë një fisionomi të quartë. Rindërtimet e sistemit mbrojtës të kësaj kohe deri tani janë diktuar vetëm në muret e kullës së hyrjes veriore. Në pjesët e mureve të kësaj kulle dallohet trajtimi stilistik i bloqeve të gurëve, të cilët duket se janë të njëllojtë me ata të mureve të akropolit. Nisur nga këto të dhëna, mun-det që edhe këtu të ketë gjurmë të rindërtimeve, që u

janë bërë mureve rethuese të periudhës ilire. Gjurmë të tjera të periudhës së parë romake janë zbuluar edhe brenda kësaj zone të qytetit të poshtëm. Në anën e brendshme të portës jugore, bri rrugëve kryesore që përshkon qytetin në drejtim të veriut, janë zbuluar trakte muresh të ndërtuara me tulla të pjekura, të vendosura me llaç balte. Përmasat e këtyre tullave janë të barabarta me ato të përdorura në murin perëndimor të fortifikimit të zonës kodrinore të sipërpermendorur, pra edhe këto mure vërtetohet se janë të njëkohshme.

Hyrja kryesore e anës jogore të qytetit të poshtëm ka qenë në gjendje të mirë dhe është përdorur në periudhën e parë të pushtimit romak. Në këtë kohë është rindërtuar dhe është ngritur në një nivel më, të lartë kalldrëmi prej guri që mbulonte gjithë korridorin ndërmjet dy portave të kësaj hyrje.

Së bashku me këtë kalldrëm janë rindërtuar edhe blloqet e pragut të portës së brendshme, sikurse mendohet se është rindërtuar edhe vetë kontruksioni prej druri i kësaj porte. Për sa i përket portës së parë, nuk ka gjurmë të tjera, veç kalldrëmit përbrenda saj. Porta e dytë ruan në vendin e tyre blloqet e gurëve, mbi të cilat vendoseshin kasht dhe dyert e portës.

Në portën e dytë janë ruajtur në vendin e tyre blloqet e gurëve të gdhendur në sipërfaqe me gropat ku vendosej kasa dhe cernierat metalike prej bronzi, që shërbenin përlëvizjen e kanatave të portës.

Ngritja e nivelit të shtresës së kalldrëmit dhe të trouarit në të dyja anët e rrugës kryesore duhet të lidhet më tepër me ngritjen në përgjithësi, të horizontit të banimit të ri të kësaj zone mbi mbeturinat e qytetit më të hershëm. Një arsyе tjetër do të ishte edhe shkaku i përmbytjeve të kësaj zone në stinën e dimrit, përmbytje këto që në këtë kohë duket se kanë qenë të shpeshta.

Duhet vënë në dukje, nga ana tjetër, se kalldrëmi ndërmjet dy portave të hyrjes lindore, nga gjendja dhe nga paraqitja e tij duket si shumë i ri dhe i papërdorur. Mungesa e gjurmëve të kalimit të karrocave, që ishin aq të dallueshme, siç u tha, te porta e Gaviarit, tregon gjithashtu përnjë ndërtim të vonë. Ndoshta edhe për një përdorim të shkurtër në kohë.

Ndërtimet e njëpasnjëshme i kanë shkatërruar pothuajse tërësisht gjurmët e qytetit të periudhës së parë ramake,

kurse në zonën e qytetit ndërtimet e mëvonshme kanë qenë më të kufizuara dhe për një periudhë më të shkurtër.

Zona e qytetit të poshtëm ishte më e populluar dhe me një veprimtari të shumtë zejtaro-tregtare që furnizonte gjithë popullsimë e Lisit dhe të krahinës përreth. Për këtë zhvillim flasin qartë gjetjet e shumta të fragmenteve të enëve të ambalazhit, amforat e mëdha, enët e tjera të përdorimit të përditshëm me materialet e tjera arkeologjike.

Amforat e kësaj periudhe, të gjetura të thyera, janë në shumicën e tyre të formave të njohura romake, që vinin si material ambalazhi për furnizimet e ushtrisë dhe të populsisë romake të vendosur në këtë qytet. Ato në përgjithësi janë amfora me bark të fryrë në pjesën e poshtme të trupit, kanë qafë e doreza të shkurtra dhe buzë të trasha e të shpërvjelura. Pjesa më e madhe e vulave të amforave të gjetura këtu, janë të ardhura nga përtej detit, por nuk mungojnë edhe vula të amforave të prodhuara në vend.

Për t'u përmendur janë edhe gurët e mokrave që pëndoreshin për bluarjen e drithërave, të cilët janë gjetur në vende të ndryshme të qytetit. Gurët e këtyre janë të llojeve të ndryshme; ndër to vërehen gurë me përzierje kuarci, që mund të janë nxjerrë në vend, por në përgjithësi ato janë me prejardhje nga llava vullkanike dhe ndoshta janë edhe të importuar. Mokrat, të përbëra nga dy gurë të gdhendur, me sipërfaqe takimi të sheshtë e në formë të rrumbullakëta, me diametër 30-50 cm, kanë nga një vrimë në qendër të tyre dhe një tjetër aty ku futej doreza e rrotullimit të pjesës së sipërme të tyre. Këto lloje mokrash janë më tepër të përdorimit shtëpiak. Por janë gjetur edhe gurë me përmasa të mëdha, në formë koni, konvekse e konkave, të punuar në gurë llave të fortë e të rëndë. Këto lloje mokrash kishin vendosje fikse dhe ishin të pajisura me një konstruktion druri, nëpërmjet të cilit viheshin në lëvizje gjatë bluarjes nga dy njerëz: Një mokër e tillë, me gurë pothuajse të plotë, pa konstruksion druri, u gjet në qytetin e poshtëm. Prania e saj tregon për një mokër me kapacitet bluarje të madh, të përdorur për bluarjen e drithërave në sasi të mëdha.

Mokrat e vogla shtëpiake janë përdorur që në kohët më të lashta dhe deri në fillim të shekullit tonë. Mokrat e mëdha, si nga forma dhe nga materiali, kanë qenë përdorur gjerësisht që nga shekulli IV p.e.sonë e deri në shekujt II-III

të erës sonë. Një mokër e tillë është gjetur kohët e fundit edhe në Apoloni.

Sistemi i fortifikimit të kësaj zone edhe në këtë kohë mendohet se ishte ai i kohës ilire; rindërtimet janë bërë në pjesën e sipërme të mureve rrëthuese, të kullave dhe të hyrjeve ekzistuese të kësaj zone.

4. Datimi i rindërtimit të sistemit mbrojtës të qytetit të Lisit në kohën e pushtimit romak

Lidhur me caktimin e kohës së rindërtimit të të gjithë sistemit mbrojtës të qytetit të Lisit ka të dhëna të férthorta nga burimet historike të kohës së lashtë si edhe të dhëna të sigurta mbishkrimore, të zbuluara në vend disa vjet më parë (fig. 15, 16).

Në tri vende të ndryshme të mureve rrëthuese të qytetit janë zbuluar blloqe gurësh të mbishkruara, në gjuhën latine, ku bëhet fjalë për rindërtime në pjesë të veçanta të mureve, të njërs nga portat e qytetit kondrinor dhe të kullës mbrojtëse të saj.

Mbishkrimi i parë, i cili u zbulua nga gërmimet arkeologjike brenda koridorit të portës së Gavjarit, bën fjalë për rindërtimin e kësaj porte dhe të kullës që ishte në të djathtë të hyrjes së saj.

Mbishkrimi i dytë u gjet 20 m më larg të parit gjatë punimeve restauruese që kryheshin në murin lindor të zonës së qytetit kodrinor. Në tekstin e ruajtur shumë mirë të këtij mbishkrimi, flitet për rindërtimin e murit.¹

Në të dyja mbishkrimet bëhet fjalë gjithashtu se punimet e rindërtimit të sistemit të fortifikimit janë bërë me vendim të këshillit të qytetit, nën kujdesin e magjistratit ekzekutiv të tij, L. Gavjarit dhe Meges. Punimet janë kryer

1 F. Prendi, «Dy mbishkrime ndërtimi nga qyteti Ilir i Lisit», *Iliria*, 1982, 2, fq. 153-163.




Fig. 1.




Fig. 2.

FORTESA E SHELUNIT




Fig. 3.




Fig. 3/1.




Fig. 4.




Fig. 5.




Fig. 6.




Fig. 7.




Fig. 8.

PLANIMETRIA
EPORTES KRYESENDE
GYTETINE POSHTEM




Fig. 9.




Fig. 10.

*PORTA PERENDIMORE
E PORTIT LUMOR*




Fig. 11.

LISI NE SHEK. I p.e.s.




Fig. 12.




Fig. 13.




Fig. 14.




Fig. 17.




Fig. 15.



Fig. 16.

LISINE SHEK. IV.

KESHTJELLA E LISIT

QYETLI HAPURI LISIT

Lumi i Drinit

0 50 100m.

Fig. 18.




Fig. 19.

me shpenzimet e bashkësisë qytetare, dhe sasia e të hollave të shpenzuara për secilën pjesë muri të rindërtuar jepet në fund të mbishkrimeve.

Gjurmët e një mbishkrimi të tretë janë ruajtur në një bllok guri, që është gjithnjë i murosur në vendin e vet, në ballin e kullës së portës së burimit, në anën veriore të murit rrëthues të qytetit kodrinor. Nga ky mbishkrim nuk ruhet gjë tjetër veç kornizës përkufizuese e vendit të mbishkuar, ku duket sipërfaqja e sheshuar dhe me shumë vështirësi mund të dallohet ndonjë germë nga teksti i zhdukur i këtij mbishkrimi.

Për një mbishkrim të katërt bëhet fjalë në kohën e mesjetës, nga qiraku i Ankonës¹, i cili shkruan se kur vizitoi Leshin, Alesio, në vitin 1463, kishte parë në mbeturinat e mureve të qytetit, një mbishkrim, ku, sipas këtij autori, bëhej fjalë gjithashtu, për rindërtimin e mureve rrëthuese nën kujdesin e të njëjtëve magjistratë, që janë edhe në dy mbishkrimet e sipërpërmendur.

Në përfundim të zbulimit të Portës së Burimit u konstatua se blloku i mbishkuar i përkiste periudhës fillestare të ndërtimit të portës dhe ishte gdhendur e ishte mbishkuar në kohën e rindërtimit të mureve. Vetëkuptohet se në këtë mbishkrim përkujtohen punimet e rindërtimit të pjesës së sipërme të mureve të portës dhe të kullës së saj, ndoshta edhe të kthinave ushtarake që, siç u tha, fillojnë që nga kjo portë dhe vazhdojnë në të gjithë gjatësinë e murit përendimor.

Mbishkrimi i portës së burimit paraqitet në pamjen e përgjithshme i ndryshëm nga dy mbishkrimet e tjera, sepse fusha e tij ishte e kufizuar me kornizën karakteristike, të përdorur gjëresisht në mbishkrime e në gurët e varreve të kohës romake.

Tekstet e mbishkrimeve të zbuluara në qytetin e Lisit janë botuar kohët e fundit nga F. Prendi,² i cili arrin në përfundimin se datimi i tyre është i sigurt dhe me një kufi kohor të ngushtë.

Për datimin e tyre autori niset nga fakti që njëri nga dy magjistratët suprem municipal, G.J. Meges, figuron në mbishkrimet si libert i Cezarit (rob i liruar nga Cezari), rrjedhimisht edhe mbishkrimet ndërtimore të Lisit i përkasin

1 Cil III, nr. 1704.

2 F. Prendi, Po aty.

kohës së prokonsullatës së Cezarit në Iliri. Për këtë kohë sugjeron edhe informata që jep vetë Cezari në veprën e tij «Lufta civile», ku thotë se «Këshilli i qytetarëve, që kishte në dorë Lisin, qytet të cilin ua kishte besuar më parë Cezari..., ishte përkujdesur ta fortifikonte».¹

Në rastet e sipërpërmendura vërtetohet një përputhje e qartë e burimeve historike me të dhënët epigrafike dhe përcaktimi i kohës së rindërtimit të sistemit mbrojtës të qytetit të Lisit del në mesin e shekullit I p.e.sonë.

Për një datim të tillë flet edhe vetë muri perëndimor i zonës kodrinore, i cili është ndërtuar me teknikën e përzier, mur tulle i lidhur me baltë, i mbështetur mbi një xokolaturë, ndërtuar me blloqe gurësh të gdhendur e të vendosur në të thatë.

Sipas të dhënavë, që u përmendën, llogaritet se rindërtimi i sistemit mbrojtës të qytetit të Lisit është bërë rreth 250 vjet pas fortifikimit të kohës ilire. Nga ana tjetër, duhet të vihet në dukje se ky rindërtim bëhet duke shfrytëzuar tërësisht muret, kullat dhe të gjitha hyrjet e qytetit ilir. Ndërtime të reja janë vetëm një pjesë e murit rrethues të akropolit dhe muri perëndimor i zonës së qytetit kodrinor.

Në një vështrim tjetër, duhet të vihet në dukje se baza ekonomike e teknike, që bëri të mundur realizimin e këtyre punimeve mbrojtëse, e kishte burimin kryesor në forcën ekonomike e ndërtimore të popullsisë së qytetit e të krahinës së tij. Pushtuesit romakë nuk ndërtuan këtu një sistem mbrojtës në një terren të virgjër, por u përshtatën në një qytet ekonomikisht të zhvilluar dhe me tradita ndërtimore të lashta.

Me interes është gjithashtu, vënia në dukje se burimet historike të kohës së lashtë nuk bëjnë fjalë, në asnjë rast, për pushtimin e qytetit të Lisit nga ushtria romake, sikurse përmendenin pushtimin e Shkodrës apo të ndonjë qyteti tjetër të Ilirisë. Rrjedhimisht nuk dihen me hollësi edhe rrëthanat në të cilat u vendosën kolonët romakë në këtë qytet. Duke u nisur nga rindërtimi i sistemit mbrojtës të Lisit, i cili është bërë, nga romakët gati 100 vjet pas pushtimit të Shkodrës, ky fakt lë vend për të menduar se në këtë interval kohe Lisi duhet të ketë qenë një qytet me autonomi të kufizuar deri në vendosjen e kolonëve romakë në gjysmën e shekullit I p.e.sonë.

1 C. J. Caesaris, *Lufta civile*, L. III, 29.

5. Përmbytja e zonës së poshtme të Losit

Zona e qytetit të poshtëm, e vendosur, siç është thënë, në afërsi të lumit dhe në terren fushor, deri në kohën ilire nuk rrezikohej nga përmbytjet, megjithëse ndodhej në grykëderdhjen e ujërave të pellgut hidrografik të lumit Arda-san. Gjadri i sotëm. Një rrezik të tillë nuk ekzistonte as edhe në kohën kur u ndërtuan muret e rrethimit të qytetit ilir.

Në kohë më të vona, kur pellgu hidrografik, që u përmend u zgjerua, rreziku i përmbytjes së kësaj zone ishte gjithnjë i pranishëm, sidomos në stinën e reshjeve të mëdha. Përmbytja e kësaj zone duhet të lidhet drejtpërdrejt me lumin e Drinit, i cili e ndryshoi drejtimin e shtratit të tij nga veriperëdimi në drejtim të jugut. Kështu pellgu hidrografik, që ka rrugëdaljen e sipërpermendur, u zgjerua aq shumë, saqë ujërat e shumëfishuara vërvshuan me rrëmbim e në sasi të mëdha, duke përmbytur si fushën e brendshme rrëzëmalore ashtu edhe atë bregdetare. Drini, duke u bashkuar me Ardaksanin në një shtrat të vetëm, e ngrinte shumë nivelin e ujit dhe në këtë mënyrë shkaktonte përmbytjen e herëpashershme të qytetit.

Lidhur me përcaktimin e kohës se kur lumi i Drinit e ka ndryshuar për herë të parë shtratin e tij në drejtim të jugut, nuk ka ndonjë burim të saktë. Megjithkëtë mund të arrihet një përcaktim kohor i përafert po të merren parasysh të dhënat e tërthorta të burimeve historike dhe sidomos të dhënat e fundit të gërmimeve arkeologjike dhe të punimeve të restaurimit.

Lumi i Drinit përmendet për herë të parë në burimet historike të kohës së lashtë nga T. Livi.¹ Ky autor, duke përshtkuar qytetin e Shkodrës së rrethuar nga Amici, në vitin 168 p.e.sonë, thotë se qyteti rrethohet nga dy lumenj: Klau-sali (Kiri), që rrjedh nga ana lindore pranë qytetit dhe Barbana (Buna), nga ana perëndimore, e cila rrjedh nga liqeni i Labeatëve. Të dy këta lumenj derdhen në ujërat e lumit Oriund (Drini), i cili buron nga malin Skord dhe pasi përbledh edhe ujërat e disa lumenjve të tjera derdhet në detin Adriatik. Një autor i shekullit I të erës sonë, Plini,² thotë

¹ T. Livi, XLIV, 31, 3, 4.

² C. Plini Secundi, *Historia e natyrës*, L. III, 22 (26).

se mbi brigjet e lumenit Drin gjendet qyteti Skodra. Ptolomeu¹, gjeograf i shekullit II, e vendos grykën e lumenit Drilon (Drinit) pas Ulqimonit (Ulkinit) dhe para qytetit të Lissos-it (Lisi). Pas këtyre burimeve lumi del përsëri në dokumentet historike në shekullin XI. Kadreni,² në veprën e tij «Përbledhje historish», thotë se lumi Drin del nga ligeni i Ohrit dhe ngjitet në veri, pastaj kthehet në perëndim dhe derdhet në det pranë Kështjellës së Elisonit (Lisit).

Nga gërmimet arkeologjike të vitezave të fundit del se pjesa e poshtme e qytetit është përblytur nga një vërshim i madh, uji i të cilit kishte arritur rrëth 1 m lartësi mbi nivelin e kalldrëmit të portës kryesore të anës jugore. Gjurmët e qarta të përblytjes së qytetit të poshtëm duken edhe sot në gjithë sipërfaqen e korridorit, brenda dhe jashtë portës kryesore të kësaj zone. Mbi kalldrëmin e korridorit të kësaj porte u gjet një shtresë, që tregonte më tepër depozitime aluvionale, të cilat ndërprisin vazhdimesinë e shtresave kulturore në zonën e përmendur. Kjo shtresë ishte mbas 3 m thellësi gërmimi nga horizonti i banimit të qytetit të sotëm. Në koridorin ndërmjet dy portave të hyrjes kryesore, depozitimi aluvional, i favorizuar nga pilastrat e portave, ruhej më mirë deri në lartësinë rrëth 0,60 m, kurse në anën e brendshme të qytetit vinte duke e zvogëluar këtë lartësi për shkak të pjerrësisë së terrenit. Gjendja e patruar e këtij depozitimi aluvional tregon në mënyrë të dukshme përbërjen e tij nga prurjet, material i precipituar mbas kullimit dhe pjesërisht avullimit të ujit të zonës së përblytur. Shtresa e parë e këtij depozitimi, duke filluar nga sipërfaqja e kalldrëmit, ishte me trashësi 0,30-0,40 m dhe përbëhej nga zhavorr i imët, i përzier me copa të vogla prej qeramike. Mbi këtë material ishte depozituar llum aluvional, i përbërë nga rërë e hollë e përzier me dhergjilat, me trashësi 0,15-0,20 m; më sipër vinte llum i pastër me ngjyrë jeshile të errët. Në sipërfaqe të këtij depozitimi u gjeten vende-vende edhe shtresa të holla (2-3 cm) me rërë shumë të pastër, si kumi i rërës së detit, me ngjyrë gri të errët. Përbërja dhe shtresëzimi i precipitimit të prurjeve aluvionale, siç duket, është bërë më kushte normale dhe nga ana

1 Ptolemeu, *Gjeografia*, L. II, 16, 3.

2 Gj. Kedreni, J. Skilices, Bur. treg, për Hist. e Shqipërisë, shek. X-XV, 1975, f. 35,

tjetër, e gjithë shtresa aluvionale që mbulonte korridorin e portës u gjet e palëvizur nga vendi, d.m.th. korridori i portës nuk është pastruar pas përbmbytjes. Një gjendje e tillë paraqitet në të gjithë sipërfaqen e pjesës së përbmbytur të zonës së qytetit të poshtëm, të zbuluar deri sot. Ky fakt kaq kuptimplotë lë shteg për të menduar se një pjesë e zonës së qytetit të poshtëm, është braktisur pas përbmbytjes pér një kohë relativisht të gjatë. Kjo gjë vërtetohet edhe nga gjurmët e horizontit të banimit të mëvonshëm, i cili, siç do të shihet, gjendet në një nivel rrëth 1 m më të ngri-tur nga horizonti i banimit, që përfaqësohet nga kalldrëmi i portës kryesore të qytetit të poshtëm.

Të dhënët më të sigurta pér vërtetimin e këtyre mendimeve janë nga një shtresë kalldrëmi tjetër, që u zbulua mbi shtresën aluvionale, në një drejtim me kalldrëmin e rrugës antike. Ky kalldrëm i dytë, që përfaqësonë një rrugë të mëvonshme, ishte i shtruar me pllaka guri, të vendosura drejt-përdrejt mbi shtresën e fundit të aluvionit. Në këtë rast, pllakat e gurit më pak të punuara dhe me përmasa më të vogla, në krahasim me pllakat e kalldrëmit të parë.

Duhet përmendur gjithashtu, se në shtresën aluvionale, të ruajtur ndërmjet dy kalldrëmeve, nuk u gjet ndonjë objekt ose ndonjë fragment arkeologjik, që mund të ndihmonte në përcaktimin kohor të përbmbytjes. Depozitimet e para, fill mbi shtresën e kalldrëmit të dytë, përbajnjë fragmente të qeramikës së përdorur në shekujt II-III madje edhe më të vona, kështu që edhe në këtë drejtim nuk ka të dhëna të saktë.

Pér të parë një datim, relativisht deri diku të përafërt, të përbmbytjes së qytetit të Llisit, duhet rikthyer edhe një herë te ndërrimi i shtratatit të lumit Drin, duke e krahasuar atë me lumenj të tjerë të vendit tonë, si me Shkumbinin, me Semanin dhe me Vjosën, të cilët gjithashtu e kanë ndërruar disa herë shtratin e tyre gjatë rrugës fushore para derdhjes në det. Dukuri të tillë janë të njoitura e të natyrshme dhe lidhen me lëvizjet tektonike të tokës.

Si një rast analog mund të përmendet ndërrimi apo zhvendosja e shtratatit të lumit Vjosë, që në burimet e lashtë quhet «Aou».

Ky lumë dihet se në kohën antike kalonte në rrëzë të kodrës, mbi të cilën ishte qyteti i njojur Apolonia e Ilirisë. Ishte pikërisht lumi i Vjosës, me anë të të cilit Apolonia lidhej me detin Adriatik dhe konsiderohej si një skelë e

rëndësishme në bregdetin lindor të Adriatikut. Ndërri-mi i shtratit të Vjosës, disa kilometra më në jug ka mundësi që të jetë i njëkohshëm me atë të Drinit dhe të lumenjve të tjerë. Janë shprehur edhe mendime se kjo dukuri natyrore ishte shkaku kryesor, që i preu rrugën detare Apolonië dhe si rrjedhim solli rënien dhe më në fund edhe braktisjen e këtij qyteti rrëth shekullit III-IV. Të dhënat e mësipërme bëjnë që të mendosh se përmbytja e qytetit të Losit duhet të ketë ndodhur nga fundi i shekullit I.

6. Zhvillimi i qytetit të poshtëm jashtë mureve rrëthuese të tij

Në qytetin e Lezhës janë të qarta gjurmët e ndërtimeve të ndryshme, që tregojnë për një zhvillim dhe për një shtrirje të qytetit në një territor më të gjerë edhe jashtë mureve rrëthuese. Këto ndërtime vërtetojnë një fazë të zhvillimit të qytetit, kur ai nu është ndjente nevojën e domosdoshme të mbrojtjes së tij me anën e mureve rrëthuese.

Nga pikëpamja e vendosjes së këtyre ndërtimeve në planin horizontal, ato tregojnë për ndryshime të rëndësishme në sistemin urbanistik të qytetit të lashtë. Në këtë kohë ai zhvillohet pës kushte jo më të kufizuara nga muret rrëthuese, por mbi rrënojat e mbuluara të tyre. Këto ndërtesa, të para në planin vertikal, tregojnë për praninë e dy horizonteve banimi që mbulojnë njëri-tjetrin. Ky fakt vërteton, nga ana tjetër, për rindërtimet rrënjosore të qytetit të poshtëm, të bëra me dy faza të njëpasnjëshme.

Ndërtimet e para jashtë mureve rrëthuese kanë qenë të ngritura mbi shtresën aluvionale, e cila presupozon, siç është thënë, përmbytjen dhe mbulimin e një pjese të qytetit të poshtëm. Këto ndërtime duket se janë në një nivel më lkuotën e kaldrëmit të dytë dhe së bashku përcaktojnë fazën e parë të rindërtimit të qytetit mbi rrënojat e qytetit të lashtë dhe jashtë mureve rrëthuese të tij.

Ky nivel banimi përfaqësohet më mirë nga një ndërtesa, që u gjet para dhe mbi hyrjen kryesore të qytetit të lashtë, rrëth 0,70 m lartësi mbi nivelin e rrugës.

Ndërtesa e zbuluar këtu paraqet një godinë me hajat

përpara. Ajo rezulton e vendosur pjesërisht mbi muret e kullës së portës së lashtë dhe pjesërisht zhvillohet mbi ish-nrugën kryesore, në drejtim të tèrthortë, duke zënë kështu gjithë gjerësinë e rrugës para portës kryesore, që tanë duket qartë se nuk funksiononte.

Në ballin gjatësor të ndërtesës u gjetën gjurmët e kolonave të rrumbullakëta, të cilat janë të kuptohet ekzistencë e një hajati të mbuluar para ndërtesës. Me interes është të vihet në dukje se dyshemeja përdhese e hajatit është në një nivel me kuotën e kalldrëmit të dytë, për të cilin është folur më sipër. Këtu nuk mund të mendohet për një rastësi, por për një dëshmi tjetër, që vërteton praninë e horizontit të banimit në fjalë. Këto të dhëna tregojnë, nga ana tjetër, se muret e rrëthimit dhe porta e qytetit të Lisishtin të rrëzuara ose të prishura vende-vende deri në rrëshqat e parë mbi themelet e tyre.

Me këtë horizont banimi mendohet se duhet lidhur ndërtesa, pjesërisht e zbuluar 40 m në veri të godinës me hajat. Nga kjo ndërtesë janë zbuluar themelet e saj, që mbështeten fill mbi trotuarin e rrugës kryesore, për të cilin është folur më parë. Gërmimet arkeologjike në këtë sektor janë në vazhdim. Për aq sa është zbuluar, mendohet që ndërtesa të përfaqësojë ndonjë nga magazinat e qytetit, e rindërtuar në të njëjtën kohë me kalldrëmin e dytë dhe me ndërtesën me hajat. Të tria këto objekte u gjetën në një horizont banimi, i cili zë fill vende-vende në një kuotë rrëth 40-60 cm mbi nivelin e rrugës kryesore të qytetit të Lisishtit. Nga ana teknike, të dyja ndërtesat, që deri më sot mendohen se i përkasin këtij niveli, janë ndërtuar me gurë të vegjël të lidhur me llaç gëlqereje përzier me rrërë. Ndërtimet nën këtë horizont kanë qenë bërë kryesisht me qerpiçë me gurë ose edhe me tulla të pjekura balte, përzier me kashtë.

Në themelet e ndërtesës së magazinës janë përdorur edhe pllaka guri të nxjerra nga trotuari i rrugës, gjë që tragon se ajo ishte e mbuluar tërësisht.

Zbulimet e mëtejshme do të jepin mundësi për ta parë edhe më qartë planimetrinë e shtrirjes, funksionin dhe kohën e ndërtimit të këtij objekti.

Niveli i dytë i banimit përfaqësohet deri tanë nga një monument i zbuluar, thua jse tërësisht, në anën jugperëndimore të ndërtesës me hajat. Ky monument paraqet një banjë publike, themelet e së cilës janë mbështetur pjesërisht mbi rrënojat e banesës me hajat dhe pjesërisht mbi mu-

ret e rrëzuara të kullës mbrojtëse, e cila bëte pjesë në sistemin mbrojtës të portës kryesore të Lisisit.

Zgjidhja arkitektonike, konstruksioni dhe teknika e ndërtimit në këtë banjë, paraqesin ngjashmëri në formën e planimetrisë, në vendosjen dhe në funksionin e mijediseve të ndryshme, me banjat e zbuluara në Apoloni, në Butrint e në Durrës. I njëllotë paraqitet edhe sistemi hidraulik dhe ai i ngrohjes i aplikuar në këtë objekt. Përmasat e planimetrisë së ndërtesës dhe numri i vogël i mijediseve lënë të kuptohet se kjo është një banjë me një kapacitet të kufizuar shfrytëzimi, që i shërbente vetëm një lagjeje të qytetit. Nga ky monument ruhet planimetria, ku dallohet më mirë salla kryesore, me dy nikelë formë abside, vendet e posaçme përmes larje mbas banjës me avull. Në anën perëndimore dhe në atë veriore të ndërtesës, zhvillohen mijedise të tjera, por gjendja e tyre paraqitet shumë e dëmtuar, aq sa ato duken më tepër si pjesë të përshtatura, që u takojnë rindërtimëve të mëvonshme të bëra në këtë objekt.

Gjurmët e zbuluara në dyshemenë e sallës kryesore trajtojnë se ajo fillimisht ishte me ngrohje si nën dyshemenë e saj ashtu edhe në faqet vertikale të mureve perimetrale. fig. 17.

Ngrohja ishte arritur me anën e rrymave të ajrit të ngrohtë që kalonin nën dysheme dhe nëpër kanale të posaçme prej tubash qeramikë. Ajri i ngrohtë përshkonte edhe faqet e brendshme të mureve të sallës kryesore dhe të mijediseve të tjera.

Në sallën kryesore u gjetën në vendin e tyre pjesë nga kolonat e vogla, të ndërtuara me tulla të rrumbullakëta, të cilat shërbën përmes mbështetjen e dyshemesë dhe përmes krijuarit e kanaleve nga ku kalonte rryma e ajrit të nxeh të. Gjatë zbulimit të këtij objekti u gjetën edhe shumë pjesë të tubacionit qeramik, që shërbente përmes ngrohjen e pareteve të mureve në mijediset ku bëhej me avull. Jashtë ndërtesës dhe në anën lindore të saj u gjetën pjesë të tubacionit prej plumbi, që shërbente përmes furnizimin me ujë të rrjedhshëm. Uji, me sa duket, merrej nga burime të afërta, rrëzë kodrës. Këta tuba, që ishin rrëth 1 m të gjatë dhe me diametër 7-8 cm, u gjetën të vendosur pjerrtas, të futur njëri te tjjetri.

Muret e ndërtesës janë ngritur me gurë të vegjël e me tulla të vendosura në muraturë, lidhur me llaç gëlgereje. Tullat janë përdorur kryesisht në ndërtimin e qosheve të

mureve dhe të hyrjeve. Gunga e fasadës kryesore të ndërtuesës, në anën jugore të saj, është e veshur me copa tulash të prera në formë rombi, sipas teknikës së njohur me emrin «Opus reticulatum». Kjo veshje më tepër zbuluruese, ishte karakteristike për ndërtimet e objekteve shoqërore. Tullat e përdorura në këtë ndërtuesë duket se janë mbeturina të rrënojave të murit ndarës të qytetit kodrinor, sepse ato kanë përmasa të njëlojta dhe në shumicën e tyre nuk janë të plota. Tulla të tilla ndeshen si në ndërtimet më të hershme ashtu edhe në ato të mëvonshmet.

Në arkitekturën, në teknikën dhe në materialet e ndërtimit, që janë përdorur në këtë ndërtuesë, ka elemente të përbashkëta karakteristike, që ndihmojnë shumë pér të përcaktuar kohën e ndërtimit të vetë banjës dhe afërsisht të nivelist të banimit ku ajo bënte pjesë. Një element i dallueshëm mjafë mirë në këtë rast është pa dyshim edhe përdorimi i teknikës «Reticulatum» e cila, siç dihet, ishte në përdorim në shekujt I-II. Ndërtime, ku përfaqësoset më mirë kjo teknikë, janë zbuluar në Butrint, në Feniqi, në Durrës etj. Nisur nga fakti që në rastin e banjës së Lezhës është përdorur kjo teknikë, ku në vend të gurëve janë përdorur mbeturina të tullave të gdhendura në prizma kubikë, mund ië mendohet se ky është një rast unikal, që ndoshta përfaqëson fazën e fundit të përdorimit të teknikës «Reticulatum» në vendin tonë.

Nga të dhënat e mësipërme mund të kuptohet që banjat me avull, të zbuluara në Lezhë, kanë qenë ndërtuar aty nga fundi i shekullit II. Me këtë pra, duhet të lidhet edhe niveli i dytë i banimit të qytetit të poshtëm të Lisisit.

Duhet ditur se kjo banjë nuk ishte e vëtmuar, por një objekt që bënte pjesë në një kompleks të gjerë ndërtuesash shoqërore. Nga ana funksionale ajo plotësonte nevojat e popullsisë qytetare, duke treguar kështu një shkallë zhvillimi mjafë të ngritur të kushteve ekonomiko-shoqërore, sa të popullsisë qytetare aq edhe të asaj përreth tij.

Ky mendim mbështetet edhe në të dhëna të tjera, të cilat vërtetojnë praninë e ndërtimeve të kësaj periudhe edhe në periferi të qytetit, siç janë mbeturinat e një ndërtese në majën e kodrës së vogël, të quajtur Sukagjel, që gjendet rrëth 5 km në veri të Lezhës.

Nga punimet pér hapjen e një kanali kullues dhe pér sistemimin e shtratit të përroit të Qarrjes, në fshatin Mergjine, u hasën mbeturinat e një konstruksioni. i cili, me sa

duket, ishte një vaskë banje në formë drejtkëndëshi, e ndërtuar në thellësi të tokës, me përmasa rrëth 2×2 m gjëresi e gjatësi dhe e thellë 0,75 m. Kjo vaskë ishte e shtruar dhe e veshur me pllaka mermari të bardhë, të lidhura me llaç gëlqereje. Brenda saj u gjet një varr i ndërtuar anash dhe i mbuluar me pllaka guri të papunuar. Skeleti i dëmtuar i këtij varri ishte vendosur mbi shtresën e dyshemesë prej mermari dhe konstruksioni i tij tregon për një kohë shumë të vonë.

Krijohet përshtypja se kjo banjë është pjesë përbërëse e një shtëpie pasanikësh skllavopronarësh dhe pjesërisht ajo mund të jetë e mbuluar akoma edhe më shumë nga punimet bonifikuese të ditëve tona. Për një gjë të tillë tregon gjithashtu edhe qeramika e shumtë, që dallohet mirë në këtë vend në të dyja skarpatet e kanalit kullues.

Si përfundim, mund të thuhet se zhvillimi i qytetit të Lisit jashtë mureve rrëthuese mund të ketë filluar nga fundi i shekullit I ose fillimi i shekullit II dhe ka vazhduar deri në shekullin III. Në këtë kohë mendohet që ky zhvillim të jetë Ishtrirë edhe në periferi të qytetit me ndërtimin e banesave të pronarëve të mëdhenj skllavopronarë në mes të tokave të tyre.

KAPITULLI IV

LISI NË ANTIKITETIN E VONË DHE NË PERIUDHËN BIZANTINE

1. Lisi në shekujt IV-V

Rënia e ekonomisë skllavopronare, që solli edhe shkatërrimin e qyteteve të rëndësishme të antikititetit, si Apolonia etj., nuk duket se preku aq rëndë qytetin e Lisis. Vazhdimësia e jetës qytetare të Lisis edhe në kushtet e vështira të periudhës së antikititetit të vonë i kushtohet, në radhë të parë, zhvillimit ekonomik të këtij qyteti, bazuar kryesisht në degë të ndryshme e të shumëllojshme, si në artizanat, bujqësi e blegtori, shfrytëzimin e minierave, lëndës pyjore dhe tregtimin e prodhimeve të këtyre degëve.

Nga ana administrative Lisi në këtë periudhë bënte pjesë në provincën e Prevalit, qendra e së cilës ishte Shkodra. Në itineraret rrugore të periudhës së vonë antiqe qyteti përmendet dy herë me emrin Lissum: së pari, në rrugën Salonë-Dyrrah dhe së dyti, në rrugën që niset nga Lissum-Nais. Nga këto të dhëna mund të mendohet se Lisi vazhdonte të ishte një qendër e rëndësishme në rrjetin rrugor tokës e detar, që ishte në përdorim të vazhdueshëm gjatë kësaj periudhe.¹

¹ Iteneraret, 1 Tabula Peuntingeriana, Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, vëll 1, 1965, fq. 309, 311.

Nga tē dhēnat burimore tē tjera nēnkuptohet se Lisi përfshihet nē radhēn e atyre qyteteve që plaçkiten ose që dëmtohen rëndë nga dyndjet barbare. Pér shkak tē shtimit tē këtyre sulmeve dhe tē turbullirave tē brendshme, nē krahanat e ndryshme tē Ilirikut, gjatë shekullit IV, duket se bëhen përpjekje pér fortifikimin e qyteteve më tē rëndësishme tē këtij territori.

Të dhēnat arkeologjike pér këtë periudhë relativisht nuk janë tē pakta. Në materialin arkeologjik tē zbuluar në Lezhë mbizotërojnë fragmente qeramike, grykë, kapakë, vjega amforash dhe ndonjë monedhë e kësaj periudhe. Në shtresat e dheut, nē nivele tē ndryshme, janë dalluar shtresa tē holla tē zeza thëngjillmbajtëse, që vërtetojnë djegie në qytet.

Pér një rindërtim tē sistemit mbrojtës tē qytetit nē këtë periudhë dëshmojnë qartë disa gjurmë muresh, që ruhen nē majë tē kodrës tē akropolit antik. Ato janë tē dukshme akoma edhe sot nē pjesën e poshtme tē murit lindor tē kështjellës mesjetare, disa metra nē tē djathtë tē hyrjes kryesore tē këtij objekti:

Gjurmët e këtyre mureve bënin pjesë nē një fortifikim, ndërtuar mbi mbeturinat e mureve tē akropolit. Në këtë mbeturina muresh shquhen edhe gjurmët e një kulle mbrojtëse nē muret rrethuese tē këtij fortifikimi fig. 18.

Kjo kullë ka përmasa tē vogla dhe një planimetri karakteristike nē formë trapezi. Është ndërtuar thuajse ngjitur kullës më tē hershme, që bënte pjesë nē muret rrethuese tē akropolit antik.

Pjesët e ruajtura tē murit rrethues dhe kulla mbrojtëse shquhen nga ndërtimet fortifikuese tē mëparshme, si nga teknika e nga materiali i ndërtimit ashtu edhe nga forma e planimetrisë së kullave. Në këtë rast vërehet përdorimi pér herë tē parë i llaçit tē gëlqeres nē ndërtimet mbrojtëse. Kjo teknikë ndërtimi zë fill nē ndërtimet shoqërore dhe nē banesat e shekullit I tē qytetit tē Lisit. Teknika e ndërtimit tē mureve me gurë tē vegjël, tē punuar me çekanë e tē vendosur nē muraturë me llaç gëlqereje, është e njerohur edhe nē ndërtimet mbrojtëse tē kësaj periudhe, që janë zbuluar edhe nē kalatë e tjera tē vendit tonë, tē cilat njihen si gjurmë ndërtimesh tē shekullit IV. Duhet thënë se nē rreshtat e parë tē mureve tē kullës janë përdorur edhe biloqe gurësh tē marra nga rrënojat e mureve antike. Ato janë vendosur ndërmjet gurëve tē vegjël dhe janë lidhur

gjithashtu me llaç gëlgereje, përzier me rërë lumi të trashë, ngjyrë gri të errët. Ky llaç është më i dobët në krahasin më llaçet e përdorura në kohë më të vona, në ndërtimin e mureve të kështjellës mesjetare të Lezhës.

Me aq sa janë ruajtur gjurmët e mureve që u përmendën, është e vështirë të thuhet me siguri nëse ato i përkasin një kështjelle të vogël të ndërtuar mbi muret e akropolit apo ato përbëjnë rindërtime të pjesëve të mureve të rrëzuara nga fortifikimi antik i tij. Vështirë është gjithashtu të thuhet nëse ekzistojnë gjurmë të mureve rrëthuese të kësaj periudhe të ndërtuara për mbrojtjen e qytetit të poshtëm, i cili, siç u tha, ishte për një kohë të gjatë i pambrojtur.

Më e arsyeshme është të mendohet se në periudhën e antikitetit të vonë rivlerësohej pozicioni strategjik i majës së kodrës, që sundonte mbi qytet dhe se në majë të saj ngrihej një fortifikim me përmasat e një kështjelle, që siguronte mbrojtjen e qytetit nga sulmet e barbarëve, të cilat ishin shumë të shpeshta në këtë periudhë.

Gjurmët e këtij fortifikimi, ndërtuar qoftë edhe vetëm në përmasat e një kështjelle, të çojnë drejt mendimit se Lisi në këtë kohë ishte një qytet me tradita të vjetra dhe me një fuqi ekonomike relativisht të shëndoshë, aq sa ndërkokë, kur qytetet e tjera ishin në rënje e sipër, ai ishte në gjendje që të ndërtonte një sistem mbrojtës të ri, që do t'i siguronte vazhdimësinë jetës qytetare edhe në kushtet shumë të vëshitura të periudhës së vonë antike.

Gjetjet e shumta të fragmenteve dhe të kapakëve të amforave, të cilat dallohen nga ato paraardhëset si nga forma ashtu edhe nga përmasat më të vogla, dëshmojnë gjithashtu për vazhdimësinë e zhvillimit të tregtisë nëpërmjet rrugëve detare e tokësore.

Ndërtimi i kështjellës së vogël apo rindërtimi i shtigjeve të hapura në muret rrëthuese të akropolit antik, i shërbjen Lisit për një kohë relativisht të gjatë, thuajse deri në fillim të shekullit VI. kohë kur për këtë qytet fillon një periudhë e re.

Kështjella e Lisit u ndërtua në një kohë kur qyteti ndjente jo vetëm nevojën e mbrojtjes së tij, por edhe të mbrojtjes së qarkullimit rrugor, e tregtimit nëpërmjet rrjetit rrugor, që kalonte përgjatë bregdetit të Adriatikut dhe rrugëve që futeshin në thellësi të gadishullit të Ballkanit.

Masa mbrojtëse të këtij karakteri dhe të njëkohshme janë diktuar edhe gjatë Rrugës Egnatia, sidomos në zonën e Elbasanit dhe në pellgun e Korçës.¹

Përmasat e vogla të kësaj kështjelle nga njëra anë, shprehin mundësitë ekonomike të kufizuara të popullsisë qytetare, por nga ana tjetër, ndërmarrja e punimeve fortifikuese mbrojtëse tregon për një rimëkëmbje të qytetit. Kjo rimëkëmbje, edhe pse është në fazën fillestare, shpreh gjithashtu dëshirat dhe vendosmérinë e popullsisë vendase, që kërkon të ruajë e të mbrojë me çdo kusht gjithçka kishte arritur me aq sakrifica dhe në kushte shumë të vështira.

2. Lisi në shekullin VI

Rimëkëmbja e qytetit të Lisit, sikurse tregojnë të dhënat historike-arkeologjike, lidhet me fillimin e mijëvjeçarit të dytë të jetës së tij qytetare. Kjo periudhë përputhet afërsisht me fillimin e shekullit VI, kohë në të cilën ai vazhdonte të bënte pjesë në provinçat perëndimore të Perandorisë Bizantine.

Në burimet historike të kësaj periudhe, Stefan Bizantini,² në veprën e tij «Mbi qytetet dhe popujt», qytetin e Lisit, e përmend me emrin «Lissos», qytet i llirisë dhe Akrolisso, emri etnik: Lissios dhe Lisseus. Një autor tjetër, Prokopi i Cezaresë,³ i cili përshkruan të gjitha fortifikimet që ndërtoi Justiniani në kohën e tij, nuk e përmend fare emrin e Lisit si qytet i fortifikuar.

Në veprën e Hieroklit⁴ me titullin «Synecdemus» (shqëruesh udhëtimi), që konsiderohet si një burim i rëndësi-shëm pér njohjen e organizimit administrativ të Ilirikut, në

1 N. Ceka, «Fortifikime të vona antike pranë Rrugës Egnatia», *Monumentet*, 1974, nr. 7-8, fq. 71-89.

2 «Stefan Bizantini mbi qytete dhe popujt», *Burime të zgjedhura pér Historinë e Shqipërisë*, Tiranë, 1965, f. 417.

3 P. Cezarese, Lufta me vandalët, Mbi ndërtimet, L. IV, *Burime të zgjedhura*, f. 435-443.

4 Hierokli, *Synecdemus*, në *Burime të zgjedhura*, f. 465.

shekullin VI, qyteti i Lisit vihet në radhën e tri qyteteve kryesore të provincës Prevalisi: Skodra, Lissos, Dorakion.

Burimet historike të sipërpermendura përputhen edhe me të dhënat që dalin nga studimi i materialeve arkeologjike dhe i rrënojave të mureve mbrojtëse, që janë zbuluar si në qytetin e poshtëm, në atë kodrinor dhe në kështjellën majë kodrës. Nga këto të dhëna rezulton se qyteti i Lisit në shekullin VI ringrihet, në vija të përgjithshme, mbi truallin e qytetit ilir. Ai zhvillohet, gjithashtu, në të katër zonat e njohura: porti lumor qyteti i poshtëm, zona kodrinore dhe akropoli në majë të kodrës.

Duke gjurmuar mbeturinat e mureve rrethuese, që ruhen në sipërfaqe dhe të pjesëve të tyre që janë zbuluar nga gërmimet arkeologjike nga punimet e restaurimit, mund të arrihet që të përcaktohen edhe për këtë periudhë, linjat kryesore të planimetrisë së përgjithshme të qytetit. fig. 19.

Rivlerësimi dhe rigjenerimi i skemës urbanistike të qytetit të lashtë në periudhën bizantine dëshmon se ajo skemë është akoma e përshtatshme dhe se favorizohej nga një sërë faktorësh të rëndësishëm. Pozicioni gjeografik i vendit kishte akoma rëndësi të veçantë për mbrojtjen e qytetit dhe lidhej me zhvillimin ekonomiko-shoqëror të popullsisë qytetare, e cila vazhdonte të zhvillohej mbi bazën e të ardhurave nga artizanati, nga bujqësia, nga blegtoria, nga minierat dhe nga tregtimi, nëpërmjet rrugëve të ndryshme tokësore e detare.

Qyteti i Lisit ringrihet edhe një herë në këmbë, për të arritur deri në ditët tona, i vendosur në të njëjtin truall, por në një horizont banimi të ri e në një nivel më të ngritur. Ai ka lënë nën themel e tij një histori të lashtë e shumëshekullore dhe nis një histori të re.

Ky fakt ka një rëndësi të madhe, sepse dihet mirë që shumë qyteteve të përmendura të lashtësisë në këtë kohë nuk u kishte ngelur gjë veç emrit të tyre dhe shumë të tjerë ishin zhdukur fare nga faqja e dheut.

Në periudhën bizantine, shekulli VI, urbanistika e Lisit paraqitet me disa veçori të cilat duhet vënë në dukje. Përsëri edhe në këtë periudhë del nevoja e domosdoshme e fortifikimit, sepse rreziku i dyndjeve barbare ishte gjithnjë edhe më i madh. Masat mbrojtëse që u morën në periudhën antike të vonë ishin më tepër të kufizuara në ndërtimin e një kështjelle të vogël në majë të kodrës së qytetit.

Këto masa pra, duhen konsideruar si hapat fillestarë

në drejtim të mbrojtjes së përgjithshme të Lisisit, që ishte gjithnjë në rritje.







Në dritën e këtyre të dhënave bëhet edhe më i qartë fakti që problemi i fortifikimit të këtij qyteti ishte një problem që kishte filluar të zgjidhej, brenda mundësive, nga vetë popullsia vendase, qysh në periudhën antike të vonë dhe mund të mendohet se ky problem ishte përfunduar para masave mbrojtëse që merren nga Justiniani. Ky do të ishte edhe shpjegimi i drejtë i mospërmendjes së Lisisit në listat e gjata të qyteteve të fortifikuara, për të cilat bën fjalë Prokopi i Cezaresë.

Në përshtatje me kushtet ekonomiko-shoqërore të popullsisë qytetare si edhe në bazë të kërkesave të reja politiko-ushtarake të kohës duket se në radhë të parë bëhen përpjekje për fortifikimin e qytetit të poshtëm me një sistem fortifikimi të veçantë nga ai i zonës kodrinore dhe i kështjellës.




Në të vërtetë, për këtë periudhë shumë çështje që lidhen drejpendrejt me masat mbojtëse të Lisisit janë akoma të paqarta mirë, sepse pjesa më e madhe e qytetit është akoma e pazbuluar. Megjithëkëtë, në gjendjen e sotme mund të flitet në vija të përgjithshme lidhur me përqendrimin e qytetit të poshtëm brenda një kalaje të ndërtuar në këtë periudhë. Deri në njëfarë mase mund të përkufizohet edhe zona kodrinore e fortifikuar. Për sa i përket kështjellës majë kodrës, të dhënat e deritanishme janë shumë të kufizuara dhe ato pak gjurmë që dihen tregojnë më tepër se në këtë periudhë duhet të jetë bërë një përforcim i kështjellës së ndërtuar më parë. Ka gjurmë që tregojnë se edhe porti lumor ka qenë rifortifikuar, gjithnjë mbi mbeturinat e fortifikimeve ilire.

a. Fortifikimi i qytetit të poshtëm. Kalaja e Lisisit.







Sikurse tregojnë gjurmët e mureve rrethuese dhe kullat e zbuluara deri tani, sistemi i fortifikimit të kësaj zone të qytetit kishte një planimetri në formën e një drejtkëndëshi të gjatë, me përmasa 260×60 m. Forma drejtkëndore, siç dihet, është karakteristike për periudhën antike të vonë dhe është përdorur gjérësisht edhe në periudhën bizantine. Me një formë të tillë kanë qenë ndërtuar rövë vendin tonë edhe









TAB. II




TAB. III.






TAB. V.



TAB. VI.



shumë kala të tjera, si ajo e Elbasanit, e Vigut, e Paleokastrës etj.

Duke ndjekur gjurmët e mureve rrëthuese, të zbuluara në zonën e qytetit të poshtëm, arrihet të fiksohet qartë, në gjithë gjatësinë e tij, vetëm muri i rrëthimit të krahut jugor. Muri perëndimor është zbuluar deri në gjysmën e gjatësisë dhe muri rrëthues i anës lindore mund të ndiqet vetëm në një largësi rrëth 60 m, kurse muri verior, së bashku me pjesët e tjera të murit perëndimor e atij lindor, që lidhen me të, deri sot janë shumë pak të dokumentuar.

Muret rrëthuese dhe kullat mbrojtëse, të zbuluara në anën jugore dhe atë perëndimore, janë ngritur mbi mbeturinat e mureve rrëthuese të qytetit iliri.

Gjurmët më të qarta të sistemit fortifikues të periudhës bizantine në qytetin e poshtëm, janë mbeturinat e murit lindor. Ky mur dallohet nga ndërtimet e tjera si nga ana konstruktive ashtu edhe nga materiali e nga teknika e ndërtimit. Muri lindor, për aq sa është zbuluar, paraqitet si mur i ndërtuar që nga themeli, me një strukturë dhe teknikë karakteristike; ai tregon përmbylljen e qytetit zejtaro-tregtar brenda një territori të mbrojtur me mure e me kulla në të katër anët e tij. Në këto rrëthana zona e qytetit të poshtëm përfshihet brenda një kalaje me përmasa e me sipërfaqe afërsisht sa ishte edhe zona e qytetit ilir breglumor.

Në dallim nga pjesa tjeter e sistemit mbrojtës të zonës kodrinore dhe të kështjellës, kalaja e qytetit të poshtëm do të emërtohet kalaja e Lisit, sepse ajo paraqitet me të gjitha karakteristikat e një kalaje, sikurse janë edhe ato të qyteteve të tjera të vendit tonë.

Muri i anës lindore të kalasë është i ndërtuar kryesisht me bloqe gurësh të gdhendur, të mbledhur nga muret e rrëzvara të kohës ilire. Këto bloqe janë vendosur në muraturë, afér njëri-tjetrit, në rreshta horizontalë dhe janë lidhur me llaç gëlgjereje. Fugat vertikale, boshllëqet ndërmjet bloqueve të gurëve të mëdhenj, që nuk bashkohen mirë njëri me tjetrin, pér shkak të gdhendjes së tyre fillestare me kënde të ndryshme, janë të mbushur me gurë të vegjël. Rrësia guri ose tulla të thyera janë vendosur edhe përmes nivellerimit e fugave horizontale. Në shumicën e rasteve, bloqet e surëve me prejardhje nga muret ilire janë vendosur në muraturë, me faqen e tyre të zhytur në një shëtresë llaçi të bollshëm. Një vendosje e tillë në muraturën e kohës bizantine, sikurse është vërtetuar edhe në raste të ngjashme

në qytete të tjera: Butrint, Bylis, Berat, etj., ka qenë e kushtëuar, për vetë faktin se muratura me llaç gëlqereje duhet ta kishte faqen e dukshme të sheshtë e të pashuar me plumbçe dhe jo të gunguar, sikurse paraqitej në teknikën e thatë të mureve ilire.

Themelet e murit lindor të Kalasë së Lisis janë hapur në një tokë me shtresa kulturore të kohëve më të hershme. Ky mur ka në anën e jashtme një faqe të sheshtë dhe blloket antike janë zgjedhur e janë vendosur me kujdes, të bashkuar njëri me tjetrin shumë mirë, saqë duken sikur janë gdhendur posaçërisht për këtë mur. Nga ana e brendshme muri paraqitet i ndërtuar dosido, blloket e gurëve janë vendosur pa rregull dhe dalin me gunga në sipërfaqen e dukshme të këtij muri. Nga ana konstruktive muri lindor paraqet një variant, mund të thuhet, të pahasur deri tanë në ndoni kala tjetër të vendit tonë. Në faqen e brendshme muri ndërpritet, në largësi afersisht të barabarta. 5 m nga pilastro drejtikëndore, të cilat, siç duket, kanë shërbyer përmështetjen e dyshemesë prej druri që zëvendëson sheshkalimin e murit rrethues. Siç dihet, ky sheshkalimi zakonisht është gjetur i ndërtuar në bërthamën e murit gjatë bedenave. Në rastin konkret, meqenëse muri lindor kishte një gjerësi relativisht të vogël (1 m), atëherë sheshkalimi ishte i ndërtuar me konstrukcion dhe me dysheme prej druri, që mbështetej në daljet e pilastrave të sipërpërmendura.

Në drejtimin jugor, muri lindor lidhej me kullën e qoshes juglindore të kalasë, e cila ruan gjurmë të qartë, që dëshmojnë se ajo është e njëkohshme me murin lindor.

Gjurmë të ngjashme, si nga materiali ashtu edhe nga teknika e ndërtimit, ruhen gjithashtu edhe te kulla e qoshes jugperëndimore dhe tek ajo veriperëndimore. Për sa i përket kullës. që do të ishte për analogji në qoshen verilindore të Kalasë së Lisis, deri më sot nuk ka ndonjë të dhënë të sigurt.

Për sa u takon hyrjeve dhe rrugëve që pëershkonin sistemin e fortifikimit të qytetit të poshtëm, d.m.th. të Kalasë së Lisis. ka disa të dhëna, që drejtpërdrejt të shpien në përcaktimin e vendit të tyre. Gjatë gërmimeve të kryera në anën veriore të qytetit, të cilat kishin për qëllim nxjerrjen në dritë të murit rrethues të qytetit ilir të Lisis, ndër të tjera u gjetën edhe pjesë të copëtuara, që ishin fragmente të një harku të ndërtuar me tulla të lidhura me

llaç gëlqereje. Këto për nga forma si edhe nga vendosja e tullave, dëshmojnë për mbeturina të një harku, që mbulonte hapësirën e një porte të madhe.

Tullat, me të cilat ishte ndërtuar harku i kësaj porte, në pjesën më të madhe ishin të vulosura me nga një monogram në mes të sipërfaqes së tyre. tab. VI.

Gërmimet në këtë sektor ishin të përqendruara në një sipërfaqe të kufizuar dhe nuk mund të zhvilloheshin në drejtimin lindor, sepse pikërisht aty kalonte rruga kryesore automobilistike Lezhë-Shkodër. Në këtë sektor, siç është përmendur, ishte porta veriore e qytetit ilir të Lisit, pra edhe gjurmët e harkut të gjetur mundet që i përkasin portës veriore të Kalasë së Lisit.

Në gërmimet e kryera në pjesën jugore për nxjerrjen në dritë të portës kryesore të qytetit ilir u gjetën copa tullash, të cilat ishin edhe këto të vulosura me të njëjtin monogram, sikurse edhe ato të portës veriore. Edhe në këtë rast mund të mendohet për praninë e një porte tjeter të hapur në anën jugore të kalasë, pikërisht mbi hapësirën e mbushur të portës ilire.

Si giurmë të tjera të kësaj porte duhen konsideruar edhe disa meremetime, që janë bërë mbi mbeturinat e murit perëndimor të kullës ilire, të zbuluara në anën e djathë të portës së kalasë. Këto meremetime dallohen nga vendosja dhe nga lidhja me llaç gëlqereje e një rreshti, i cili është ndërtuar me bloqe gurësh të gdhendur, të marrë nga rrënojat e mureve të kullës ilire.

Siç duket, të dhënat e përmendura sugjerojnë që të arrihet në përfundim se Kalaja e Lisit kishte të paktën dy porta kryesore: një në anën jugore dhe tjetrën në anën veriore, të vendosura pikërisht në të njëjtin vend, ku ishin edhe portat antike të qytetit të Lisit.

Duke pasur parasysh se në kala të tjera portat e tyre, të vendosura në vii të drejtë dhe në dy mure paralele, janë të lidhura gjithmonë me një rrugë, atëherë mund të supozohet se edhe në Kalanë e Lisit, ndërmjet dy portave të sipërpermendura, kalonte përsëri rruga që përshkonte qytetin nga jugu në veri.

b. Porti lumor

Për ekzistencën dhe për funksionimin e portit lumor në këtë periudhë duhet nisur nga disa gjurmë të qarta mu-

resh dhe rrënojat e një kulle që ruhen në breg të lumit të sotëm mbi kullën dhe mbi murin antik, i cili mbronte krahun verior të portit lumor. Gjurmë të tjera muresh me llaç gëlqereje janë diktuar gjithashtu në anën jugore; edhe këtu mund të mendohet se ato mbështeten mbi muret më të hershme.

Ajo që vërteton edhe më konkretisht komunikimin e portit lumor me kalanë e qytetit eshtë prania e një hyrjeje tjetër në anën e murit perëndimor. Kjo hyrje funksiononte ndërmjet dy portave, të vendosura në kullën e dytë, që mbronte anën perëndimore të kalasë. Gjurmët e portës së jashtme duken qartë në pjesët e ruajtura të murit verior të kullës, ndërsa ato të portës së brendshme më pak të qarta, janë në murin perëndimor. Këtu ruhen më mirë pjesë muri të rrëzuar nga qemeri i kësaj porte, i cili ishte ndërtuar me rulla e llac gëlqereje. Këto mbeturina, të njëlllojta me ato të portës veriore të kalasë, tregonjë për ndërtimin e një-kohshëm të tyre.

Vendosja e këtyre portave, në mënyrë që hyrja e dalja të bëhej tërthor dhe e kontrolluar brenda katit përdhe të kullës eshtë një zgjidhje interesante, e pahasur në kalatë e tjera të vendit tonë, sepse jo vetëm që e maskon hyrjen, por edhe e mbron shumë mirë nga sulmet që mund të vinin nga lumi.

Duhet thënë se hapësira e portës së jashtme, që ishte në murin verior të kullës, u gjet e myllur me mur guri me llaç gëlqereje, gjë që tregon se ajo nuk ka funksionuar në kohë të mëvonshme.

c. Fortifikimi i zonës kodrinore

Në rimëkëmbjen e sistemit të fortifikimit të përgjithshëm, edhe zona kodrinore paraqitet me një fortifikim të vecantë, i cili duket se bazohet kryesisht në meremetimin e mureve rrëthuese më të hershme, sidomos në anën lindore dhe në atë jugore, ku muret rrëthuese të qytetit ilir duhet të kenë qenë në gjendje mjaff të mirë. Ky mendim përforcohet edhe nga gjurmë shumë të qarta që ruhen akoma edhe sot, sidomos në anën lindore, ku muri ilir edhe ndonjë kullë mbrojtëse e tij ruhen akoma deri në 2-3 m lartësi.

Muri rrëthues i kësaj zone, i ndërtuar i ri që nga the-

meli duket se është ai perëndimor, i cili ngrihet pjesërisht mbi trasen e murit ndarës të qytetit të Lisis. Duke filluar që nga jugu, ai ngjitet përpjetë në drejtim të veriut deri në majë të kurrit të tij. Këtu bën një kthesë dhe, duke **ndje-kur** murin ilir në një largësi prej 20 m, e lë atë dhe **vazhdon** në të njëjtin drejtim për 20 m të tjera. Më tej ky mur nuk duket më në sipërfaqe. Duhet përmendur se muri në sjalë duke ndjekur drejtimin lindor, dëshmon se bashkohet me muret e kështjellës dhe në këtë mënyrë lë jashtë rrithimit pjesën veriore të shpatit kodrinor, që dikur rrithohej nga muret ilire. Pra, në këtë rast, shihet një tkurrje e zonës kodrinore në periudhën bizantine.

Gjatë këtij drejtimi perëndimor dallohen gjurmët e një kulle të vetme, e cila është ndërtuar në anën e brendshme të zonës së rrithuar; kulla ka formë drejtkëndore dhe ngrihet pjesërisht mbi murin ndarës të kohës romake dhe pjesërisht mbi muret e njërit nga mjediset ushtarake të së njëjtës periudhë.

Muri perëndimor dhe pjesa e tij, që shkon në drejtimin lindor, ruhen në pjesën më të madhe në një rresht gurësh, blloqesh antike, të vendosura njëri pas tjetrit me llaç gëllëreie; me të njëtin material dhe teknikë paraqiten **edhe** mbeturinat e kullës. Më tepër ky mur ishte ruajtur deri në lartësinë 2 m vetëm në pjesën ku ai mbyllte hapësirën e korridorit të portës së brendshme, që i përkiste sistemit të fortifikimit të periudhës romake.

Disa rrënoja muresh ndërtuesash, që duken në sipërfaqe. në anën e brendshme të murit perëndimor, me rezervë mund të konsiderohen si mbeturina të banesave të ndërtuara në periudhën bizantine, në zonën kodrinore të qytetit.

Lidhur me hyrjet që pëershkonin sistemin e fortifikimit të zonës kodrinore deri më sot nuk ka ndonjë të dhënë të sigurt, sepse nga muri perëndimor ruhen vetëm gurët e rrështit të parë të themelit të tij. Megjithëkëtë mund të mendohet se për këtë zonë, edhe në kohën bizantine, kanë qenë gjithnjë në përdorim porta e Gaviarit, porta e vogël dhe porta jugperëndimore e Lisis ilir.

d. Kështjella e Lisis

Në periudhën e hershme bizantine, Kështjella e Lisis duket se ishte në gjendje relativisht të mirë. Sikurse e trajtojnë disa gjurmë muresh, që dallohen nga ndërtimet e tjera

paraardhëse, në këtë kohë ajo përforcohet me një kullë, e cila kishte për qëllim mbrojtjen e portës kryesore të kështjellës që ndodhej në anën lindore. Mbeturina të kësaj kulle ruhen në qoshen juglindore të mureve rrethuese të kështjellës. Për aq sa ruhen në sipërfaqe, këto mure dëshmojnë për një ndërtim të ri, që i mbështetet kullës së akropolit antik.

Për ndërtimin e kullës janë ripërdorur gjithash tu bllqe gurësh të gdhendur dhe ndërmjet tyre janë përdorur copa tullash të trasha, edhe këto të mbledhura nga rrënojat e sistemit të fortifikimit të kohës romake.

Përdorimi i tullave të kuqe në fugaturat vertikale, më rrallë edhe në ato horizontale, i ka dhënë muraturës një pamje të veçantë nga ndërtimet e tjera të Kështjellës së Lisis, por nga ana tjetër të njëllojtë me muret mbrojtëse të periudhës bizantine, të ndërtuara në Butrint, në Berat, në Bylis etj.

Periudha e ndërtimit të kësaj kulle lidhet edhe me materialin e vogël arkeologjik, që ka dalë në gërmimet arkeologjike të bëra brenda territorit të kështjellës (fragmente qëramike dhe monedha të hershme bizantine).

Përveç këtyre, me këtë periudhë lidhen edhe disa mbeturina të vogla ndërtimi, që vihen re në murin jugor të kështjellës. Në këtë mur, jo shumë larg kullës së përmendur, ruhet një trakt rrëth 2 m i gjatë, i cili duket se është në vendin e tij fillestare dhe ruan gjurmët e një brezi lidhës, ndërtuar me 5 rreshta tullash, me përmasa $27 \times 34 \times 3.5$ cm. Tullat janë të vendosura në rreshta horizontalë me shtresa llaçi prej gëlqereje e rërë, përzier me zhavorr të imët. Në dy skajet gjatësore ky trakt muri ndërpritet nga ndërtimi të mëvonshme. Me interes është edhe fakti që më tutje nga trakti i përmendur vihen re pjesë të vogla ose blloqe muri të rivendosura në muraturën e mëvonshme. Siç tre-gojnë tullat e përdorura, këto bllqe duket qartë se janë marrë nga pjesë të rrëzuara të murit me breza tullash. Kjo gjë vërtetohet edhe pse një nga këto bllqe është i vënë me tullat e brezit, të vendosura në drejtim vertical.

Në njérën nga tullat e përdorura në brezin lidhës të murit të përmendur, është konstatuar një monogram në formë kryqi të stilizuar. Ky monogram, për nga kompozimi, paraqitet i njëllojtë me njërin nga monogramet e përdorura në monedhat e prera në kohën e perandorit Justinian. Të nisur nga ky monogram si edhe nga përmasat e tullave të

përdorura në këtë rast, mund të arrihet në përfundimin se fragmenti i murit të përmendur bënte pjesë në punimet përforcuese të kryera gjatë shekullit VI në kështjellën e këtij qyteti.

Këto punime mendohet se janë bërë në fazë të ndryshme dhe nuk mund të konsiderohen të menjëherëshme me ndërtimin e kullës, sepse nga ana teknike ato rezultojnë të ndryshme. Meqenëse trakti i murit me breza tullash është i vogël dhe përfaqëschet vetëm në një pjesë të murit rrethues, atëherë mund të supozohet se në rastin konkret është bërë një meremetim i murit të anës jugore të kështjellës.

Për këto arsyen, si përfundim, mund të supozohet se Kështjella e Lisit, e ndërtuar gjatë shekullit IV, ishte deridiku në këmbë edhe në periudhën bizantine. Në këtë periudhë janë bërë, në fazë të ndryshme, punime me karakter mirëmbajtës dhe përforcues. Nëpërmjet këtyre punimeve, gjurmët e të cilave përshkuën më sipër, është rritur aftësia mbrojtëse e kështjellës, si një hallkë e rëndësishme e sistemit të fortifikimit mbrojtës të përgjithshëm të Lisit.

Në periudhën e hershme bizantine Lisi paraqitet si një qytet, që pas një kohe të gjatë shekulllore, nën presionin e kushteve të vështira të pushtimit romak, arrin të rimëkëmbet. Kjo rimëkëmbje nuk është një dukuri e vecantë. Historiani Milan Shuflai¹ shkruan se qytetet dhe kështjellat shqiptare, pas shekullit V, krijohen si bërrhama të reja, me përpjekjet e popullsisë vendase për vetëmbrojtje. Ky mendim i arritur nëpërmjet dokumenteve historike, gjen mbështetje të plotë në gjithë të dhënrat kërkimore arkeologjike. Përpjekjet e popullsisë vendase për vetëmbrojtje janë të dokumentuara edhe në rrënojat e sistemit të fortifikimit mbrojtës. të cilët duken akoma edhe sot në qytetin e Lisit.

Me interes është edhe një burim historik tjetër, që trengon se Lisi në këtë periudhë ishte qendër episkopale dhe flet në të njëtin kohë edhe për braktisjen e qytetit nga peshkopi, në vitin 592, për aq kohë sa qyteti ishte në duart e armiqve.² Ky burim historik është i fundit për periudhën e hershme bizantine, ku përmendet qyteti i Lisit dhe vështirë është të thuhet diçka lidhur me armiqtë që e kanë

¹ M. Shuflai, *Serbët dhe shqiptarët*.

² Acta et Diplomata res Albaniae..., f. 40.

pushtuar atë. Kjo e dhënë historike ka rëndësi të veçantë, sepse me të lidhen disa të dhëna të përfituar nga gjermimet arkeologjike, që janë kryer në kishën e shën Kollit. që kishin për qëllim përcaktimin e vendvarrimit të Skënderbeut. Ndëri shtresëzimet e ndryshme arkeologjike u gjetën disa shtresa dyshemeshë, mure e absida të ndërtuara njëra mbi tjetrën, që tregojnë qartë për ndërtim kulti të kohëve të ndryshme. Del se në këtë vend, qysh në kohët më të para të shpalljes së lirë të fesë kristiane, kanë qenë ndërtuar objektet e kultit për zhvillimin e ceremonive fetare (fig. 20).

Supozohet se me faltoren fillestare, që është ndërtuar në këtë vend, lidhen edhe mbeturinat e dyshemës së shtruar me tulla, të cilat u zbuluan në anën perëndimore, brenda kishës së vendvarrimit të Skënderbeut. Kjo dysheme, që u zbulua në thellësinë rrith 1.20 m, ishte e shtruar me tulla të vendosura mbi një shtresë llaç gjelqereje të bardhë. Ajo shtrihej në një sipërfaqe rrith 15 m^2 dhe dukej se i kalonte kufijtë e caktuar nga muret e kishës së vendvarrimit. Ky fakt dëshmon për përmasat e mëdha që duhet të kishte faltorja e parë e ndërtuar në këtë vend. Mundet që këtij objekti t'i përkasë edhe një shtyllëz e gdhendur në gur, që u gjet në anën veriore jo shumë larg mureve të kishës së vendvarrimit. Kjo shtyllëz, me përmasat $0.90 \times 0.35 \text{ m}$, dhe me formën e gdhendur të trupit të saj, përfaqëson një element karakteristik të arkitekturës kishtare, të përdorur kryesisht në kishat e mëdha të periudhës bizantine.

Shtyllëza të tilla përdoreshin në dritat e faltoreve pëendarjen e hapësirës së dritës në dy ose në tri pjesë të barabarta. Ky element, megjithëse i vetëm, dëshmon qartë se i përkiste një kiske të hershme. të ndërtuar me një arkitekturë, ku zënë fill elemente të tilla karakteristike të faltoreve bizantine.

Në driten e këtyre të dhënave, mund të thuhet se objekti për të cilin bëhet fjalë është kisha katedrale, ku kryente funksionet fetare peshkopi i Lisit, që përmendet në burimin historik të vitit 592.

Si bashkëkohëse e katedrales së Lisit mund të konsiderohet edhe një faltore tjetër, gjurmët e së cilës janë diktuar rrith 1 km larg Lezhës, në bregoren që ngrihet buzë rrugës automobilistike, e cila të shpie në Shengjin. Nga punime të rastit, këtu janë konstatuar mbeturina muresh dhe pjesa e poshtme e një abside. Në afërsi të saj janë ha-

sur edhe varre. Varre tē njëlljoita janë gjetur edhe nën dyshemenë e altarit tē kishës. Por ajo që tē shtyn më tepër pér tē menduar pér praninë e një faltoreje tē hershme edhe në këtë vend, është pa dyshim një kapitel i vogël prej guri tē gdhendur, që është gjetur në afërsi tē rrënojave tē përmendura. Ky kapitel është i zbukuruar në tē katër anët me gjethë akanthi, tē gdhendura në gur nga një dorë e stërvitur në këtë mjeshtëri. Për nga forma, nga përmasat dhe sidomos nga trajtimi stilistik, kapiteli i gjetur këtu vërteton më së miri praninë e një kishe, bashkëkohëse e katedrales së Lisisit (foto 14). Duhet përmendur bashkë me kapi-telin u gjet edhe një skulpturë antike, ku paraqitet një «Eros», i cili është përmendur më parë. Kjo skulpturë e gdhendur me mjeshtëri në mermer tē bardhë duket se është një kopje e kohës romake. Gjetja e kësaj skulpture në territorin e një faltoreje lë shteg pér tē menduar se ajo dikur ruhej këtu si skulpturë kishtare, duke u konsideruar si përfytyrim i një engjëlli me fletë.

Së fundi, duhet thënë gjithashtu, se ndërmjet këtyre gjetjeve janë zbuluar edhe monedha bizantine prej bronzi tē kohës së perandorit Justinian.

Pas gjithë këtyre objekteve tē zbuluara në këtë vend s'ka dyshim se këtu duhet tē ketë qenë një kishë, një manastir ose edhe vetë selia e peshkopit Joan, sikurse emërtotoj peshkopi i Lisisit në letrën e papa Georgit I, dërguar në vitin 592.¹

Prania e këtyre dy kishave tē hershme bizantine dha vetë dokumentimi i një peshkopi me qendër në qytetin e Lisisit tregojnë pér rëndësinë dhe pér zhvillimin ekonomiko-kulturor që kishte ky qytet në prag tē rimëkëmbjes së tij në periudhën e hershme bizantine.

Materialet e imëta arkeologjike, që janë zbuluar këtu, plotësojnë deri në njëfarë mase edhe kuadrin e zhvillimit tē jetës qytetare si edhe marrëdhëni me qytetet e mëdha përreth Lisisit.

1 Acta. Alb. Vep. cit. f. 40.

KAPITULLI V

LISI ILIRO-ARBËROR

(Shekujt VII-XII)

1. Te dhëna historike

Në vazhdim të zhvillimit të mëtejshëm të ngjarjeve, qyteti i Lisit nuk përmendet më në burimet historike, për një periudhë mjaft të gjatë, që nga shekulli VII dhe deri në fillim të shekullit X. Kjo periudhë treshekullore është vëzantinore e errët edhe pér shumë qytete të tjera të vendit tonë. Pér të qenë më të saktë në këtë drejtim duhet shtuar se përmendja e Lisit, si qytet bregdetar ilir, nga Anonimi i Ravenës, shekulli VII-VIII, nuk është marrë parasysh, pér faktin se ky autor, siç pohon edhe vetë, është mbështetur në burime më të hershme se shekulli VII.¹

Kjo heshtje, apo ky boshllék që vërehet në burimet historike, pér një kohë kaq të gjatë, nuk do të thotë se ky qytet nuk ekzistonte më, por vetëm se si në këtë periudhë nuk përfshihet në zhvillimin e ngjarjeve historike më të rëndësishme të Perandorisë Bizantine, nga ku vijnë edhe burimet historike të kësaj kohe.

¹ Anonimi i Ravenës, Përshtkimi i botës IV, 15, Burime të zgjedhura pér Historinë e Shqipërisë, f. 487.

Duke iu referuar kërkimeve dhe studimeve arkeologjike të viteve të fundit, mund të thuhet se boshllëku i burimeve historike plotësohet deri në njëfarë mase nga të dhënat arkeologjike. Në dritën e këtyre të dhënave është vërtetuar se gjatë këtyre tre shekujve Lisi ka vazhduar të jetë një qytet zejtaro-tregtar, por me një prodhimtari të kufizuar në krahasim me të kaluarën e tij jo shumë të largët.

Deri më sot, të dhënat më të rëndësishme vijnë nga varreza arbërore e zbuluar në Qafën e Kalasë, Lezhë. Mënyra e varrimit, tipologjia e varreve si edhe objektet e ndryshme që u zbuluan këtu, tregojnë, për një përdorim të varrezës nga popullsia vendase, duke filluar që nga fillimi i shekullit VII.

Autori i zbulimit dhe i botimit të materialit arkeologjik të kësaj varreze, F. Prendi,¹ ka shprehur mendimin se ajo përfshihet në arealin e kulturës arbërore. Në këtë kuadër materiali arkeologjik paraqet interes të veçantë, pasi është i pari i këtij lloji që zbulohet në një qytet të lashtë mesjetar shqiptar. Në këto rrethana, mund të mendohet që në këtë periudhë Lisi duhet të ketë qenë një nga qendrat më kryesore të kultures, e ana llahel shtrigjat me arberit më të hershem.

Materialet e ndryshme, që janë gjetur në rrëth 40 varret e zbuluara deri më sot, janë të dhëna të rëndësishme, të cilat ndihmojnë, në radhë të parë, për të njoftuar objektet personale, veglat e punës, objektet e zhukurimit dho armët vetjake që përdoreshin nga popullsia vendase, nga shekulli VII në shekullin VIII.

Ndër këto objekte dallohen tekëza prej bronzi dhe hekuri me forma e me madhësi të ndryshme. Më të shumta në numër paraqiten thikat prej hekuri. Ato, në përgjithësi, janë gjetur nga dy copë së bashku. Thikat kanë forma të njëjolla dhe madhësi të ndryshme, pra edhe funksione të veçanta. Me sa duket, mund të mendohet se këto thika kanë qenë përdorur për therjen e bagëtisë së imët dhe për punime në dru. Thika e madhe mund të përdorej edhe si armë përvetësimbrojtje.

Si gjetje më të rralla paraqiten sëpatat prej hekuri, që përdoreshin si vegla pune dhe si armë mbrojtëse. Në varrezen e Qafës së Kalasë nuk mungojnë edhe armët si pajisje

¹ F. Prendi, «Një varrezë e kulturës arbërore në Lezhë», *Iliria* IX-X, 1979-1980, fq. 123-170.

luftarake (ato këtu paraqiten në disa tipa). maja shigjetash prej hekuri, të ngjashme me ato të gjetura në varrezën e Komanit dhe në atë të Krujës.

Objekte të tjera, që mbaheshin për zbukurim, si rrathë, tamthorë, unaza, gjilpëra etj., paraqiten të punuara sipas rastit në metale të çmuara, si ar, argjend dhe bronz. Objektit e zbukurimit janë punuar me forma të kërkuaara dhe të zbukuruara me mënyra të ndryshme e me mjeshtëri të një niveli artistik mjافت të ngritur.

Për nga vlera e materialit, nga mjeshtëria e përpunimit dhe e zbukurimit të këtyre objekteve, del në pah edhe dallimi i shtresave shoqërore të popullsisë vendase. Nga ana tjetër, nëpërmjet tyre përfaqësohen edhe degët e ndryshme të prodhimit zejtar, si degë të zhvilluara në të gjitha drejtimet.

Mbizotërimi i objekteve të derdhura e të punuara në bronz dëshmon gjithashtu për trashëgimin e traditave të kohëve të lashta, të shfrytëzimit të minierave dhe të përpunimit të këtyre metaleve të çmuara.

Objektet prej qeramike në këtë varrezë janë të pakta, si në formë, ashtu dhe në numër. Në përgjithësi, janë broka me grykë të vogël, me një vjeçë dhe me zbukurime shumë të thjeshta. Nga ana tipologjike dhe nga dekoracioni këto enë dëshmojnë për lidhje gjenetike me ato të periudhës së vonë antike, gjë që tregon vijimin e traditave vendase edhe në këtë fushë të prodhimit të poçerisë.

Prania e rruazave të punuara me brumë qelqi, me ngjyra e me teknologji të ndryshme, të cilat në përparësi nga objektet e tjera, kanë pasur një përhapje të gjerë territoriale dhe nië përdorim të shumtë në mesjetën e hershme, dëshmon gjithashtu për lidhje me vende përtet Adriatikut.

Në bazë të disa objekteve dhe të disa elementeve të ndryshme karakteristike, varreza e Qafës së Kalasë datohet e shekullit VII e në vazhdimësi edhe pas shekullit VIII. Kultura materiale që përfaqësohet në këtë varezë, është e përbashkët me atë të grüpuit kulturor të Komanit, ku shquhen transformimet ekonomiko-shoqërore, kulturore e gjuhësore të popullsisë autoktone ilire në atë arbërore.

Kohët e fundit, d.m.th. pas zbulimit të varrezës së Qafës së Kalasë, janë diktuar varre të njëlllojta, në anën veriore të kodrës, në tarracën ndërmjet Portës së Madhe dhe Portës së Burimit, sikurse janë diktuar edhe në vende të sheshta të shpatit jugor të kodrës.

Shtrirja kaq e gjerë e këtyre varreve, rrith e rrotull, nën majën e kodrës së kështjellës, vërteton se i gjithë ky territor, i cili dikur ishte i banuar, tanimë është kthyer në një vendvarrim.

Rrjedhimisht duhet menduar se qyteti i Lisit, gjatë shekujve VI-VIII ka pësuar një tkurrje apo zhvendosje të pjesëshme në territorin e banimit të tij. Në këtë periudhë ai është përqendruar kryesisht në zonën e qytetit të poshtëm dhe në territorin e kështjellës në majë të kodrës. Në këto kushte del qartë edhe përdorimi i varrezës së Qafës së Kalasë nga popullsia që banonte në territorin e kështjellës, kurse varreza e shtrirë në zonën kodrinore përdorej nga vetë popullsia e qytetit të poshtëm (fig. 21).

Fillimisht, tkurrja e vërtetuar e qytetit tregon nga ana tjetër edhe për rënien e nivelit ekonomiko-kulturor të popullsisë vendase. Gjithë këto kanë ndodhur si rrjedhojë e dëmeve dhe e shkatërrimeve të mëdha, të shkaktuara nga sulmet barbare e slave, që zënë fill nga fundi i shekullit VI. Kjo gjë vërtetohet edhe nga largimi i peshkopit të Lisit, në vitin 592, sikurse e thonë edhe burimet historike të sipërpërmendura.

Në këtë periudhë edhe Perandoria Bizantine, për shkak të turbullirave të brendshme dhe të presionit të vazhdueshëm të ushtrive të fiseve barbare, ndodhej në kriza të mëdha ekonomike dhe politiko-ushtarake. Për pasojë, edhe konsolidimi i pushtetit qendror në të gjitha krahinat perandorake ishte në shthurje e sipër.

Qyteti i Lisit si edhe qytetet e tjera në afërsi të tij, të dëmtuara rëndë ekonomikisht dhe ushtarakisht, ishin lënë jashtë vëmendjes dhe interesave më të rëndësishme të pushtetit qendror perandorak bizantin.

Në këto rrethana kaq të vështira, popullsia vendase u grumbullua në qytet për ta rindërtuar atë dhe për të rifilluar edhe një herë nga e para rrugën e mëtejshme të jetës së tij.

Gjendja e krijuar, mbas dyndjeve barbare, në qytetin e Lisit dhe në krahinën rreth tij, ishte nga më të vështirat, gjë që vërtetohet edhe nga vetë fakti se rimëkëmbja e qytetit zgjati për një periudhë të gjatë treshekullore.

Gjithë këto të dhëna e bëjnë edhe më të qartë formimin e qytetit iliro-arbëror të Lisit, si një qytet që rilind në kushte shumë të rënda dhe në mes dëmeve të mëdha materiale e shpirtërore. Ndërmjet këtyre dëmeve duhet përfshire

në radhë të parë, edhe shkatërrimi rrënjosor i sistemit të fortifikimit mbrojtës të qytetit. Si rrjedhojë e këtyre ngjarjeve, Lisi edhe një herë jetoi, për një kohë relativisht shumë të gjatë, në kushtet e një qyteti të hapur dhe fare të pambrojtur. Gjatë kësaj periudhe, si kalaja ashtu edhe kështjella, tërësisht të shkatërruara, nuk kishin asnë funksion mbrojtës.

Nga gërmimet arkeologjike të deritanishme nuk ka të dhëna për ndërtim shoqërore e kulti, të bëra gjatë shekujve VII-VIII dhe aq më pak gjetje monedhash të kësaj periudhe. Mungesa e këtyre të fundit në fondin e përgjithshëm të gjetjeve monetare të Lisis, që është kaq i pasur për periudhat më të hershme e më të vona se shekujt VII-VIII, është dëshmi që tregon për një kufizim të qarkullimit monetar dhe të tregtimit të mallrave në një territor të ngushtë, në krahinat më të afërta të tij.

Një mungesë e theksuar e qarkullimit monetar bizantin pasqyrohet në të gjitha qytetet mesjetare të vendit tonë. Në një studim të veçantë të këtij problemi, H. Spahiu arrin në përfundimin se, duke filluar qysh nga sundimi i Tiber-Kostandinit I¹ (582-602) monedhat bizantine të gjitura në territorin e Shqipërisë, vijnë duke u rralluar, derisa zhduken plotësisht me monedhat e prera nga Kostandini II (641-668). Kjo mungesë zgjati deri nga mesi i shekullit VIII.¹

Të dhënat e mësipërme vërtetojnë mjaft qartë edhe ndryshimet e ndjeshmë që bëhen në këtë kohë në strukturaën ekonomiko-shoqërore të popullsisë qytetare të Lisis.

Megjithatë, duhet vënë në dukje se ky qytet në këtë periudhë të vështirë arrii të ruaië e të zhvillojë karakterin e një qendre zeitaro-tregtare, e cila kishte lidhje të ngushtë me territorin përreth, bujqësor e blegtoral.

Në këto rrethana Lisi zë vendin e një treguesi të vërtetë, për atë çka është thënë nga S. Anamali, se gjallërimi i zeitarisë vendase, sidomos për shekujt VII-VIII, përbën një vëçori që nuk krahasohet as me kohën e Perandorisë Romake as edhe me antikitetin e vonë. Rigjallërimi i zeitarisë vendase konsiderohet nga ky autor edhe si tregues i ndryshimit të gjendjes ekonomike dhe i krijimit të një gjendjeje të re politike, sipas së cilës, treva e banuar nga shqip-

1 H. Spahiu, «Moneda bizantine të shekujve V-XIII, të zbuluara në territorin e Shqipërisë», *Iliria*, IX-X, 1979-1980, fq. 353-422.

tarët, që nga fundi i shekullit VI e deri në krijimin e Themës së Durrësit, njihet vetëm për emër Bizantin.¹

Rrjedhimisht, për këtë periudhë relativisht të gjatë shihet një zhvillim gradual, i cili në kushte shumë të vështira e ringre qytetin e Losit në radhën e qyteteve më kryesore të kohës së tij.

Si fazë më kulminante e rritjes së zhvillimit të qytetit të Losit, mendohet se duhet konsideruar periudha e shekujve VIII-IX, periudhë në të cilën popullsia vendase bëri përpjekjet e para për konsolidimin e vetëqeverisjes dhe të vetëmbrojtjes së qytetit.

Lidhur me këto probleme duhet marrë parasysh fakti që në këtë kohë Perandoria Bizantine ndodhej gjithnjë në situata ekonomiko-politike të vështira dhe kishte humbur tërësisht kontrollin mbi krahinat e largëta perëndimore. Kjo gjendje bëhet më e qartë edhe nga burimet historike, të cilat domumentojë se në kohën e perandorit Mihail II (820-829) kështjellat e Dalmacisë u bënë të vetësunduara, duke mos iu nënshtruar më as perandorit bizantin as edhe ndonjë tjetri. Shembullin e tyre e ndoqën edhe popullsitë kroate etj.²

Ndërmjet këtyre të dhënave historike del më e qartë gjendja e krijuar në krahinat perëndimore të Perandorisë Bizantine para riorganizimit të ri ushtarako-administrativ, i cili bazohej në sistemin e ri të themave. Këto të dhëna flasin tërthor për riorganizimin e popullsisë vendase të këtyre krahinave, duke pasur si baza kryesore qytetet më kryesore e përfaqësuese të tyre.

Si shembull vërtetues i këtyre ngjarjeve, mendohet se mund të merret, fare mirë, edhe qyteti i Losit. Ky qytet, siç është thënë, duke u mbështetur tërësisht në forcat e brendshme qytetare e krahinore, mundi të përballonte dëmet e mëdha të një shkatërrimi rrënjosor barbar dhe të arrinte të mbijetonte duke u bërë një qendër e rëndësishme dhe përfaqësuese e krahinës së tij. Për më tepër, duhet shtuar se Lisi përfaqësohet edhe në ngjarjet historike të një sfere më të gjerë e jashtëkrahinore.

1 S. Anamali, *Nga ilirët tek arbërit (shqiptarët e hershëm)* në shqipetarët dhe trojet e tyre, f. 110.

2 K. Porfirogjeniti, «Mbi drejtimin e perandorisë», *Burime tregimtare bizantine për Historinë e Shqipërisë*, Përg. për bot. nga K. Bozhani — Filip Liço, Tiranë, 1975, f. 21.

Lisi del përsëri në burimet historike, në gjysmën e parë të shekullit X nga Kostandin Porfirogjeniti, perandor e shkrimitar (905-959). Ky autor e përmend dy herë, në rastin e parë si qytet që vjen pas gjirit të Rizonit: Lisi dhe Akrolisi dhe Epidamni; dhe në rastin e dytë, të emërtuar Elison, si një ndër kështjellat e themës së Durrësit, që ishin në kuftë me themën e Dalmacisë.¹

Për rastin e parë duhet menduar se ky autor ka para-sysht burime më të hershme, kurse në rastin e dytë ai mbështetet në faktet dhe në dokumentet e ndarjes administrative të Perandorisë Bizantine.

Është me interes të vihet në dukje se përmendja e Elisonit në gjysmën e parë të shekullit X, si kështjellë e themës së Durrësit, e cila, siç dihet, është krijuar nga fillimi i shekullit IX, ka një rëndësi të veçantë për qytetin e Lisisit.

Në këtë burim jepen të dhëna mbi ndarjen administrative të themes së Durrësit dhe përmenden qytetet më të rëndësishme, të cilat mendohet se ishin të tilla që me krijimin e kësaj theme, në fillim të shekullit IX. Këto të dhëna shtyjnë për të menduar se ai qytet ishte i fortifikuar dhe se Kështjella e Elisonit është ndërtuar aty nga fundi i shekullit VIII, përderisa ishte këshjellë e themës së Durrësit në fillim të shekullit IX. Përfundimet e bazuara në njoftimet e K. Pofirogjenitit gjunjë një mbështetje të plotë në të dhënat arkeologjike dhe sidomos në identifikimin e rrënojave të mureve rrëthuese. Këto mure vërtetojnë jo vetëm qenësinë e Kështjellës së Elisonit por edhe praninë e një sistemi të përgjithshëm mbrojtës të Lisisit, të rindërtuar në shekullin VIII.

Duke i kushtuar një vëmendje të veçantë pikërisht ballafaqimit të burimeve historike dhe të dhënavë kërkimore arkeologjike për periudhën e shekuve VI-VIII, Lisi duhet konsideruar si qyteti i parë i vetëfortifikuar në fund të shekullit VIII.

Me këtë nuk duhet kuptuar se në këtë kohë nuk kishte qytete të tjera të fortifikura, por duhet tërhequr vëmendja për identifikimin e rindërtimeve të kësaj periudhe në këto qytete.

¹ K. Porfirogjeniti, *Mbi Thema*, Vep. cit., fq. 19-20.

2. Kështjella e Lisis (Elisonit)

Duke gjykuar mbi ato çka rûhen në Kështjellën mesjetare të Lezhës së sotme, mund të thuhet se pjesa më e madhe e mureve rrëthuese i përkasin pa dyshim, kohës së rindërtimit të bërë në fund të shekullit VIII. Kjo periudhë ndërtimi është më mirë e dallueshme në anët lindore, veriore dhe pjesërisht në atë jugore. Në këto raste muret rrëthuese ngrihen sipër mbeturinave të mureve të ndërtuara në kohë më të hershme, respektivisht, siç është thënë, të kështjellës së shekullit IV dhe të ndërtimeve përforcuese të saj të bëra në shekullin VI (fig. 22).

Në ndërtimin e Kështjellës së Elisonit kanë ndikuar edhe një herë: pozicioni gjeografik i vendit si edhe mbeturinat, në gjendje rrënoje të ndërtimeve të lashta. Për këto arsyen, kështjella nuk ka ndonjë formë të përcaktuar, por paraqet një planimetri, afërsisht në formë vezake, me majë nga perëndimi, pra edhe me aksin gjatësor të drejtuar lindje-perëndim. Muret rrëthuese janë ndërtuar, sipas rastit, në vija të drejta ose të harkuara dhe kanë kthesa me kënde të çrrëgulla.

Kështjella përbëhet kryesisht nga një mur që rrëthonte majën e kodrës, i cili ishte i përforcuar në qoshet kryesore me ndonjë kullë të improvizuar mbi ndërtime të lashta, që kanë forma jo shumë të rregullta. Kulla të tjera janë shumë pak të dala nga kurtina e mureve dhe kanë një ballë shumë të gjerë, aq sa ndonjëra prej tyre duket më tepër si një pjesë muri e dalë tej vijës perimetrale, sesa një kullë e mirëfilltë. Një përforcim i tillë është bërë në mes të gjatësisë së murit jugor dhe një tjetër në një kthesë të murit verior. E njëlllojtë me këto mund të konsiderohet edhe kulla e ndërtuar në qoshen perëndimore të kështjellës.

Po të vërehet në veçanti materiali i ndërtimit, konstrukioni i mureve dhe teknika e thjeshtë e përdorur në këtë kështjellë, duket qartë se ajo është një fortifikim i realizuar në rrëthana të ngutshme dhe me mundësi ekonomike e teknike relativisht të kufizuara.

Në kështjellë hyjej nga tri porta të ndërtuara në anët lindore, veriore e perëndimore. Dy portat e para janë ndërtuar në po ato vende ku ishin edhe dy portat e akropolit antik të Lisis. Porta perëndimore nuk ruan gjurmë të ndër-

timeve më të hershme dhe duket se ajo është ngritur me qëllim që kështjella të komunikonte me qytetin nëpërmjet një rruge më të shkurtër fig. 23.

Të tria këto porta janë të njëjlojta si nga zgjidhja arkitektonike ashtu edhe nga teknika e ndërtimit. Këto të dhëna ndihmojnë edhe për datimin e tyre si të njëkohshme me muret rréthuese të kështjellës. Portat janë ndërtuar me bloqe gurësh antikë, të gdhendur rishtas, me përmasa sipas atyre të secilës portë. Në pjesën e sipërme ato kanë formën e një harku pak të shtrirë. Të para nga ana e jashtme, porta veriore dhe ajo perëndimore ruajnë ende të plotë gjendjen e tyre fillestare, kurse porta e tretë, në anën lindore, është mjaft e dëmtuar dhe ruan vetëm gjurmë të formës fillestare të saj. Me gjithë paraqitjen e thjeshtë të këtyre portave, vlen për t'u përmendur si një element karakteristik, përdorimi i harkut të shtrirë, i realizuar, sikurse edhe gurët e qosheve me prejardhje nga mbeturinat e mureve ilire.

Harku i shtrirë, si element konstruktiv e arkitektonik, është përdorur më rrallë nga harku gjysmërrathi, që gjendet në të gjitha kalatë e vendit tonë. Ky element është përdorur edhe në ndërtimin e portave kryesore të Kalasë së Shkodrës. Në këtë rast ato dallohen për nga përmasat madhështore dhe nga teknika më e arritur e përpunimit të bloqeve të gurëve të përdorur në ndërtimin e tyre.

Portat e Kalasë së Shkodrës, të punuara me mjeshtëri të përsosur, u morën më tepër si shembull krahasimi për të treguar edhe një herë se Kështjella e Lisit përfaqëson periudhën fillestare të teknikës së ndërtimeve fortifikuese mesjetare në vendin tonë.

Teknika e ndërtimit e kësaj kështjelle karakterizohet nga ndërtimi i mureve me gurë të vegjël e mesatare, të gdhendur me çekan e të vendosur në muraturë me llaç gëlqereje, përzier me rërë të trashë. Trashësia e mureve mbi thembrën e tyre, luhatet nga 1.50 deri në 2 m. Lidhja konstruktive e muraturës është realizuar me anën e brezave të ndërtuar me trarë druri, të vendosur brenda murit horizontalisht. Trarët lidhen me binarë, të mbërthyer me gozhda kovaçi të mëdha. Gjurmët e këtyre brezave, sot të kalbur brenda murit, tregojnë se ata ripërsërteshin në çdo 2 m. lartësi të mureve rréthuese.

Muratura në përgjithësi, ngrihet mbi një thembër themeli, të dalë jashtë muraturës 10-20 cm. dhe të shkallëzuar në largësi të caktuar sipas pjerrësisë së terrenit.

Ky i fundit, që përfshihet brenda mureye të kështjellës. ishte në atë kohë më i pjerrët, sesa duket sot, në drejtimin jugor dhe nxjerrja jashtë mureve e ujérave sipërfaqësore bëhej me anën e një rrjeti të dendur kanalesh. Grykëderdhjet e këtyre kanaleve janë të dukshme, nga ana e jashtme, në gjithë gjatësinë e murit të rrethimit të anës jugore. Lujjet e këtyre kanaleve dalin në largësi të ndryshme. Dissa të tilla janë ndërtuar në kuotë më lart në krahasim me fillestaret dhe ky fakt tregon sigurisht për horizonte banimi më të vonshme.

Brenda këtij sistemi fortifikimi janë gjetur fragmente të shumta qeramike, grykë e vjega të një tipi amfore, me përmasa më të vogla nga ato që janë përmendur më përpara. Ky tip është karakteristik për nga modelimi i formës, i grykës së vogël dhe i vjegave të shkurtra, që ngrihen mbi buzët e amforave.

Fragmentet e gjetura janë me përmasa të ndryshme, gjë që tregon se edhe vetë amforat kanë qenë me madhësi të ndryshme, por të njëllojta për nga forma e tyre. Nga fragmentet e dorezave të këtyre amforave, të cilat janë të ngjitura mbi buzët e tyre, duket se ato kanë pasur formë sférique dhe qafë shumë të shkurtër. Grykët janë me diametër të jashtëm 5-8 cm dhe me diametër të brendshëm 3-3,5 cm. Kanë buzë të profiluara me damarë të ngritur në formë rrathësh koncentrikë. Qafa e tyre është e shkurtër 3-4 cm, prandaj vjegat ngrihen deri 5 cm mbi grykë. Vjegat e gjera 4 cm e të trasha 2,5 cm janë të profiluara në pjesën e sipërme të tyre.

Këto të dhëna tregonjë për prodhimin në vend të një tipi amfore me përmasa më të vogla, që përdoren më tepër si shtambë uji, siç tregonjë fragmentet e tyre, të gjetura në një shtresë të veçantë, të depozituara mbi ato më të herëshmet, dhe që lidhet me sistemin e fortifikimit, i rindërtuar në fund të shekullit VIII.

Furnizimi i kështjellës me ujë të pijshëm bëhej nga burimet e afërtë përreth saj, por në kohë të vështira përdorci edhe uji i shiut, që depozitohej në cisterna të ndërtuara posaçërisht brenda saj. Një cisternë e tillë, mjaft e madhe, ka qenë ndërtuar brenda kullës perëndimore dhe dy të tjera, më të vogla, gjenden njëra afér tjetrës në pjesën më të ngjitur të kështjellës. Këto të fundit janë gjithnjë plot me ujë edhe në ditët tona.

3. Kalaja e qytetit të poshtëm në shekullin VIII

Rindërtimet që janë bërë për mbrojtjen e qytetit të poshtëm në fund të shekullit VIII, sot për sot janë më pak të ruajtura. Megjithëkëtë gjurmët e mureve rrëthuese, të zbuluar kohët e fundit, tregojnë përpjekjen e qytetarëve të Lisit për rritjen e aftësisë mbrojtëse të qytetit, duke ndërtuar muret rrëthuese dhe kullat mbrojtëse të qytetit të poshtëm. Këto gjurmë kanë dalë kohët e fundit dhe dëshmojnë për vodosjen e hyrjes kryesore të kalasë ndërmjet dy kullave mbrojtëse. Porta e kalasë është e vodosur në murin rrëthues të anës jugore, pikërisht mbi rrënojat e portës së kalasë së periudhës bizantine. Kjo portë, meqenëse është rindërtuar edhe në kohë të mëvonshme (periudha në fjalë), nuk ruhet veçse në mbeturinat e dy kullave që ishin në mbrojtje të saj, të ndërtuara në të dyja anët e hyrjes së portës. Kullat janë në formë katrorë dhe me përmasa 6.5×6.5 m, më të vogla se kullat e mëparshme. Ato janë ngritur që nga themeli mbi rrënojat e kullave të fortifikimit ilir, fig. 24.

Në të dyja skajet e kullave ruhen edhe pjesë nga muret rrëthuese, që tregojnë për një lidhje konstruktive dhe për ndërtim të njëkohshëm. Këto gjurmë ruhen në pjesën e themelit të muraturës. Me shumë interes është të vihet në dukje se kulla që gjendet në anën e djathtë të hyrjes së portës, në themelin e murit lindor të saj lidhet me murin rrëthues, i cili, duke bërë një kthesë pak të harkuar, tregon se i ngjitet përpjetë shpatit të kodrës. Pjesa e zbuluar e këtij muri, deri tanë është vetëm 3-4 m. Disa mbeturina murash që duken në sipërfaqe, në pjerrësinë e kodrës, shtyjnë për të menduar se edhe ato duhet të lidhen me këtë mur. Ky mur, më tutje, mund të bashkohet me murin bizantin që rrëthonë në kohën e tij pjesën e qytetit kodrinor të Lisit, për të cilin është folur më parë. Kjo lidhje akoma nuk është vërtetuar mirë, por mendohet se muri rrëthues i anës jugore të kalasë, në sistemin mbrojtës të rindërtuar në fund të shekullit VIII, duke ndjekur gjurmët e mureve ilire, i ngjitet kodrës përpjetë, duke e zgjatur në këtë mënyrë perimetrin e mureve rrëthuese të kësaj kohe në një gjatësi rrëth 1200 m. Po të merret parasysh se muret rrëthuese të kalasë së qytetit të kohës bizantine arrinin një gjatësi prej rrëth 750 m.

del qartë se sistemi i fortifikimit mbrojtës, në fund të shekullit VIII, megjithëse nga ana ndërtimore paraqitet më i thjeshtë, përfshinte një sipërfaqe banimi gati tri herë më të madhe nga ajo e kohës bizantine. Në këtë mënyrë duket se është arritur edhe zëvendësimi i terrenit kodrinor dikur të banuar, por që në këtë periudhë është lënë jashtë mureve rrëthuese. Banorët e zonës kodrinore të dikurshme duket se janë vendosur më afér qytetit të poshtëm dhe përfshihen në një sistem mbrojtës të përbashkët me të. Kjo gjë vërtetohet nga ana tjetër edhe nga prania e varrezës, që në këtë periudhë shtrihej në pjerrësi më të mëdha të zonës kodrinore.

Këto mendime gjejnë mbështetje dhe bëhen më të argumentuara, po të merret parasysh se muri lindor i kalasë së rindërtuar në shekullin VI, pér aq sa është zbuluar, nuk ruan asnjë gjurmë të ndërtimit të shekullit VIII, d.m.th. ky mur e ka humbur funksionin e tij mbrojtës dhe tani gjetet thuaqse në mes të qytetit dhe brenda mureve rrethuese të kalasë së rindërtuar në shekullin VIII.

Bazuar në të dhënët e mësipërme, mund të arrihet në përfundim se qyteti i Lisis, mbas shkatërrimeve të shkakta-ara nga dyndjet sllave, fillimisht u grumbulluan në qytetin e poshtëm dhe në kohë më të vona ai u zhvillua në anën lindore, në pjerrësinë e rrezes së kodrës, duke arritur një sipërfaqe banimi mjaft të gjerë. Sikurse tregojnë gjurmët e mureve të përmendura, sistemi i fortifikimit të Lisis u ri-ndërtua pikërisht në përmasat e këtij zhvillimi në dy fazat e njëpasnjëshme.

Në këtë periudhë qyteti i Lisit paraqitet për herë të parë në dy zona banimi, respektivisht të fortifikuara: qytet-kala dhe kështjellë. Ky lloj sistemi fortifikimi është konstatuar edhe në qytete të tjera dhe përbën një kërkesë të re, që karakterizon fizionominë fillestare të qytetit mesjetar, në prag të ndryshimeve që lindën, për shkak të shthurjes së bashkësisë fshatave dhe krijimit të marrëdhënieve feudale.

Simbioza, e përbërë nga bërthama e qytetit të fortifikuar në formën e përgjithshme të një kalaje dhe të kështjellës, një fortifikim tjetër më i vogël, i ndërtuar në vendin më dominues, ishte zgjidhja më e mirë në rrethanat e krijuara dhe më e përshtatshme për dallimin klasor të popullsisë qytetare të kësaj periudhe.

Rigjallërimi i ekonomisë së qytetit të Lisit dhe i marrëdhënieve tregtare të tij, gjatë shekujve IX-X, vërtetohet edhe nga rifillimi i qarkullimit monetar në këtë qytet, i ndërprerë,

siç u tha që në shekullin VII. Monedha e parë, që përfaqëson këtë rifillim, është një monedhë argjendi e gjetur në qytet, e cila mban emrin e perandorit bizantin Leonit VI, vënë në qarkullim gjatë viteve 886-912. Vitet e fundit është gjetur edhe një thesar i vogël prej 12 copë monedhash prej ari. Këto monedha, që sot ruhen në fondin monetar të Muzeut Historik të Lezhës, janë gjetur rastësisht në shpatin e malit të Rencit, 250 m në perëndim të fshatit Balldren, rrëth 5-6 km në veri të qytetit të Lezhës. Ky thesar i vogël në numër, por me një rëndësi të veçantë historike, vërteton vazhdimësinë e qarkullimit monetar dhe të ngritjes së ekonomisë së qytetit edhe gjatë shekullit X. Monedhat e gjeturat në Balldren janë dy tipash, me nga 6 monedha secili tip. Tipi i parë mban në faqe portretet e dy perandorëve bizantinë: Kostandinit X dhe Romanit II, bashkësundues gjatë viteve 948-959.

Në vazhdim të shfletimit të burimeve historike, qyteti i Lisisit del me emrin «Eilison», i përmendur nga G. Kedren në shekullin XI. Ky autor, në përshkrimin e një udhëtimi që bën perandori Vasili II (976-1025), i cili gjatë luftës kundër bullgarëve u vendos përkohësisht në Ohër (në fillim të shekullit XI), thotë: «Ohri qe një qytet i vendosur mbi një kodër të lartë, tepër afér një ligeni shumë të madh (ligeni i Pogradecit), nga buron lumi Drin që shkon drejt veriut, pastaj kthehet nga perëndimi dhe derdhet në Jon afér Kështjellës së Eilisonit». . . Ky burim historik vërteton përrasinë e Kështjellës së Lisisit edhe në fillim të shekullit XI.¹

Për vazhdimësinë e jetës qytetare dhe përrasinë e Lisisit gjatë shekullit XII ka njoftime të rëndësishëm nga Ana Komnena, historiane bizantine. Kjo autore, në veprën e saj «Aleksiada», e përmend qytetin e Lisisit një herë me emrin Eliso^s dhe disa herë të tjera Elisoi. Në përshkrimin topografik që i bën qytetit të Durrësit, ajo thotë: «Epidamni është qytet i vjetër dhe ndodhet më poshtë se qyteti Elisos... U quajt kjo qytezë Elisoi ose nga ndonjë lumë që quhet Elisoi dhe që bashkohet me lumin më të madh Drinon, ose thjesht kështu nuk jam në gjendje që ta them qartë». Në vazhdim, A. Komnena shkruan se «Elisoi është një qytezë që duket sikur ndodhet në ajër dhë me çdo mjet qoftë, është i papushtueshëm. Duke vështruar poshtë, nëpër fushat Du-

1 Gj. Kedreni, J. Skiciles, Vep. cit. fq. 35.

rrësin dhe, siç thonë, është aq i sigurt, saqë si nga deti ashtu edhe nga toka i jep një ndihmë të madhe Durrësit. Këtë qytetit të Epidamnit dhe nëpërmjet lumenit Drinon, i cili qe i lundrueshëm dhe e siguroi qytetin e Epidamnit, duke i çuar nga toka dhe nga deti çdo gjë të nevojshme si për ushqimin e ushtarëve dhe të banorëve të tij ashtu edhe armë që u nevojiteshin për betejat... Ky lumë (Drini), duke kaluar pranë viseve të fundit të dalmatëve dhe duke u ngjitur nga veriu, pastaj kthehet nga jugu arrin te bregu i Elisoit dhe derdhet në gjirin e Adriatikut. Këto u shkruan për pozicionin e Epidamnit dhe Elisoit dhe të sigurisë së të dy vendeve». ¹

Njoftimet nga Ana Komnena janë shumë të rëndësishme për historinë e qytetit të Lisit edhe përvetë arsyen se ato janë të vetmet njoftime historike për gjithë shekullin XII. Duhet vënë, në dukje se nëpërmjet këtyre njoftimeve mund të krijuhet një përfytyrim më i qartë mbi atë që përfaqësonte ky qytet në periudhën e rëndësishme të rilindjes së qyteteve iliro-arbërore. Nga ana tjetër, shihet se Lisi paraqet një rëndësi të veçantë për mbrojtjen e qytetit të Durrësit, sidomos në kohën e rrëthimit të tij nga ushtria normane nën udhëheqjen e Boemundit, më 1107.

Nuk duhen lënë pa u nënvizuar të dhënrat, që e paraqesin qytetin e Lisit si një qendër shumë të fuqishme edhe nga ana ekonomike, e cila, gati për një vit, furnizoi qytetin e Durrësit me ushqime dhe me armët e nevojshme, aq të domosdoshme për të përballuar rrëthimin e tij.

Sistemi i fortifikimit të Lisit dhe pozicioni fiziko-gjeografik i pëershkuar nga Ana Komnena, e paraqesin atë si të papushtueshëm prej çfarëdo mjeti që do të përdorej kundërtij.

Në përfundim të kësaj periudhe, qyteti i Lisit, në sajë të përpjekjeve të mëdha e të vazhdueshme, arriti edhe një herë një rimëkëmbje të dukshme ekonomike e kulturore dhe u vu në radhën e qyteteve më të rëndësishme të Arbërisë.

1 A, Komnena. *Aleksiada*, vell. 2, lib. XII, f. 8, 9.

KAPITULLI VI

LESHI (ALESIO) GJATE SHEKULLIN XIII-XV

Në fillim të shekullit XIII dhe menjëherë pas shembjes së Perandorisë Bizantine, në krahinat perëndimore të saj, lindën një sërë shtetesh feudale ndërmjet tyre edhe principata e Arbërisë.

Shtrirja territoriale e kësaj principate është afërsisht e përcaktuar nga burimet historike në lindje të Durrësit (dukatit të Durrësit të krijuar nga Republika Veneciane). Principata e Arbërisë kishte në kufirin jugor Despotatin e Epirit, në anën lindore Mbretërinë Bullgare dhe në veri atë Serbe.

Në këtë përkufizim territorial përfshihej edhe qyteti i Leshit, i cili, si një qytet bregdetar i fortifikuar, që ishte në atë kohë, mund të mendohet se ka ndihmuar shumë sa në krijimin e principatës së Arbërisë aq edhe në konsolidimin e kufijve veriorë të saj¹.

Në fillim të krijimtarisë së Principatës së Arbërisë, Leshi ishte akoma një qendër rrugore me rëndësi dhe nga ana tjetër, ai ishte i vetmi liman, nga ku kjo principatë komunikonte me rrugët detare të Adriatikut. Rëndësia e veçantë e këtij qyteti del shumë qartë po të merret parasysh aktmarrëveshja e lidhur nga Dhimitri, «kryezot i Arbërisë», me Republikën e Raguzës, rrëth viteve 1208-1215.² Në këtë dokument historik bëhet fjalë për shkëmbime tregtare e për transportim

1 Historia e Shqipërisë, vëll. I, Tiranë, 1959, f. 195.

2 Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, VII, Tiranë, 1962, f. 83.

mallrash pa taksa si në rrugët tokësore ashtu edhe në ato detare. Vetëkuptohet se qyteti i Lisit kishte një rëndësi të veçantë për zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet Arbërisë dhe Republikës së Raguzës, dhe njëkohësisht ishte qyteti më i fortifikuar në mbrojtje të Arbërisë kundër sulmeve të Mbretërisë Serbe. Në një dokument të vitit 1388 përmendet lumi i Leshit, nëpërmjet të cilit transportohej lëndë druri, që pritej dhe që përpunohej në vend, në trarë të skuadruar. Kjo lëndë transportohej me barka për në limanin e Raguzës.¹

Në dy dokumente të tjera të vitit 1395 rezulton se Leshi i është dorëzuar Republikës së Venedikut, nga Progon Dukagjini, në vitin 1393.²

Në këtë kohë qyteti nuk është veçse një kështjellë, e përmendur fillimisht «Castrum Iesii», Kështjella e Leshit. Në dokumente më të vona gjendet me emrin Alessio dhe në ndonjë rast Alexio.³

Lidhur me ndryshimin e emrit të qytetit në këtë periudhë janë shprehur disa mendime, të cilat nuk duken se janë shumë bindësse. Për këtë çështje duhet sjellur një variant i ri, i cili ndoshta është më afër së vërtetës.

Qyteti i Leshit, deri në fund të shekullit XII, siç doli, ka të njëtin emër që kishte në kohën ilire, por të paraqitur në burimet greko-latine me ndonjë prapashtësë ose para-shtësë, sipas rregullave gramatikore të gjuhëve që është shkruar.

Paraqitja e Lisit, në fund të shekullit XIV. me emrin «Castrum Lessi», është një fakt që tregon jo vetëm për ndërrimin e emrit të qytetit, por njëkohësisht edhe për ndryshimin që është bërë në përbërjen qytetare të tij. Kalaja e Lisit e kohëve më të para është tkurrur dhe paraqitet si një kështjellë. Nga ana tjetër, është për t'u vënë në dukje se Kështjella e Elisionit, që ishte në majë të kodrës, tanimë është kthyer në një përmadhë muresh të rrëzuara (fig. 25).

Emri i kështjellës, i shkruar në gjuhën latine: Lesii, përmendimin tonë nuk lidhet me emrin e mëparmë, por ai i përgjigjet emrit Llesh, që është një shkurtim në gjuhën dialektore të krahanës i emrit Aleksandër dhe nga ana tjetër, është i barabartë me emrat Aleks-Aleksio, të cilët njihen si

1 Acta et Diplomata, II, 415.

2 Acta et Diplomata, II, 535.

3 Acta et Diplomata, II, 517, 607.

shkurttime të emrit Aleksandër, respektivisht të përdorur nga grekët dhe nga latinët...

Shtrohet pyetja se ç'lidhje ka ky emër me qytetin apo me kështjellën. Mendohet se ka shumë mundësi që emri Llesh=Aleks, Lekë=Aleksandër, lidhet drejtpërsëdrejti, sikurse edhe emrat e zotërimeve feudale: Lekni, Dukagjin, Kastriot etj., që përfaqësojnë gjithashtu figura familjesh.

U tha se në kohën e dorëzimit te venecianët, Kështjella e Leshit ishte nën zotërimin e feudalit Progon Dukagjini, i cili, siç dihet, ishte i biri i Lek Dukagjinit. Historikisht del se familja e Dukagjinave (Dukë Gjin Tanushi), më 1281, sundonte Leshin dhe bregun e majtë të Drinit. Dihet gjithashtu se një nga dy degët e kësaj familjeje kishte Leshin si kryeqendër dhe sundonte Zadrimën, Pukën, Selitën dhe Fanin në Mirditë. Në interpretimin e këtyre të dhënave, mund të mendohet që dega e familjes së Dukagjinave, që kishte kryeqendër Leshin, të ishte dega e Lek Dukagjinit dhe prej këtij është quajtur kështjellë e Leshit, d.m.th. e Lekë=Aleksandrit, për ta dalluar nga kështjellat e degës tjetër. Sipas Rrok Zojzit, me emrin Lekni është quajtur deri vonë krahina Lezhë-Mirditë.

Lidhur me çështjen e këtij emri, del një pyetje tjetër, që kërkon gjithashtu një përgjigje të argumentuar. Cila është arsyja që në dokumentet veneciane fillimisht përmendet «Castrum Lesii» dhe më vonë atë e quajnë Alessio? Arsyetimi i drejtë për një ndryshim të menjëherëshëm të emrit të kësaj kështjelle mendohet se është fakti që venecianët fillimisht përdorin emrin shqiptar Llesh dhe e shkruajnë atë Lesii, por më vonë kur ata mësojnë se emri Llesh është i barabartë me emrin Aleks, atëherë edhe ata përdorin vazhdimisht emrin Alessio.

Paraqitja e Leshit në fund të shekullit XIV, si një kështjellë e fortifikuar jo shumë mirë, lë shteg për të menduar se qyteti i dikurshëm ka pësuar një rënje të ndjeshme. Kjo rënje vërtetohet edhe nga fakti që ky qytet nuk paraqitet gjatë shekullit XIV në radhën e qyteteve shqiptare të zhvilluara, si: Durrësi, Shkodra apo Drishti, kufitare me të. Arsyet e vërteta të rënies ekonomike-shoqërore të Leshit, për mungesë të dhënash, mbeten gjithmonë të panjohura, pra edhe të pashpjegueshme.

Kështjella e Leshit i dorëzohet Venedikut nga feudalët Dukagjinave, me qëllim që t'i shpëtonin rrezikut të ushtrisë turke, e cila me një sulm të befasishëm pushtoi Shkodrën.

dhe Ulqinin, në vitin 1393. Nga ana tjetër, ata shpresonin se, sipas marrëveshjes që kishin bërë me venecianët, do të përfitonin 1/3 e të ardhurave të kështjellës.

Izolimi i kështjellës së Leshit nga toka shqiptare dhe vënia nën zotërimin e Republikës Veneciane e keqësori gjendjen edhe më tepër dhe e ktheu qytetin në një qendër të vogël, që shërbente për tregtimin e kripës dhe në një skelë ku përgatitej e transportohej lëndë druri për ndërtimin e anijeve veneciane.

Për të kriuar një përfytyrim sa më të plotë mbi atë që është quajtur në kohën veneciane Kështjella e Leshit, mjaf-ton një dokument i vitit 1398, rrëth pesë vjet më pas pushtimit të kështjellës nga venecianët. Leshi është shumë i dobët dhe mbi breg të lumit gjendet një mal nga perëndimi (drejtimi në këtë rast është gabim, sepse duhet të thuhet nga lindja), mbi të cilin qëmoti ka qenë ose një qytet ose një fortesë dhe tanë janë disa mure të larta, mbi të cilat thonë se mund të ndërtohet lehtësisht një fortesë për një fuqizim më të madh dhe për siguri të vendit. Më poshtë këtij dokumenti, urdhërohet që të verifikohet gjendja në vend dhe të nxirren shpenzimet e punimeve, të cilat duhen kryer për të rindërtuar fortifikimin në majë të malit dhe pastaj do të shikohej nga Senati Venecian nëse ishte e arsyeshme të bë-heshin punimet në fjalë.¹

Punimet e parashkruara për rindërtimin e kështjellës së sipërme, majë malit, siç e quajnë venecianët, duket se nuk janë bërë, përderisa nuk ka edhe asnjë të dhënë konkrete, tjetër, veç dokumentit të përmendur. Nga ana tjetër, nuk duken gjurmë ndërtimesh të kësaj periudhe në kështjellën mesjetare të Leshit. Në dokumente më të vonshme bëhet fjalë vetëm për meremetimin e kështjellës së poshtme. Këto punime janë kryer edhe me ndihmën e popullsisë vendase. Njoftohet gjithashtu se masa të tillë janë marrë edhe në kala të tjera: Durrës, Rodon, Shkodër etj., që ishin gjithashtu nën sundimin venecian.

Nga të dhënët e përmendura më sipër, bëhet fare e qartë gjëndja e qytetit të Lisit gjatë pushtimit venecian, i cili figuron i përbledhur, në pjesën e poshtme, në përmesat e një kështjelle disi të fortifikuar, që shërbente vetëm për të mbrojtur interesat veneciane dhe për të ndaluar daljen e ushtrisë turke në bregdetin e Adriatikut

¹ Acta et Diplomata, II, 607.

Kështjella e sipërme në këtë kohë është e braktisur dhe e rrënuar.

Duke iu referuar gjurmëve të mureve rrethuese, që ruhen në anën verilindore, bri rrugës së vjetër Lezhë-Shkodër, Kështjella e Leshit, në shekullin XV, kishte afërsisht përmasat dhe planimetrinë e Kalasë së Lisit, rindërtuar në shekullin VI.

Po të merret parasysh gjendja e rrënuar e kështjellës së sipërme, mosbanimi në zonën kodrinore si edhe zgjedhimi i sipërfaqes së banuar të kalasë në shekullin IX, atëherë rezulton se Kështjella e Leshit përfaqëson t'kurrjen më të madhe që ka arritur qyteti i Lisit gjatë gjithë jetës së tij disa mijëvjeçare.

Si një ngjarje që luajti një rol të rëndësishëm në historinë e vendit dhe që lidhet me qytetin e Leshit të shekullit XV, është për t'u përmendur në mënyrë të veçantë edhe Kuvendi i Lezhës, që u bë në këtë qytet, më 1444, nën kryesinë e Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit.

Sic dihet, Kuvendi i Leshit u mbloq në katedralen e shën-Kollit, e cila, në bazë të kërkimeve arkeologjike dhe të studimeve që janë bërë, është identifikuar me ish-xhaminë e pazarit të qytetit¹.

Sikurse shkruan M. Barleti në «Historinë e Skënderbeut», Kuvendi i Leshit u bë në qytetin Lisus, të cilin me një emër të zakonshëm e quajnë Alessium.

Pas kësaj ngjarjeje të shënuar, i gjithë populli shqiptar u bashkua me Gjergj Kastriotin në krye, në luftë kundër pushtimit turk.²

Kështjella e Leshit qëndroi nën zotërimin venecian për një kohë relativisht të gjatë, rreth 75 vjet dhe më 1478 u pushtua nga ushtria turke.³

Në të vërtetë, kështjella dhe gjithçka që ishte brenda saj u dogjën nga qytetarët, para se të arrinte ushtria turke për ta pushtuar atë. Pas shkatërrimit të kështjellës i gjithë populli e braktisi qytetin dhe u largua me barka nëpër lumë, në drejtim të detit të hapur.

Në dokumentet historike turko-veneciane të shekullit XV

1 F. Prendi, «Vendvarrimi i Skënderbeut», *Konferenca e Dytë e Studeve Albanologjike*, Tiranë, 1968, vëll. 1, f. 241-247.

2 M. Barleti, «Historia e Skënderbeut», *Burime të zgjedhura*, Vep. cit., f. 286.

3 Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, vëll. 2, f. 358.

pushtimi apo dorëzimi i qytetit paraqitet në mënyra të ndryshme dhe kontradiktore si dhe nga pozitat e dy fuqive ndërluftuese në një vend të huaj për to.

Viti 1478 është viti i fundit i vetë ekzistencës së Lisis, i cili jetoi shekuj me radhë. Pas luftërave të shumta e shkatërrimeve të mëdha ai rilindte përsëri mbi gërmadhat dhe rifillonte të ngrihej përsëri në këmbë.

Por këtë radhë ndodhi diçka që nuk kishte ngjarë asnjëherë në të kaluarën. Qyteti dhe gjithçka që ishte brenda tij u dogj e u shkatërrua nga vetë ata që e kishin ndërtuar nga banorët e tij. Prandaj edhe shkatërrimi këtë herë ishte rrënjesor, në mënyrë që asgjë të mos i shërbente armikut. Dhe në të vërtetë kështu ndodhi. Lisi mbeti i shkretë dhe për shumë vjet i pabanuar, por banorët e tij shpëtuan nga robëria dhe për një kohë, jetuan të lirë në tokën amtare, në një zonë jo shumë larg qytetit të tyre.

Burimet osmane nuk tregojnë të vërtetën kur thonë se banorët e Leshit, që u orvatën të largoheshin nga qyteti, u asgjësuan nga ushtarët turq. Në të vërtetë, popullsia e shpërndarur u vendos në ishullin që ndodhej në grykëderdhjen e lumit të Drinit dhe jetoi aty për shumë vjet, pa u diktuar nga turqit

Në këto dokumente banorët e ishullit përmenden si qytetarë të Alesit, të Lleshit, të Lezhës, të vendosur në ishullin e Lezhës dhe në ndonjë rast lihet të kuptohet qyteti i Lezhës i shpërndarur në ishull. Ishulli i Lezhës përmendet për herë të parë në dokumentet veneciane, të njoitura në histori «Ditaret» e M. Sanutos. Ky autor i ngarkuar me funksionin e historianit zyrtar të Venedikut, në shënimet kronikale të kohës përmend një letër shkruar nga frat Bernardini nga Shkodra, në të cilën thuhet se në ato anë pritej që të vinte Skënderbeu i Ri së bashku me Stefan Dukagjinin, i cili pasi të merrte ishullin e Lezhës, do të sulmonte Shkodrën e Krujën.¹

Një ide më e qartë se ç'ishte ishulli i Lezhës dhe ku ndodhej ai në atë kohë, jepet në pjesët e ditarit, që mban datën 19 mars 1501.²

Në një përbledhje letrash është një përshkrim i hollësishëm i këtij ishulli si edhe i popullsisë që banon në atë vend.

¹ Dokumente për Historinë e Shqipërisë (1479-1506), Pjesa II (1499-1506), Tiranë, f. 160.

² Po aty, f. 285.

Në këtë dokument, ndër të tjera, thuhet se: «Vendi i Lezhës është një ishull që gjendet në mesin e lumenit të Drinit dhe del në formë trekëndëshi; ka një rrreth 9 milesh me nga 3 mile për çdo krah dhe aty u tërhoqën njerëzit, pasi Shkodra iu dha sultanit, duke lënë Lezhën e vjetër dhe banojnë në këtë vend. Janë rrreth 200 shtëpi prej dérrase dhe vendi është i populuar mirë. Dhe këto shtëpi janë gjatë krahëve të trekëndëshit, në anën e lumit. Nuk ka as fortesë as ndonjë mbrojtje tjeter, veç ndopak penda me hunj».

Nga përbajtja e këtij dokumenti duket qartë se refugjatët e ikur fill mbas djegies së qytetit, janë vendosur në ishullin që ndodhej në deltën e lumit Drin, për t'i shpëtuar robërisë turke.

Në ditarë me data të mëvonshme del gjithashu se ishulli i Lezhës u bë qendra më e rëndësishme, ku jetonte e gjallë lëvizja e rezistencës së organizuar kundër pushtimit turk dhe nëpërmjet këtij ishulli mbaheshin lidhje të ngushta me kryengritësit e krahinave të pushtuara dhe Skënderbeut të Ri, i cili erdhi në këtë ishull, më 5 mars 1501, për të organizuar veprimet ushtarake dhe për të çliruar Shqipërinë e shtypur nga turqit.

Për t'u përmendur është edhe vetë fakti që funksionarët venecianë, që shqëronin Skënderbeun e Ri, duke përfituar nga rrethanat e gjetura në ishull, shpejtuan të ngrenë menjëherë flamurin venecian (më 7 mars 1501)¹, duke e vënë në këtë mënyrë ishullin e Lezhës nën zotërimin e tyre. Ky akt i dokumentuar tregon se ishulli i Lezhës ishte i vetti vend, që qëndronte i lirë në Shqipërinë e Veriut, të pustuar nga turqit.

Në dritën e këtyre të dhënavë vërtetohet se zbritja e Skënderbeut të Ri, ngritja e flamurit venecian dhe vendosja e përfaqësuesit venecian në ishullin e Lezhës dhe jo në qytetin e Lezhës. Sikurse është menduar deri më sot, tregojnë se ky qytet ishte të paktën deri më 1501 i braktisur.

Shqyrtimi i dokumenteve të tjera nxjerr në plan të parë Republikën Veneciane, e cila nën pretekstin se gjoja ndihmonte Skënderbeun e Ri që të vihej në krye të kryengritësve shqiptarë. Zbarkoi me ushtri në ishull dhe vuri atë nën mbrojtjen veneciane. Venecianët në të vërtetë, kishin

¹ Po aty, f. 278.

për qëllim të përdornin lëvizjen e organizuar shqiptare të kryengritësve shqiptarë kundër turqve, duke shpresuar se në këtë mënyrë do të ulej presioni ushtarak turk dhe do të mënjanohet rreziku që i kërcenohej Durrësit, të cilin e kishin akoma nën zotërimin e tyre.

Por zhvillimi i ngjarjeve historike të mëvonshme mori një rrugë tjetër. Durrësi u pushtua nga turqit pas 6 muajve, më 17 gusht 1501. Gjendja e krijuar në ishullin e Lezhës, pas pushtimit të Durrësit, pasqyrohet mjaft mirë edhe nga një letrë dërguar Këshillit Venecian, më 31 tetor 1501 nga A. Boni. Ky proveditor venecian në Shqipëri, ndër të tjera, thotë se e ndjen veten të pazotë dhe është në frikë të madhe se mos stratiotët shqiptarë do të ngrihen edhe kundër venecianëve, meqenëse akoma nuk janë plotësuar premtimet e dhëna, qoftë për ndihmat e premtuara popullit, qoftë edhe për mosmarrjen e masave për fortifikimin e ishullit të Lezhës. Në vazhdim të kësaj letre, autori kérkor me këmbëngulje fortifikimin e ishullit, ose në rast të kundërt propozon që më mirë të hijen artilleritë dhe municionet para se ato të bien në duart e turqve.

Në këtë kohë edhe marrëdhëni e proveditorit venecian të ishullit të Lezhës me Shkënderbeun e Ri janë keqësuar aq shumë, sa ai është detyruar, siç thotë, të vërë në dijeni dhe të ankohet pranë Këshillit të 10-ve, se Skënderbeu i Ri nuk u ka qëndruar premtimeve të dhëna dhe se ai, sipas tij, kérkon të lidhet me njerëz të dyshiratë e nëpërmjet tyre, me Ali Beun e Krushës.

Gjatë zhvillimit të këtyre ngjarjeve, ishulli i Lezhës doli në rendin e ditës edhe për qeverinë turke, e cila, duke e ndier veten të zënë në befasi, me pushtimin e ishullit të Lezhës nga venecianët, me këmbëngulje kérkoi që ishulli t'u dorëzohej atyre menjëherë, sepse sipas marrëveshjes së paqes turko-veneciane, ai u përkiste atyre.

Venecianët, pasi e panë qartë se dështuan në synimet e tyre ushtarako-politike, filluan të vlerësojnë anën ekonomike të ishullit të Lezhës, kundërshtuan dorëzimin e tij të turqit dhe menduan ta kthejnë atë në një skelë tregtare. Ku mund të depozitonin kripën dhe të furnizoheshin me lëndë druri për ndërtimin e anijeve të flotës së tyre.

Në këto rrethana, turqit, duke parë se bisedimet për dorëzimin e ishullit zvarriteshin me letra e me protesta të njëpasnjëshme. Menduan se problemi mund të zgjidhej vetëm me anën e luftës. Për këtë qëllim, në janar të vitit 1504, bënë

të gjitha përgatitjet pér një sulm të befasishëm mbi ishull. Duke shfrytëzuar kushtet e vështira dimërore, në një kohë kur lumi i Drinit, që rrëthonte ishullin, kishte ngrirë, ata bënë përpjekje pér të kaluar mbi akull me kuaj dhe të pushtonin me forcë ishullin. Pér këtë qëllim, sanxhakbeu i Shkodrës, Feris Beu, kishte mbledhur 500 burra dhe u kishte dhënë urdhër 500 të tjerëve që të sillnin nga një krah kashtë pér ta shtruar mbi akull, që të mos rrëshqitnin kuajt e ushtrisë, e cila do të sulmonte ishullin. Banorët e ishullit të Lezhës, të informuar pér përgatitjet e turqve, dolën me vërcakë e shata dhe e thyen akullin në të dyja anët e lumit, që rrëthonte ishullin, kështu që turqit edhe këtë radhë nuk arritën ta pushtonin këtë vend.

Në një dokument tjeter lexohet se mbas dimrit të madh të vitit 1504, në fillim të muajit mars, ishulli i Lezhës u përmbyt. Uji mbuloi gjithë vendin, në banesat më të larta arri- ti gjysmë hapi, u rrëzuan shtëpi, u mbytën njerëz, u shkaktuan dëme të mëdha në depot e grurit dhe të mallrave të tjetra dhe njerëzit u larguan me trapë dhe barka të vogla. Venecianëve iu dëmtuan depot e kripës, municionet dhe artilleria.¹

Me gjithë dëmet e mëdha të shkaktuara nga kjo përmbytje, banorët e vendit, me sa duket, u ristabilizuan dhe nuk ka tö dhëna pér braktisjen e ishullit pas dëmeve të pësuara nga kjo përmbytje.

Sikurse mësohet nga proveditori N. Marcelo, pas këtyre ngjarjeve ishulli u përforcuat me artileri të dërguar nga duka i Kretës. Megjithëkëtë ky proveditor kërkoi edhe ndihma të tjetra, sepse siç shkruan ai, «vendi është i hapur nga çdo anë dhe mbrohet vetëm me 13 këmbësorë. Ishulli ka nevojë pér roje të tjetra, sepse është në zemër të Shqipërisë».

Nga këto të dhëna duket qartë se përforcimet ushtarake të ishullit janë fare të pamjaftueshme pér mbrojtjen e vendit dhe nga ana tjetër, interesat veneciane pér këtë vend vijnë gjithnjë duke u rrezikuar nga presioni ushtarak i Turqisë.

Në një dokument të vitit 1505 thuhet se Gjon Marini, qytetari kryesor i ishullit të Lezhës, u ngrit kundër proveditorit venecian, i cili, duke zbatuar urdhrat që kishte nga Venediku, kërkonte ta tërhiqte artilerinë nga ishulli dhe ta linte atë pa mbrojtje.²

1 Po aty, f. 382.

2 Po aty, f. 469.




Fig. 20.




Fig. 22.




Fig. 21.



Fig. 23.




Fig. 24.

LESHI-ÅLESIO ^{HE} SHEN. XIII-XV.




Fig. 25.

ISHULLILEZHES NE SHEK. XVI.




Fig. 26.




Fig. 27.

Si përfundim i ngjarjeve historike të zhvilluara në ishullin e Lezhës, në vitet e para të shekullit XVI, është edhe një dokument tjetër i viti 1506, ku për të fundit herë përmendet ishulli i Lezhës, Banorëve të Lezhës u treguan vendimin e Senatit, që ai vend t'i jepej sulttanit. Vendasit donin të mbroheshin, por venecianët e hoqën artilierinë dhe ata (banorët) e dogjën gjithë vendin. Një pjesë e tyre kërkuan dhe u bartën në Ulqin, të tjerë shkuan në Pulje. Kështu që ai vend qe djegur dhe shpopulluar dhe po pritej i dërguari i sulttanit.

Sikurse vihet re nga studimi i hollësishëm i ditarëve të ndryshëm të M. Sanutos, që nga viti 1500 e deri në vitin 1506, mund të nxirren një sërë të dhënash, të cilat për probleme të ndryshme paraqesin interes dhe janë bazë për caktimin topografik të ishullit të Lezhës dhe për rolin që ka luajtur popullsia e vendosur në të.

Në dritën e këtyre të dhënavë dhe të interpretimit të drejtë të këtyre burimeve, arrihet të vërtetohet një fakt historik i pavënë në dukje deri më sot. Ishulli i Lezhës ishte vendi i vetëm në bregdetin e Shqipërisë së Veriut, i cili për 23 vjet (1478-1501) qëndronte i lirë, i pavarur dhe i vet-administrueshëm.

Ishulli i Lezhës gjatë shekujve ka pësuar ndryshime të dukshme topografike. Gjurmë të këtyre ndryshimeve figurajnë edhe në paraqitjen e vendit në hartat topografike të ditëve tonë. Në këto harta të kohëve të ndryshme dallohen gjurmë të lëvizjeve të shtratit dhe të grykëderdhjes së Drinit. Në këtë drejtim janë ruajtur edhe toponime që tregonë për ndryshime të tillë siç janë toponimi «Liqenet e grykës së lumit», «Vija e lumit». Ata tregonë për derdhjen e lumit të Drinit disa kilometra më në jug nga derdhja e sotme. Qenia e një grykëderdhjeje tjetër në anën veriore vërtetohet nga fakti që në anën e kundërt të ishullit të Lezhës ndodhet fshati i quajtur Ishulli i Shëngjinit. Të dy këto fshatra në të kaluarën kanë qenë ishuj të formuar, njëri pas tjetrit, në grykëderdhjet e lumit të Drinit.

Në kohë më të vona duket se është mbushur degëzimi jugor i lumbit që formonte ishullin e Lezhës dhe po me këtë rast ndoshta është hapur një degëzim i ri, në anën e djathtë të rrjedhjes qendrore të Drinit, duke formuar në këtë mënyrë një ishull të ri në grykëderdhjen e tij, i cili më vonë është quajtur ishulli i Shëngjinit.

Nga vendosja topografike e të dy këtyre ishujve, për-

ballë njëri-tjetrit, mund të përcaktohet deridiku edhe vija bregdetare e Adriatikut, në fillim të shekullit XVI. Po të bëhet një krahasim ndërmjet grykëderdhjes së Drinit në fillim të shekullit XVI dhe asaj të ditëve tona, del qartë se gjatë këtyre 500 vjetëve të fundit është bërë një shtesë e madhe e sipërfaqes bregdetare, rrjedhimisht edhe shtrati i lumenit të Drinit është zgjatur rrreth 3 km gjatësi në vijë të drejtë¹. (fig. 26).

Mbathja apo mbushja e terrenit në të dyja anët e shtratit të Drinit, vetëkuptohet se është bërë gradualisht dhe në disa fazë, zakonisht në kohën e reshjeve të mëdha të stinës së dimrit.

Të dhënat e mësipërme vërtetojnë nga ana tjeter, se vija bregdetare në fillim të shekullit XVI, ishte rrreth 3 km larg nga qendra e qytetit të sotëm të Lezhës. Rrjedhimisht, mund të iuhet për analogji, se në kohë më të lashta deti ka qenë edhe më afér qytetit ilir të Losit. Edhe nga burimet e historisë së lashtë nënkuptohet se qyteti ilir i Losit, në mos ishte një qytet bregdetar, të paktën kishte një skelë detare jo shumë larg tij.

Këto të dhëna paraqesin gjithashu një interes të veçantë edhe për studimin në përgjithësi të bregdetit shqiptar, të prurjeve dhe të depozitimeve aluvionale në fushën bregdetare të vendit tonë, duke përfshirë këtu edhe studimin e lëvizjeve apo të zhvendosjes së shtretërve të lumenjve të tjerë të vendit tonë.

1 K. Zheku. Ishulli i Lezhës, Po aty, f. 137.

KAPITULLI VII

LESHI NË SHEKUJT XVI-XVIII

Pas rënies së ishullit të Leshit (1506) në duart e turqve, ky vend i shkatërruar dhe i braktisur nga popullsia, nuk paraqiste më asnjë interes për pushtuesit. Për më tepër, ata nuk kishin përsë të interesoheshin, përderisa ia arritën qëllimit që kishin: dëbimin e venecianëve nga bregdeti shqiptar dhe përfshirjen e këtij ishulli në territorin e pushtuar prej tyre.

Turqit, siç do të shihet më poshtë, u interesuan për Leshin vetëm rrëth 40 vjet pas djegies së qytetit dhe pikërisht në atë kohë kur pushteti i tyre ushtarak nuk e ndiente veten të sigurt, për shkak të shtimit gjithnjë e më shumë të rezistencës së armatosur të popullit shqiptar.

Nga ana tjetër, në gjendjen e krijuar qeveria turke nuk mundte më as me dhunë t'i vilte të ardhurat e detyrimeve nga popullsia vendase.

Në këto kushte kaq të vështira e të pasigurta për pushtuesit turq, dilte nevoja e domosdoshme e konsolidimit të pozitive të tyre në qytetet e pushtuara si dhe e sigurimit të qarkullimit të vazhdueshëm në rrugët kryesore të furnizimit të tyre.

Për t'ia arritur këtyre qëllimeve, qeveria turke mori një sërë masash lidhur me përforcimin e sistemit të mbrojtjes së qyteteve të pushtuara, rindërtimin e kalave të rrënuara si edhe ndërtimin e kështjellave të reja.

Të shumta janë gjurmët dhe burimet historike, që bëjnë

fjalë për ndërtime të karakterit mbrojtës, si në Durrës, Bashtorë, Ishëm, Shkodër etj.

Në këtë kuadër përfshihen edhe punimet e rindërtimit që janë bërë nga turqit në kështjellën e Leshit, të cilat vërtetohen nga një mbishkrim i gdhendur në një pllakë mermeri, që është gjetur në vend dhe që sot është eksposuar në Muzeun Historik të qytetit.

Sipas përbajtjes së tekstit të këtij mbishkrimi rezulton se kështjella është ndërtuar nga Sulejmani (bir i Selimit (bir) i Bajazit Konit... nën mbikëqyrjen e Muhamet Dervish Urguzit... në vitin 928 (1521-22) (foto 15).

Duket qartë se për turqit kështjella e rindërtuar në majë të kodrës përaqiste disa anë të favorshme, si nga ana e pozicionit gjeografik mbizotëruesh e të mbrojtur nga natyra, ashtu edhe nga ruajtja deri diku e mureve rrëthuese të kështjellës së mëparshme (foto 16; fig. 27).

Në këto rrëthana, punimet e rindërtimit të sistemit fortifikues të kësaj këshijelle sikurse duken qartë edhe në vend, kanë qenë të përqendruar në rindërtimin e pjesëve të rrëzuara të mureve rrëthuese dhe të kullave mbrojtëse. Në këtë kohë, kryesisht është rindërtuar deri në lartësinë e nevojshtme, shtrati i kalimit të rojave përgjatë bedenave dhe janë ndërtuar frëngjtitë e reja në format e në përmesat e përshtatshme, sipas armëve luftarake që ishin në përdorim.

Ruhën akoma edhe sot disa frëngji topash dhe të tjera më të vogla, karakteristike për gjaujtje me pushkë, të cilat kanë qenë rindërtuar në gjithë gjatësinë e mureve rrëthuese dhe në kullat mbrojtëse të kështjellës.

Për t'u përmendur janë edhe punimet që janë kryer në tri hyrjet e saj, të cilat janë trajtuar në një mënyrë të veçantë dhe tregojnë për fortifikimin e tyre në bazë të kërkuesave dhe të koncepteve të reja.

Në secilën hyrje, në përshtatje me pozicionin dhe me gjendjen e ruajtjes së tyre, janë bërë shtesa në oborret e parahyrjes së portave si edhe në pjesën e sipërme të tyre.

Në portën lindore, duke mos e konsideruar më të përshtatshme hyrjen e portës së kështjellës së vjetër, është ndërtuar një portë tjeter para saj, duke krijuar në këtë mënyrë një korridor të myllur në mes dy portave.

Para hyrjes së kësaj porte është ndërtuar një mur i lartë barrierë, i cili mbronte portat nga goditjet të drejtpërdrejta me artileri dhe njëkohësisht ndryshonte edhe drejti-

min e hyrjes së kësaj porte. Me ndërtimin e këtij muri është kriuar një oborr i mbrojtur para hyrjes, i cili shërbente më tepër pér kontrollimin e njerëzve që hynin në kështjellë.

Mbi harkun e portës së parë, rindërtuar që nga themeli, në këtë kohë, ishte murosur edhe mbishkrimi që përjetësonë ndërtimin dhe kohën e rindërtimit të kështjellës së Leshit.

Karakteristikë që e dallon nga portat e Kështjellës së Elisonit është pa dyshim edhe harku gjysmërrrethor, i përdorur në portat-shtesë, gjurmët të cilave duken te porta lindore dhe tek ajo perëndimore.

Si element dallues duhet konsideruar edhe vetë sistemi i ndërtimit të dy portave të njëpasnjëshme pér secilën hyrje të kalasë si edhe krijimi i një oborri të mbrojtur pérpara këtyre portave.

Vendosja e dy portave njëra pas tjetrës dhe krijimi në mes tyre i korridorit të mbyllur, përbën një zgjidhje me shumë interes pér vetë mbrojtjen e hyrjeve të kështjellave.

Në një zgjidhje të tillë krijuhen komplekse të reja fortifikuese mbi hyrjet dhe njëkohësisht gjejnë vend të përshtatshëm mjediset e nevojshme pér strehimin e truprojave të posaçme, që ishin në vëzhgim të pérherershëm të hyrje-daljeve të kështjellës (foto 17).

Në portën lindore, siç tregojnë gjurmët, janë rindërtuar edhe kullat mbrojtëse, që ishin në të dyja anët e hyrjes, duke e kthyer kështu këtë hyrje në një kompleks shumë të fortifikuar.

Punimet e kryera në portën perëndimore në këtë kohë, janë gjithashtu të karakterit përforcues; aty vërehen ndryshime që lidhen me rëndësinë dhe me funksionin që merr kjo portë si edhe me vetë pozicionin e saj. Oborri i krijuar para hyrjes ishte gjithashtu i mbrojtur, me anën e një murit-barrierë, i cili ishte i pajisur me frëngji luftimi në të gjithë gjatësinë e tij.

Në drejtim të aksit të portës, karshi hyrjes së saj, duken gjurmë të një kulle, ndërtuar nga ana e jashtme e murit-barrierë, e cila edhe në këtë rast shërbente si vend pér rojat e jashtme, që kontrollonin dhe mbronin hyrjen e kësaj porte të kalasë.

Për t'u vënë në dukje është fakti se në hyrjen perëndimore dhe në atë veriore portat-shtesë (portat e dyta) janë ndërtuar nga ana e brendshme, duke lënë në pamjen e jashtme portat e vjetra të kështjellës së Elisonit. Në portën lin-

dore është vepruar në të kundërtën, d.m.th. porta-shtesë është ndërtuar në anën e jashtme të portës fillestare.

Nga ndërtimet më të rëndësishme që janë bërë nën pushtimin turk brenda territorit të kështjellës së Leshit, është edhe kompleksi i ndërtimeve të vendosura në pjesën më të ngritur të kështjellës, që e rrëthuar me një mur mbrojtës, përbënte një kompleks të vogël urbanistik e arkitektonik tipik për kushtet e periudhës në fjalë. Raste të tilla janë gjetur edhe në kala të tjera, si në: Shkodër, Berat, Durrës etj. Nga ky kompleks, deri vonë ruheshin muret e rrëzuara të ndërtuesave të sarajeve, ku banonin autoritetet më të larta të pushtimit turk. Të dallueshme janë akoma rrënojat e një xhamie, sternat e ujit si edhe kalldrëmet e rrugëve të qarkullimit nëpër zonën e këtij kompleksi të fortifikuar (fig. 27).

Muri që rrëthonë zonën e sarajeve ndjek një linjë të thyer, me kthesa të çrrëgullta dhe në ndonjë rast ai mbështetet në muret e ndërtuesave. Ai është i pajisur me dy kullat vogla, të ndërtuara në kthesat e murit dhe në vende më të përshtatshme për mbrojtje. Në paretet e murit rrëthues ruhen gjurmë, që tregojnë për pajisjen e tij me frëngji të posaçme për armë zjarri. Muri i rrëthimit të sarajeve zë fill duke iu mbështetur murit verior të kështjellës, menjëherë pas portës së brendshme të hyrjes veriore dhe përfundon po në murin verior, afër portës perëndimore. Në këtë mënyrë, ai rrëthonë pjesën më të ngritur të kalasë mesjetare.

Në zonën e mbrojtur të sarajeve kalohej nëpërmjet dy hyrjeve, njëra prej të cilave ishte hyrja kryesore, që komunikonte kryesisht me portën perëndimore të kalasë (foto 19). Hyrja tjetër, më e vogël, ishte nën anën jugore dhe shërbente për komunikimin me dy hyrjet e tjera.

Nga vendosja e këtyre hyrjeve duket se edhe vetë porta perëndimore e kalasë kishte në këtë kohë një funksion të veçantë: atë të komunikimit të drejtpërdrejtë me zonën e mbrojtur të sarajeve.

Në pjesën tjetër të territorit të kalasë, gjurmimet arkeologjike që janë bërë tregojnë për një dendësi ndërtuesash të ndryshme, të cilat u përkasin kohëve më të hershme para pushtimit turk.

Duke pasur parasysh faktin se në këtë pjesë nuk ruhen mbi sipërfaqe gjurmë të ndërtuesave të tjera, veç atyreve që lidhen me përforcimin e mureve rrëthuese të saj, mund të mendohet se në këtë zonë të sheshit, që shtrihej në mes murit rrëthues të kështjellës dhe atij që mbronte sarajet, të

kenë qenë ngritur çadrat e fushimit të ushtrisë turke, e cila mbronte këtë objekt.

Të gjitha masat e marra nga qeveria turke për rindërtimin e sistemit të fortifikimit të kështjellës së Leshit, në veçanti edhe të sarajeve, të zonës së banuar nga autoritetet e pushtimit, tregojnë qartë se pushteti osman dhe ushtria turke ishin gjithnjë nën frikën e sulmeve të befasishme të kryengritësve shqiptarë.

Për të krijuar një përfytyrim edhe më të plotë të gjendjes në të cilën jetonin turqit në tokat shqiptare, ndihmon një ndër dokumentet e burimeve historike osmane të shekullit XVI (viti 1570), ku thuhet shprehimi i «Popullsia e kazasë së Shkodrës dhe ajo e nahijeve të Musjes e Kurbinit» është hedhur në kryengritje. Shtatë-tetë mijë kryengritës, të bashkuar me forcat ushtarake të Ulqinit e të Tivarit, sulmojnë kështjellën e Leshit. Kundër tyre dërgohet bejlerbeu i Rumelisë¹.

... «Popullsia e kazasë së Shkodrës kanë ngritur krye që të gjithë, se këta kanë njohur për zotër të pafetë e kalave armike të Tivarit e të Ulqinit, që varen nga Venediku dhe se mbasi është bërë një lidhje midis tyre dhe të pafeve të sjellë me anije nga kalatë e mësipërme, shtat-tetë mijë të pafe kanë marshuar kundër kështjellës së Leshit. Mbasi është bërë tri ditë luftë..., të pafetë janë asgjësuar ca janë shkuar në shpatë, ca janë mbytur. Mirëpo, s'ka dyshim, se ata do të formonin përsëri lidhje edhe në qoftë se nuk do të arrinin 300 jeniçerë dhe më se 1000 kalorës, Kalatë e Shkodrës e të Leshit do të na dalin nga dora... Natën e 15 të muajit (dhjetor) të lartpërmendur, komandantët e Kalave të Tivarit, Ulqinit e Kotorrit, kush nga deti me galerë e kush nga toka, duke pasur me vete kaq mijë njerëz dhe përdredhore, kanë ardhur në skelen e kështjellës së Leshit dhe kanë formuar një forcë të përbashkët. Prandaj është e sigurt se ato do t'i sulen kështjellës. Dërgohet për ndihmë dhe në mbrojtje të kështiellës së Leshit me forca të shumta, bejlerbeu i Rumelisë. Në të njëjtën kohë kanë ngritur krye edhe të pafetë e nahijeve të Musjes e të Kurbinit, që ndodhen në kazanë e Akçe hisarit (Krujës), të sanxhakut të Ohrit. Këta kanë dëgjur çifligjet e myslimanëve, që ndodhen në (tokat), nga viset e tyre deri në kështjellën e Leshit, kanë plaçkitur pasurinë

1 Dokumente osmane, Vep. cit., Dokumenti nr. 51,

e këtyre dhe kanë zënë robër shumë veta. Këta qenkan duke u bashkuar me komendantët e fortësave të mësipérme. Kështu që armiku i lig është duke sulmuar nga çdo anë. Në qoftë se brenda katér-pesë ditësh nuk dërgohen forca ushtarake, dihet si një e një që bëjnë dy, se jo vetëm që do të na dalin nga dora kalatë, por do të zihen robër e do të bien dëshmorë të gjithë spahinjtë e sanxhakut të Dukagjinit si edhe myslimanët e tyre...¹

Të dhëna të rëndësishme, mbi gjendjen dhe vendosjen e zonave të banuara të Leshit për këtë periudhë dalin edhe nga një relacion anonim, i shkruar në vitin 1570. Ky relacion paraqet në përgjithësi, përshkrime gjeografike të qyteteve, të lumenjve, të liqeneve etj. të vendit tonë. Në këto përshkrime bëhet fjalë shkurtimisht edhe për Leshin, për lumin e Drinit dhe për skelat që gjenden në gjirin e tij.

Autori i panjohur i këtij relacioni thotë se, duke vazhduar nga veriu për në jug, 24 mile larg nga Shkodra, është Kështjella e Leshit në majë të një malit me mure të ulëta e të dobëta, vetëm me afro 80 shtëpi myslimanë. Ndërsa tjetra thuhet se në brigjet e lumit ka një varosh vetëm për të krishterët.

Në bazë të këtyre të dhënave duhet menduar se në këtë kohë Leshi ishte i ndarë në dy zona, të banuara respektivisht nga myslimanë e të krishterë. Qendra kryesore ishte kështjella, ku përveç autoriteteve turke ishin vendosur edhe 80 shtëpi myslimanësh. Në breg të lumit duket se ka filluar të rindërtohet tregu i qytetit të vjetër, ku banojnë edhe të krishterët.

Kjo pjesë e qytetit të hershëm të Leshit në këtë përshkrim gjeografik të shkurtër është quajtur varosh. Dihet se në periudhat më të vona ky emërtim është përdorur thuajse në të gjitha qytetet mesjetare të vendit tonë, duke përcaktuar gjithnjë pjesën ose lagjen që ndodhej jashtë mureve të fortifikuara të kalasë.

Nga përshkrimi që i bëhet në këtë relacion lumi i Drinit, del se ky lumë akoma derdhet në det me dy gryka. Kjo gjë tregon edhe një herë ekzistencën e ishullit, për të cilin u fol më parë.

Thuhet gjithashtu se gjiri në grykëderdhje në lumi i Drinit quhej gjiri i Drinit ose i Ludrinit. Këtu përmendet

¹ Burime historike..., Vell, 3, f. 159.

edhe skela e Leshit prej nga eksportohej pisha e butë që nxirrej nga malet e Dukagjinit.

Sipas të dhënave të tjera, këtë radhë të nxjerra nga burimet osmane, duket se turqit kanë arritur ta stabilizojnë gjendjen e tyre përderisa beu i Dukagjinit urdhërohet që nga 150 rojtarët e kështjellës së Leshit, t'i dërgojë 50 ushtarë me rrogë në përforcim të Kalasë së Ishmit, në të cilën kanë përfunduar punimet e ndërtimit.¹

Në ndihmë të konsolidimit të pushimit turk në Shqipëri, ishin pa dyshim, edhe marrëdhëniet paqësore të krijuara në këtë kohë, ndërmjet Venedikut dhe Portës së Lartë.

Nga kjo kohë, ambasadorët venedikas, për të vajtur në Stamboll zbritnin në Lesh dhe prej këtej ata kalonin nëpër tokën shqiptare për t'u futur në thellësi të Ballkanit.

Me interes janë pjesët nga relacioni i ambasadorit venecian Soronco² (viti 1575), i cili, siç thotë vetë, sapo arriti tre milje pranë qytetit të Leshit, aty ku me galerë nuk mund të shkohej më tutje, u ndal për të zbritur. Këtu ambasadori pri-tet nga një çauš, që ishte ngarkuar nga sulltani për ta shoqëruar atë deri në Stamboll. Çauši u takua me ambasadorin dhe mori leje për t'u kthyer në qytet, prej ku dërgoi menjëherë katër lundra të zbukuruara me qilima e me ble-rime dhe një barkë për plaçkat si edhe pajisje njerëzish për vozitjen e lundrave, që do ta mbartnin ambasadorin nëpër lumë deri në qytet të cilin, siç thotë relacioni, e kanë rrënuar luftërat.

Në vitin 1591 zbret në Lesh Bernardo³, një tjetër ambasador venecian, i cili ishte për udhëtim në Stamboll. Në relacionin e udhëtimit të tij përshkruan gjithashtu lumin e Drinit me dy rryma të lundrueshme, të cilat formojnë një ishull në fushë shumë të bukur e pjellore, ku thuhet se dikur ka qenë qyteti i Leshit, kohë kur ishte pushtuar nga zotërinjtë tanë venedikas, të cilët dërgonin aty proveditorët. Duket qartë se ky autor është në dijeni të ngjarjeve historike të zhvilluara në fillim të shekullit XVI në ishullin e Lezhës dhe i rikujton ato menjëherë sa zbriti në atë vend. Në vazhdim të relacionit të tij Bernardo thotë se tashti Leshi është një kështjellë me mure rrëthuese të vogla dhe jo shu-

1 Dokumente osmane, Vep. cit., f. 120.

2 Burime, vëll. 3, Vep. cit., f: 167: ,

3 Burime, vëll. 3, Vep. cit., f. 169.

më të forta, ndërtuar që nga lashtësia dhe gjendet përmbi një kodër me tokë pjellore, gjysmëmilje larg nga bregu i lumit. Bernardo jep edhe disa të dhëna të tjera si, p.sh., për kishën franceskane, të ndërtuar rishtas, përballë, në bregun tjetër, dhe për banesat e Leshit që shtriheshin nga bregu i lumit dhe deri në rrëzë të malit. Këtu ishte dhe shtëpi e Eminit si edhe karvanosaraj (hani), ku bujtnin tregtarët dhe udhëtarët.

Në Lesh, vazhdon ai, grumbullohen mallrat; aty, në kohë të mëparshme kishte lëvizje të madhe, por tanë bëhen punë pak, sepse rrugët nuk janë të sigurta, sepse kërcënohen nga shqiptarët e Dukagjinit.

Duke krahasuar dy relacionet e mësipërme, të cilat kanë një largësi kohe pak më se 15 vjet, shihet se pjesa e poshtme e Leshit kishte filluar të zhvillohej, megjithëse me një ritëm të ngadalshëm. Gjatë kësaj kohe ishte ndërtuar hani, i cili prespozon një zhvillim të tregtisë dhe qarkullini i është udhëtarëve. Nga ana tjetër, edhe rindërtimi i kishës matanë Drinit tregon për një rimëkëmbje të ekonomisë dhe për lëshime të pushtetit osman kundrejt popullsisë vendase. Në fillim të shekullit XVII Frang Bardhi¹ nga Zadrima dhe peshkop i kësaj krahine, në botimin e tij «Skënderbeu», Leshin e përmend me emrin e lashtë Lissos dhe thotë se në kohën e Skënderbeut dhe të babait të tij si edhe më parë, pjesa më e madhe e Zadrimës, atdheut tim, ka qenë nën sundimin e princave shpirtmëdhenj Dukagjinash, kurse pjesa tjetër ishte nën zotërimin e Lek Zaharisë.

Nga materialet burimore arkivale të fillimit të shekullit XVI, për t'u përmendur janë gjithash tu edhe relacionet e M. Bicit² (kryepeshkop i Tivarit) dhe të B. Orsinit (peshkop i Leshit). Në këto relacione ka disa pak të dhëna, të cilat ndihmojnë në përcaktimin më të qartë të shtrirjes së Leshit dhe të lagjeve që ishin në ato kohë, përreth tij. Ndër to bëhet fjalë pér Lagjen e Pazarit, banorët e saj si edhe për kështjellën në majë të kodrës.

Nga këto të dhëna vërtetohet rigjallërimi dhe zhvillimi i jetës së këtij qyteti, që po rimëkëmbej përsëri, megjithëse me ritme të ngadalshme dhe në kushte shumë të vështira.

1 F. Bardhi, Skënderbeu, Përkthim nga S. Prifti, f. 48, 50, 85.

2 Burime dhe materiale për Historinë e Shqipërisë, Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII, vëll. I, 1610-1634, f. 120.

Në relacionin e M. Bicit thuhet se Leshi në vitet e kaluar ishte diçka, por tanj, qoftë me ndërtesa e qoftë me banorë, ka rënë kaq poshtë saqë është si një fshat, me muret që kishte përreth të rrëzuara dhe me shumicën e shtëpive të rrënuara e të shkatërruara...; mund të jenë nga 30 shtëpi të krishtera.

Ky kryepeshkop latin shkoi në Lesh i ftuar për të kremluar një festë fetare, e cila, sipas tij, kremltohej, në atë kohë, me pjesëmarrjen e madhe të popullsisë kristiane. Festa e kremluar në një kishë të madhe, që zinte më shumë se 2000 veta. Kjo kishë, emri i së cilës nuk përmendet në relacion, thuhet se ishte jashtë qytetit, në anë të lumit të Drinit; aty shërbenin fretërit, të cilët kishin edhe një kuvend në qytet.

Kurse në relacionin e B. Orsinit¹, shkruar në vitin 1629, d.m.th. gati mbas 20 vjetëve, thuhet se qyteti i Leshit ishte i vendosur në breg të lumit të Drinit, me fortësë të vendosur mbi supet e malit të shën Shelbunit. Ka 70 familje të krishtera dhe në lagjet përreth tij 100 shtëpi të tjera, kurse në kështjellë nuk ka asnjë të krishterë.

Në lagjen e Pazarit thuhet se ka pak skizmatikë (ortodoxë të huaj). Turqit, sikurse theksohet nga B. Orsini, ishin më shumë në kështjellë, por kishte edhe në qytet e në lagjet përreth tij.

Me njëfarë interesë janë edhe të dhënë që jep B. Orsini lidhur me kishat që kishte Leshi në kohën e kaluar dhe përato që ishin akoma në funksionim. Së pari, ai përmend kishën e shën Gjergjit, e cila thotë se është ndërtuar me shumë bukuri. Kisha e shën Mërisë së Borës ishte kthyer prej turqve në depo armësh. Në relacion përmenden edhe kishat e shën Sebastianit dhe të shën Nunciatës, por nuk thuhet vendi se ku gjendeshin ato. Kisha e shën Kollit, e cila ishte kisha katedrale e qytetit, sipas B. Orsinit, ishte kthyer në xhami qysh përpëra 40 vjetëve. Në përgjithësi, kishat e përmendura theksohet se nuk janë në funksionim, sepse disa janë rrëzuar e disa të tjera janë pushtuar nga turqit. Në këtë qytet, vazhdon ai, nuk ka asnjë manastir, por vetëm një kuvend të vogël të fretërve, me një kapele përbrenda. Në këto rrëthana peshkopi i Leshit, i cili nuk kishte se ku të meshonte. bleu një shtëpi për 25 skude nga fretërit dhe atje

¹ Burime. vëll. 3, Vep. cit., f. 195.

vendosi selinë e tij, ku ndërtoi një kapele (kishëz) për të meshuar.

Përveç këtyre, B. Orsini përmend edhe kishën e shën Margaritës e cila ishte rrëzuar gjithashtu nga turqit, që një-kohësish dogjën edhe manastirin. Aty pranë ishte edhe kisha e shën Mërisë, ku fretërit kryenin shërbimet e tyre.

Të dhënat e dy relacioneve të sipërpërmendura japid një ide deri diku të qartë lidhur me kishat, që ishin të njoitura akoma në atë kohë në qytetin e Leshit. Duke parë në retrospektivë, të dhënat e burimeve të fillimit të shekullit XVI tregojnë se në periudhën para pushtimit turk qyteti i Leshit kishte një numër faltoresh, relativisht të konsiderueshëm. Disa prej tyre ishin edhe të mëdha e të ndërtuara bukur. Kiske edhe kuvende apo manastire dhe të gjitha këto së bashku vërtetojnë shkallën e zhvillimit ekonomiko-kulturor të qytetit dhe të krahinave përreth tij, që ishte arriut para pushtimit turk. Në ditët tona janë të njoitura vetëm katër kisha në qytet, dy prej të cilave janë matanë lumi të Drinit dhe dy të tjera brenda pazarit.

Me këto kisha përputhen të dhënat e burimeve për sa i përket kishës së shën Kollit, katedrales së qytetit, ku, sipas Barletit, ishte varrosur Skënderbeu.

Kisha tjetër, shumë e vogël dhe shumë e thjeshtë, që ndodhet në afersi të bregut të lumi, mundet që të ketë qenë kapelja që pati ndërtuar M. Bici në kohën e tij. Ajo arriti deri vonë me emrin e shën Kollit, gjë që lë shteg për të menduar se trashëgonte emrin dhe funksionet e katedrales së vjetër të kthyer në xhami.

Kisha e madhe, që M. Bici thotë se ishte jashtë qytetit dhe matanë lumi, duhet të jetë kisha e manastirit të shën Antonit, i cili në fillim të shekullit tonë, në kohën kur u vizitua nga Th. Ipen, ishte një manastir i vogël i franceskanëve, kisha e të cilët ishte rindërtuar në kohë të reja. Në këtë objekt, sipas Ipenit, ishin përdorur edhe materiale që i përkisnin kishës së vjetër të ndërtuar në shekullin XIII. Autori i këtyre të dhënavë bën fjalë për një gur të murosur në portën e kishës së re, mbi të cilin ishte një pjesë mbishkrimi në gjuhën latine, që dukesh se ishte pjesë e gurit të arkitraut të portës së faltores së vjetër.¹

1 Th. Ipen, Alte Kirchen und Kirchenruinen in Albanien

Në fillim të shekullit XVIII Leshi përfshihej në sanxhakun e Shkodrës dhe ishte qendra e nahijes së tij, që në atë kohë quhej nahija e Leshit. Qyteti i Leshit nuk ishte në radhën e qyteteve-kaza më të zhvilluara të këtij sanxhaku, sikurse ishin Ulqini, Tivari, Podgorica, Plava dhe Mali i Zi.

Nga fundi i këtij shekulli feudalët leshjanë u lidhën me ata të Mirditës, pér t'i bërë ballë rrezikut që i kërcenohej nga pashai i Bushatlinjve. Në vitin 1768 Mehmet Pasha suimoi leshjanët me një ushtri prej 2500 vetash, por nuk i theu dot. Qyteti i Leshit ra më 1770 pas pushtimit të Zadrimës nga ushtria e Mehmet pashë Bushatlliut, duke hapur në këtë mënyrë rrugën pér të shkuar me ushtrinë e tij në frontin e Luftës Russo-Turke.

Në Rrethimin e Dytë të Shkodrës, në vitin 1793, leshjanët përkrahën Karamahmut Bushatliun, i cili ishte i rrethuar nga ushtria turke në Kalanë e Shkodrës. Leshjanët së bashku me fshatarë të tjerë kryengritës, më 28 nëntor 1793 sulmuan ushtrinë turke, që kishtë pushtuar qytetin e Shkodrës; ndërkojë edhe Karamahmut Pasha doli nga kalaja dhe të gjithë së bashku sulmuan ushtrinë turke. Eburbeqiri, pashai i ushtrisë turke, u detyrua të luftonte, me qëllim që të shpëtonte i gjallë nga ky rrethim i papritur. Gjatë tërheqjes nga Shkodra ushtria turke u shpartallua edhe më keq nga prita që ishte ngritur në qytetin e Leshit. Eburbeqiri, me mbeturinat e ushtrisë së tij, u tërroq në drejtim të Elbasanit dhe prej këtej shkoi menjëherë pér në Manastir.

LEZHA NË EPOKËN E PARTISE

Gjatë shekullit XIX deri në prag të Çlirimt Lezha ishte një qendër e vogël administrative e pazhvilluar. Menjëherë pas Çlirimt u morën masa të rëndësishme për rindërtimin e dëmeve të luftës, dhe në mënyrë të veçantë për vënien në funksionim të rrugës kryesore automobilistike Lezhë-Shkodër, e cila do të shërbente për komunikimin e rregullt dhe për furnizimin pa vështirësi të pjesës veriore të Shqipërisë.

Gjatë viteve të pushtetit populor Lezha, si e gjithë Shqipëria, është rritur dhe është zbuluar. Vendi i këne-tave dhe i moçaleve, krahina më tipike e mushkonjave dhe e malaries, vendi i hasmërive, i gjaqeve dhe i hakmarrjes, i urisë dhe i varfërisë shekullore është bërë sot vend i begatisë dhe i lumturisë.

Popullsia e qytetit dhe e rrethit është e përbërë nga njësi të veçanta etnografike, të cilat të para nga pikëpamja e traditave zakonore dhe sidomos nga veshjet e tyre popullore karakteristike mund të ndahen në tri grupe kryesore. (foto 20).

Banorët që mund të cilësohen si më të hershëm në këtë krahinë janë zadrimorët, të cilët përbëjnë një grup me tipare të veçanta etnografikë. Ata shquhen nga veshja e tyre e pasur në ngjyra, nga doket e nga zakonet familjare, nga traditat folklorike, nga dialekti i veçantë etj.

Në anën verilindore shquhet një grup tjetër i vogël, kallmetasit. Edhe ata, megjithëse janë përqendruar në pak fshatra, kanë veshjen e tyre karakteristike, sidomos të grave, kryesisht të bardhë dhe me tipare të trashëguara nga veshjet e lashta tradicionale shqiptare.

Grupi i tretë përbëhet nga banorët mirditorë që kanë

zbitur në fushë e në qytet nga malësia e Mirditës, të cilët gjithashtu dallohen nga veshja, nga zakonet familjare dhe nga dialekти.

Në qytetin e Lezhës si dhe në zonën fushore ka edhe grupe të vogla të ardhura nga malësia e Kelmendit, nga Dukagjini etj., të cilat janë vendosur këtu fillimisht si blegtorë shëtitës, që shoqëronin kopetë e bagëtive të imëta në kullotat fushore.

Nga gjithë këto grupe, gjatë viteve të Pasqirimit është krijuar popullsia e re lezhiane, në të cilën karakteristikat e çdo grupi etnografik manifestohen më mirë se kudo në festivalet folklorike kombëtare e krahinore.

Lezha është bërë një qytet me industri të zhvilluar. Janë ngritur disa fabrika si ajo e letrës, që është më e madhja në vendin tonë e që prodhon 7 lloje letre, për gazetë, për letër tipografike, për ofsejt etj. Është ngritur fabrika e vajit, e tharjes së perimeve, e ekstraksionit, e konservave të peshkut, e konservave të perimeve dhe e frutave, e blojes etj. Është rritur industria e materialeve të ndërtimit mbi 5 herë, e drurit mbi 10 herë, e veshmbathjes etj. (foto 21).

Shërbimet komunale dhe rrjeti i tregtisë janë shtrirë si në qytet ashtu edhe në fshat. Tregues pozitiv, që lidhet si me prodhimin ashtu edhe me nevojat që ka popullata, është rritje e madhe e energjisë elektrike. Në këtë rreth elektrifikimi i plotë në të gjithë fshatrat përfundoi më 28 mars 1970. Në procesin e transformimeve të mëdha e të thella revolucionare vend të rëndësishëm zë bujqësia.

Reforma Agrare shpronësoi pa shpërblim tokat e pronarëve shfrytëzues dhe të institucioneve fetare.

Me zbatimin e Reformës Agrare në këtë rreth 566 familje përfituan 3,766 ha tokë. Përveç tokës, Reforma Agrare shpërndau 6.632 rrënjenj ullinj, 600 pendë qe etj.

Më 20 nëntor 1946, në Tale u ngrit e para kooperativë bujqësore. Në zbatim të orientimeve të Partisë, në vitin 1959, në këtë rreth përfundoi kolektivizimi i bujqësisë në zonat fushore e kodrinore, ndërsa më 1967 edhe në ato malore. Në fillim të vitit 1960 u ngrit ndërmarrja bujqësore. Në fillim të viteve 1972 dhe 1975 në Bregun e Matës dhe në Dajç u krijuan kooperativat e tipit të lartë.

Nga 4.728 ha tokë që kishte rrethi më 1938, më 1979 u rrit afër 4 herë. Kjo u arrit në mënyrë të veçantë si rezultat i tharjes së kënetave e moçaleve.

Kënetat e formuara në grykëderdhjen e Drinit si dhe ajo e Kakarriqit, paraqisnin një sërë problemesh të vështira, si në drejtim të bonifikimit ashtu edhe të ujitjes. Problem të veçantë përbënte sidomos studimi i bonifikimit të Fushës së Zadrimës, e cila në pjesën më të madhe ishte e pashfrytëzuar pér arsyet e përmbytjeve nga vërshimet e lumenjve Drin dhe Gjadér.

Pér t'i kthyer këto në fusha të lulëzuara filluan studimet përkatëse, pér largimin e ujërave, pér hapjen e kanaleve kulluese e ujitëse etj. U bë gjithashtu edhe studimi i sistemimit të lumenjve nëpërmjet digave e argjinaturave mbrojtëse apo edhe pér ndërrimin e drejtimit të derdhjes së tyre.

Pér realizimin e këtyre punimeve pushteti populor bëri investime të shumta; u dërguan eskavatorë, buldozerë dhe mekanizma të tjera, specialistë dhe qdo gjë tjetër që nevojitej. Kontribut të rëndësishëm dha edhe fshatarësia kooperativiste.

Mëdis seprave të rëndësishme bonifikuese dhe ujitëse mund të përmendet diga e madhe që u ndërtua në Dajç, e cila pret ujërat e Drinit dhe i kthen në detin Adriatik. Pér bonifikimin e fushës së Bregut të Matit u ndërtua një argjinaturë 12 km e gjatë dhe u hapën kolektorët kullues (rreth 20 km gjatësi). Pér largimin e ujërave, u ndërtua hidrovori i Tales, me energji elektrike të instaluar 500 kw dhe me kapacitet prej 11,25 m³ ujë në sekondë. Ndërkohë u ndërtua edhe vepra e marrjes së ujit nga lumi Mat pér kanalin ujitës 15 km të gjatë me një prurje 4,5 m³ ujë në sekondë.

Një vepër tjetër e madhe ishte edhe tharja e kënetës së Kakarriqit e përbërë nga 2200 ha. Pér kullimin dhe pér largimin e ujërave u hapën dhe u pajisën me seprat përkatëse rreth 200 km kanale dhe u ndërtua stacioni i elektropompave në Balldren.

Punime të rëndësishme janë bërë pér ndërtimin e seprave ujitëse, një nga të cilat është dhe rezervuari i Kallmetit, i cili grumbullon rreth 2.000.000 m³ ujë dhe ujit rreth 700 ha tokë. Reversuarë të tjera më të vegjël janë ndërtuar në Kashnjet, në Troshan, në Patalej etj.

Me anën e punimeve bonifikuese të kryera gjatë një kohe njëzetvjeçare, u arrit që të kthehen në toka buke rreth 6000 ha këneta e moçale, të cilat në të kaluarën ishin burime të malaries e turbekulozit, sëmundje vdekjeprurëse pér masat e gjera të popullit.

Bonifikimi, sistemimi i tokave, ndërtimi i seprave ujitëse



Foto. 1.




Foto. 2.




Foto. 3.




Foto. 4.



Foto. 5.




Foto. 6.



Foto. 7.




Foto. 8.




Foto. 9.




Foto. 10.




Foto. 11,



Foto. 12.



Foto. 13.




Foto. 14.




Foto. 15.




Foto. 16.



Foto. 17.



Foto. 18.



Foto. 19.




Foto. 20.



Foto. 21.



Foto. 22.



Foto. 23.




Foto. 24.

dhe masat e tjera agriteknicke bënë që të shtohen prodhimet bujqësore e begtorale. Sot këtu mëren mbi 34 kv grurë për ha, mbi 50 kv misër, mbi 15 kv lule dielli për ha etj.

Rezultate të dukshme janë arritur edhe në shtimin e blegtorisë, të frutikulturës. Rrethi i Lezhës dallohet përritjen e derrit, të shpendëve dhe të bletës.

Në vitin 1955 u ngrit SMT-ja, e cila ndikoi pozitivisht në zhvillimin dhe në mekanizimin e bujqësisë. Toka tanimë pluhohet e diskohet me traktorë të fuqishëm, mbjellja e kultuvave të ndryshme bëhet me makina mbjellëse dhe korjet e shirjet bëhen me autokombajna. Në tokat e këtij rrethi sot punojnë mbi 700 traktorë me 15 kuaj fuqi, mbi 50 autokombajna e shumë makineri e aggregatë të llojeve të ndryshme.

Rritja e prodhimeve bujqësore e blegtore ka bërë që të rriten në mënyrë të ndjeshme edhe të ardhurat e përgjithshme të kooperativave bujqësore. Kjo ka sjellë si rezultat që si në qytet ashtu edhe në fshatra të përmirësoset niveli i jetesës së popullit.

Në këtë rreth funksionojnë 11 shkolla të mesme, nga 7 shkolla fillore që kishte para çlirimt. Në bankat e shkollave ulen rreth 14 mijë nxënës çdo vit dhe ka mbi 800 mësues. Funksionojnë 45 shtëpi e vatra kulture, 10 librari, 84 biblioteka etj. Këtu ka 5 herë më tepër kuadro të lartë mjekësore më shumë sesa kishte në vitin 1967 dhe një mjek u shërben 600 banorëve. Popullsia e rrethit është 2,74 herë më e madhe se më 1945. Jetëgjatësia mesatare është 70 vjeç nga 38 që ishte më 1938. (foto 22).

Në të gjithë fshatrat ka qendra shëndetësore e në çdo qendër fshati të bashkuar ka më shumë se 2 mjekë, funksionojnë 2 spitale. Më 1984 u ndërtua spitali infektiv dhe më 1985 spitali gjinekologjik. Në qendrat e fshatrave të bashkuara ka shtëpi lindjeje dhe në çdo fshat ka mami.

Gjatë viteve të pushtetit popullor janë ndërtuar në fshat mbi 3000 shtëpi të reja banimi.

Për pushimin e fëmijëve dhe të punëtorëve janë ndërtuar dy shtëpi pushimi në plazhin e bukur të Shëngjinit. Është ngritur qendra turistike, me hotelin karakteristik të gjuetisë, i cili është bërë një nga vendet më të preferuara për punonjësit.

Rezultate të rëndësishme janë arritur edhe në ndërtimin e një rrjeti të gjërë rrugor automobilistik, për lidhjen e kooperativave bujqësore me qytetin. Rrjeti rrugor i ndër-

tuar në fushat e gjera të bonifikuara ka ndihmuar për qarkullimin e mjeteve të mekanizuara bujqësore dhe të makinave të transportit të prodhimeve bujqësore, të tregtisë dhe ato të shërbimit urban.

Me ndërtimin e hekurudhës Tiranë-Lezhë-Shkodër, qyteti i Lezhës është bërë një qendër e rëndësishme dhe me perspektivë në rrjetin e përgjithshëm hekurudhor të vendit.

*

* * *

Tërmeti i fuqishëm i 15 prillit 1979 e dëmtoi rëndë qytetin e Lezhës dhe disa fshatra të këtij rrethi. Nga njofstimet e menjëherëshme doli se u dëmtuan 4203 shtëpi e apartamente banimi si dhe 223 objekte socialkulturore.

Me thirrjen që bëri Partia dhe shoku Enver Hoxha, u ngrit në këmbë e gjithë Shqipëria. U morën masa të menjëherëshme për strehimin e të dëmtuarve dhe për fillimin e punimeve për zhdukjen e pasojave të tërmetit. Mijëra punonjës të qytetit dhe të fshatit të këtij rrethi së bashku me më tepër se 3000 vullnetarë të ardhur për ndihmë nga rrethe të tjera të vendit, punuan me frymë revolucionare për të merremtar banesat e dëmtuara dhe për të rindërtuar objekte e apartamente të reja. (foto 23).

Në këtë aksion të madh politik, ideologjik dhe ekonomik u shpreh edhe një herë me forcë të madhe mobilizimi, vrulli revolucionar dhe solidariteti socialist i punonjësve dhe masave të giera. I gjithë populli shqiptar, me mendje e zemër, ishte pranë të dëmtuarve nga tërmeti. Përveç mijëra specia-listëve të degëve të ndryshme dhe aksionistëve, ndërmarrje të ndryshme, nga të gjitha rrethet dërguan edhe sasi të mëdha materialesh ndërtimi, si cimento, gëlqere, lëndë druri, hekur, tjegulla, tulla, etj.

Iniciativa të shumëlojshme, zotime dhe aksione të mëdha lindën dhe u vunë në jetë, në të gjithë vendin për të shtuar prodhimin dhe për të punuar me orë të zgjatura në ndihmë të të dëmtuarve nga tërmeti.

Qyteti i Lezhës dhe fshatrat e dëmtuara u kthyen në kantiere të mëdha ndërtimi. U ngrit menjëherë shtabi i punës për zhdukjen e pasojave të tërmetit. Institucionet për-

kalëse u ngarkuan për hartimin e projekteve të ndërtimit dhe përfundimin me materialet e nevojshme.

Sipas planit rregullues të qytetit, pazari i vjetër dhe godinat e tjera të rrënuara e të dëmtuara rëndë do të ngriheshin të reja. U vendos që një pjesë e truallit që zinte pazari i vjetër, nën të cilin ruheshin edhe gjurmë të qytetit ilir dhe të periudhave të tjera, të përjashtohej nga ndërtimet dhe të caktohej zonë arkeologjike. Ndërtime të tjera u ngritën në terrenin kodrinor, në anën jugore të qytetit.

Punimet për zhdukjen e pasojave të tërmëtimit në qytetin dhe në rrethin e Lezhës përfunduan brenda një kohe relativisht të shkurtër. Në sajë të një mobilizimi të pashembullt, gjatë pesë muajve u riparuan 3924 banesa dhe objekte socialkulturore dhe u ndërtuan 502 apartamente e shtëpi të reja. Në këtë mënyrë $\frac{3}{4}$ e popullsisë së rrethit u strehuan në apartamente e në shtëpi të reja, shumë më të mira nga ato që kishin më përparrë.

Për realizimin e gjithë këtyre punimeve, përvèç forcës njerëzore e makinerive që u vunë në përdorim, shteti i akordoi rrethit të Lezhës një fond prej 33 000 000 lekë. U vunë në përdorim 10. 200 000 copë tulla, 270 000 copë tjegulla, 4592 tonë gëlqere, 6000 tonë çimento, 4000 m^3 lëndë druri, 500 tonë hekur, 6000 m^2 parket etj. etj.

Duhet vënë në dukje se tërmëteti i 15 prillit 1979 jo vetëm nuk e ndërpree zhvillimin e jetës normale, por dhimbja e popullsisë së dëmtuar u kthye në një vrull revolucionar e një mobilizim të përgjithshëm, që e bëri qytetin e Lezhës dhe fshatrat e saj përfundimtarët.

Këto suksese e kanë burimin në vijën e drejtë të Partisë dhe në mësimet e shokut Enver Hoxha që e mobilizojnë popullin shqiptar të kryejë veprat gjithnjë e më të mëdha.

Në rrethin e Lezhës, gjatë viteve të pushtetit popullor, është ndërtuar tërësisht i ri, edhe një qytet i dytë, Shëngjini. Para Çlirimtës ai ishte vetëm një skelë e vogël me tri-katë baraka, me një aktivitet shumë të kufizuar. Ndërsa në ditët tona është bërë porti detar më i rëndësishëm në bregdetin verior të vendit. Aty ankorohen anije transporti me tonazhe të ndryshme. Këtu është ngritur ndërmarrja e peshkimit, e pajisur me anije që peshkojnë në ujërat bregdetare të vendit dhe në det të hapur. (foto 24).

Ky qytet është bërë një qendër e rëndësishme pushimi,

në sajë të pozicionit gjeografik dhe plazhit të bukur me ujë e rërë të pastër, që preferohet shumë në stinën e verës. Këtu janë ndërtuar hotele, kabina, lokale të ushqimit social e njësi të tjera tregtare.

Suksese akoma më të mëdha do të arrijë rrithi i Lezhës gjatë Planit të tetë pesëvjeçar.

PËRMBAJTJA

	Page
Hyrje	3
Kapitulli I. Periudha parahistorike.	7
1. Epoka e bronzit dhe e hekurit.	7
2. Qendra e protourbane.	12
Kapitulli II. Qyteti ilir i Lisit.	14
1. Të dhëna historike.	14
2. Gjurmë të zhvillimit urbanistik të qytetit	20
a) Hyrjet e qytetit	22
b) Rrugët e qytetit	27
3. Mbrojtja e qytetit	28
4. Akrolisi	32
5. Materiali dhe teknika e ndërtimit të mureve rrethuese të qytetit.	33
6. Mbi arkitekturën dhe artin	38
7. Jeta ekonomiko-shoqërore e qytetit	41
8. Monedhat e qytetit të Lisit	48
Kapitulli III. Qyteti i Lisit në kohën e pushtimit romak.	54
1. Akropoli i qytetit	55
2. Qyteti kodrinor	57
3. Qyteti i poshtëm	61
4. Datimi i rindërtimit të sistemit mbrojtës të qytetit të Lisit në kohën e pushtimit romak.	64
5. Përmbytja e zonës së poshtme të Lisit.	67
6. Zhvillimi i qytetit të poshtëm jashtë mureve rrethuese të tij.	70

Kapitulli IV. Lisi në antikitetin e vonë dhe në periudhën bizantine	75
1. Lisi në shekujt IV-V	75
2. Lisi në shekullin VI	78
a) Fortifikimi i qytetit të poshtëm. Kalaja e Lisit.	80
b) Porti lumor	83
c) Fortifikimi i zonës kodrinore	84
d) Kështjella e Lisit	85
Kapitulli V. Lisi iliro-arbëror (shekujt VII-XII).	90
1. Të dhëna historike.	90
2. Kështjella e Lisit (Elisonit).	97
3. Kalaja e qytetit të poshtëm në shekullin VIII.	100
Kapitulli VI. Leshi (Alesio) gjatë shekujve XIII-XIV.	104
Kapitulli VII. Leshi në shekujt XVI-XVIII.	115
Lezha në epokën e Partisë	126

Zheku, K.

Lisi në shekuj. [Red.: J.
Toçka]. T., «8 Nëntori»,
1988.

131 f. me il.

(B.m.) dhe

(B.v.) : 930.26 (406.5-21)
+ 949.65.01/.062


Zh 44

Tirazhi: 1500 kopje

Formati 60 x 88/16

Stash: 2204-82

Shtypur Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «MIHAL DURI» — Tiranë, 1988



Lek 6